



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORTI VJETOR

2020

Nr. 20

Prishtinë, 2021

Përmbajtja

Fjala e Avokatit të Popullit.....	7
I. Institucioni i Avokatit të Popullit	10
Mandati i Avokatit të Popullit.....	10
Promovimi i të drejtave të njeriut.....	13
Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit	20
II. Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.....	24
Pushteti legjislativ	24
Sistemi gjyqësor	26
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut gjatë pandemisë COVID-19.....	26
Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve	29
Pushteti ekzekutiv	30
Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	37
Përgjegjësia për mjedisin jetësor.....	39
E drejta për qasje në dokumente publike	49
III. Të drejtat e fëmijëve	54
Të drejtat e fëmijëve gjatë pandemisë COVID-19.....	55
E drejta e fëmijëve për arsim.....	56
Fëmijët me aftësi të kufizuara	56
Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve.....	58
Drejtësia për të mitur.....	60
Detyrimet pozitive të shtetit lidhur me të drejtën për jetë.....	61
Parandalimi i martesave të fëmijëve	62
E drejta për identitet ligjor	63
Rreziku nga qentë endacakë.....	64
IV. Barazia para ligjit.....	68
Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm për mbrojtje nga diskriminimi	68

Diskriminimi në punë.....	69
Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve gjatë pandemisë globale COVID-19..	70
Pozita e pensionistëve në kohën e pandemisë.....	73
Personat me aftësi të kufizuara.....	75
Barazia gjinore	77
Të drejtat e komunitetit LGBTI	79
Dhuna në familje	80
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	82
Strehimi social.....	83
Aktivitetet e Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi.....	84
Të drejtat e komuniteteve.....	87
Kthimi dhe siguria	89
Të drejtat pronësore	91
Arsimi	92
Përdorimi i gjuhës.....	95
Integrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe problemet me papunësinë	97
V. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës.....	102
Vizitat e realizuara	103
Policia e Kosovës	105
Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit.....	108
Qendra për Azilkërkues.....	118
Qendra e Mbajtjes për të Huajt	119
Institucionet e shëndetit mendor	120
Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës.....	120
Reparti i Urgjencës dhe i Kujdesit Intensiv Psikiatrik	122
Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.....	125

Shtëpitë Integruese në Bashkësi	126
Instituti Special në Shtime.....	127
Shtëpitë me Bazë në Komunitet	128
Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore - Shtime.....	128
Shtëpitë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare	129
VI. Bashkëpunimi ndërkombëtar	134
Bashkëpunimi me homolog dhe me organizata të tjera ndërkombëtare	137
Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë.....	142
VII. Komunikimi me publikun dhe me mediat	148
VIII. Financimi	154
Buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit	154
Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës	154
Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020	155
IX. Statistikat	160
Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve.....	160
Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2020 - 31 dhjetor 2020.....	169
Statistikat mbi treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike	174

Fjala e Avokatit të Popullit

Republika e Kosovës ndërtohet mbi parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, mosdiskriminimit, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Për më shumë se dy dekada, Avokati i Popullit ka qëndruar fuqishëm në rolin e tij kushtetues në përmbushje të mandatit për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe në fuqizimin e parimeve mbi të cilat është ndërtuar demokracia e vendit tonë. Në këtë drejtim është edhe përmbushja e obligimit kushtetues për t'i paraqitur Raportin Vjetor Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këtë vit, raportimi po bëhet në një situatë krize për shkak të Pandemisë Covid-19.

Masat kufizuese që janë ndërmarrë për të parandaluar kërcënimin ndaj shëndetit publik, e kanë vendosur në qendër të vëmendjes rëndësinë që e ka respektimi i të drejtave të njeriut edhe në kohë krizash.

Përmes këtij Raporti pasqyrohet gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe prezantohet puna e Avokatit të Popullit në mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Raporti synon të tërheqë vëmendjen e institucioneve që respektimi i të drejtave të njeriut të mos lihet në mëshirën e veprimeve të lira politike, por nëpërmjet instrumenteve ekzekutive dhe ligjore të sigurohet respektimi dhe zbatimi i tyre. Rëndësi të veçantë i kushtohet fuqizimit të mekanizmave që garantojnë pavarësinë e sistemit nga ndikimi i ndryshimeve në qeverisje dhe proceset politike.

Jam i bindur se konstatimet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit të adresuara dhe të paraqitura në këtë Raport, do të kenë vëmendjen e merituar të autoriteteve, në mënyrë që ky dokument të jetë një udhëzues për orientimin e politikave të funksionimit të shtetit, në pajtim me parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë, të epërsisë së sundimit të ligjit, të transparencës, të llogaridhënies, si vlera të demokracisë.

Ju siguroj se Avokati i Popullit do të vazhdojë të jetë në rolin e vet kushtetues si gardian i të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të cenuara- grave, personave të moshuar, personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, komuniteteve pakicë, komunitetit LGBTI dhe qytetarëve që jetojnë në varfëri.

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

I. Institucioni i Avokatit të Popullit

I. Institucioni i Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) si kategori kushtetuese, përkatësisht si institucion të pavarur kushtetues.¹ Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.² Funksionin e tij Avokati i Popullit e ushtron në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit shërben si mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve të tjera të cilat ushtrjnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: autoritetet publike), dhe si mekanizëm kombëtar për parandalimin e torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.³

Gjithashtu, Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë, i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë, pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.⁴

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, IAP-ja përbëhet nga: Avokati i Popullit, pesë zëvendës të Avokatit të Popullit dhe nga personeli i IAP-së.⁵

Mandati i Avokatit të Popullit

Mandati i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilëve Avokati i Popullit pranon dhe heton ankesat nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i/e cili/a pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore nga autoritetet publike në Kosovë.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e kompetencave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga autoritetet publike, të cilat janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, në pajtim me ligjin.

Në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit,⁶ si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligj.⁷

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XII, nenet 132-135.

² Po aty, neni 132.

³ Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 1.

⁴ Po aty, neni 1, paragrafi 2.

⁵ Po aty, neni 5.

⁶ Po aty, neni 3, paragrafi 1.

⁷ Po aty, neni 3, paragrafi 3

Në kuadër të kompetencave të tij, Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut, të parapara me Kushtetutë, me ligje, me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ).⁸

Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (ex-officio) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdor ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët ndodhen jashtë shtetit.

Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale, ai e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, me çështjet e barazisë gjinore dhe me mbrojtjen nga diskriminimi. Avokati i Popullit nuk ndërhyt në rastet dhe në procedurat e tjera gjyqësore, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave. Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.⁹

Në kuadër të Avokatit të Popullit funksionon Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKPT).¹⁰

Avokati i Popullit, në kuadër të përgjegjësive si MKPT, është i obliguar që t'i vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria (duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrën e emigracionit dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut). Avokati i Popullit bashkëpunon me mekanizmat ndërkombëtarë dhe vendorë në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të japë sugjerime dhe rekomandime për personat dhe për institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria, pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe të kushteve të tyre.

Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me legjislacionin tjetër në fuqi; mbledh të dhëna statistikore për çështjet e diskriminimit dhe të barazisë të paraqitura te Avokati i

⁸ Po aty, neni 16.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, paragrafi 2, neni 135, paragrafi 4, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 10. Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 29.

¹⁰ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17.

Popullit, të cilat edhe i publikon; nxjerr raporte dhe jep rekomandime për politikat dhe për praktikatat për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë; bashkëpunon me partnerët socialë dhe me OJQ-të të cilat merren me çështje të barazisë dhe kundër diskriminimit, si dhe me trupa ndërkombëtarë të ngjashëm me Avokatin e Popullit.¹¹

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit, por edhe të angazhohet për eliminimin e tyre; të hartojë dhe të miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe për trajtimin e ankesave për fëmijët, si dhe krijimin e ekipit të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe të programit të përhershëm për vetëdijesimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe për rolin e IAP-së për mbrojtjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe t'u rekomandojë qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe me avancimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të barazisë dhe jodiskriminimit; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe për liritë e njeriut, të barazisë dhe kundër diskriminimit, dhe të kryejë hulumtime për çështjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të barazisë dhe kundër diskriminimit; në pajtim me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare. Të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut; ta ruajë fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke u kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ankesat kundër administratës publike qytetarët mund t'i parashirojnë sipas procedurës së thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e qytetarëve të drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, të cilat nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e këshilltarëve të IAP-së kanë të bëjnë me ofrimin e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet e tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore.

Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme. Nëse Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren masa të menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë që organi administrativ kompetent të ndërmarrë

¹¹ Po aty, neni 16, paragrafët 13 dhe 16.

ose ta suspendojë një veprim të veçantë, si masë e përkohshme për të parandaluar dëmin e papërmirësueshëm të ankuesve apo të pasurisë së tyre.

Në qoftë se kërkesat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, për t'i mënjeluar shkeljet. Raporti i drejtohet autoritetit i cili ka bërë shkelje, kurse kopja e raportit i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe organizatave të tjera përkatëse. Ndërsa raportin vjetor për vitin paraprak, Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës deri më 31 mars të vitit vijues, i cili shqyrtohet në seancë plenare në Kuvend gjatë sesionit pranveror.¹²

Kompetencat e Avokatit të Popullit për t'i shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në përgjithësi dhe nga diskriminimi gjinor në veçanti janë paraparë me dy ligjet e tjera bazike për të drejtat e njeriut (Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore).

Kështu, sipas Ligjit për Barazi Gjinore, Avokati i Popullit është institucion i barazisë gjinore që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.¹³

Ndërsa, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin, sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.¹⁴

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.¹⁵

Promovimi i të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit 2020, është përkushtuar në drejtim të përmbushjes së mandatit kushtetues dhe ligjor për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Duke qenë se situata e pandemisë COVID-19 këtë vit ka paraqitur sfidë për IAP-në në drejtim të realizimit të aktiviteteve promovuese, Avokati i Popullit, nëpërmjet kapaciteteve ekzistuese me përpjekje maksimale, organizimin e aktiviteteve ia përshtati masave kundër pandemisë.

Në dy muajt e parë të vitit 2020, aktivitetet e planifikuara promovuese janë realizuar në terren, ndërsa nga muaji mars i këtij viti shumë prej aktiviteteve të planifikuara u konvertuan në aktivitete virtuale dhe u realizuan nëpërmjet platformave të ndryshme. Po ashtu u ngrit

¹² Po aty, neni 29.

¹³ Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13.

¹⁴ Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9.

¹⁵ Po aty, neni 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.

përçimi i mesazheve dhe i qëndrimeve të IAP-së, nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejt në media dhe nëpërmjet video spoteve.

Avokati i Popullit nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit bëri të ditur rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut edhe gjatë periudhës së pandemisë. Theks i veçantë iu dha informimit të publikut se të drejtat e njeriut kufizohen vetëm me ligj dhe që pandemia paraqet kërcënim për shëndetin publik, dhe si i tillë mund t'i justifikojë kufizimet ndaj të drejtave të caktuara, si: liria e lëvizjes, e tubimit etj. Në anën tjetër iu bë thirrje autoriteteve publike që ta respektojnë parimin e proporcionalitetit në caktimin e masave kufizuese në raport me të drejtat e njeriut. Qëndrimet e Avokatit të Popullit u paraqitën edhe nëpërmjet deklaratave të publikuara.

Në janar të vitit 2020, IAP-ja së bashku me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), mbajtën tri sesione informuese para gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve për të drejtat e njeriut të nivelit qendror dhe lokal për përdorimin e Platformës për të Drejtat e Njeriut dhe Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm. Platforma u publikua nga IAP-ja më 10 dhjetor 2019, në bashkëpunim me UNDP-në dhe me mbështetje financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. E njëjta ofron dy udhëzues që do të shërbejnë për të siguruar qasje më të lehtë dhe praktike në juridiksionin vendor dhe në atë ndërkombëtar përmes lidhjeve të strukturuar mes instrumenteve juridike dhe gjyqësore (praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, si dhe për të demonstruar lidhjet e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe për të drejtat e liritë themelore të njeriut. Gjatë sesioneve informuese për Platformën janë prezantuar edhe 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, përfshirë rolin dhe përgjegjësinë e shteteve për zbatimin e tyre.

Po ashtu, në janar Avokati i Popullit në bashkëpunim me UNDP-në prezantuan një udhëzues para gjyqtarëve, prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe zyrtarëve ligjorë lidhur me mundësitë dhe opsionet e kërkimit në koleksionin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – HUDOC. Udhëzuesi ofron sqarime lidhur me përmbajtjen e bazës së të dhënave dhe procesin e kërkimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), si dhe ofron shpjegime konkrete për filtrimin e informacioneve në bazë të shtetit, gjuhës, neneve të Konventës dhe opsione të tjera. Baza e të dhënave HUDOC (Human Rights Documentation) përmban aktgjykime, vendime, përmbledhje juridike dhe kumtesa për shtyp lidhur me rastet e vendosura nga GjEDNj-ja. Avokati i Popullit dhe UNDP-ja përmes këtij materiali synojnë që të avancojnë më tej zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në sektorin e drejtësisë në Kosovë. Ky udhëzues, i hartuar me mbështetje profesionale dhe financiare të UNDP-së dhe të Ambasadës norvegjeze në Kosovë, do t'i ndihmojë në veçanti zyrtarët ligjorë dhe bashkëpunëtorët profesionalë në gjykata dhe në prokurori në interpretimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore në frymën e nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Më 4 prill 2020, Avokati i Popullit, nëpërmjet komunikatës për media, ka reaguar lidhur me publikimin e disa lajmeve nga portalet, të cilat kanë publikuar lista me tabela që përmbanin emra dhe mbiemra dhe të dhëna të tjera personale për personat të cilët janë urdhëruar të izoloohen në karantinë, për shkak të koronavirusit. Avokati i Popullit u ka bërë thirrje mediave elektronike që t'i largonin lajmet në fjalë, në mënyrë që të mos ripublikoheshin nga portalet e tjera. Po ashtu, Avokati i Popullit kërkoi nga mediat dhe gazetarët që të bëjnë më shumë për mbrojtjen e të dhënave personale të personave në vetizolim, në karantinë, të diagnostikuar me COVID-19, dhe të hospitalizuar, përveç informatave që jepen me pëlqimin e vetë personit.

Më 30 prill 2020, Avokati i Popullit publikoi deklaratën lidhur me dhunën në familje gjatë pandemisë COVID-19. Avokati i Popullit tërhoqi vëmendjen te detyrimi i shtetit ndaj standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për të ushtruar kujdesin e duhur për parandalimin, hetimin, ndëshkimin dhe për të siguruar dëmshpërblim për veprat e dhunës, në përputhje me detyrimet e tyre sipas Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Më 3 maj 2020, me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, Avokati i Popullit publikoi komunikatë për media, nëpërmjet së cilës i konsideroi shqetësuese rastet në rritje gjatë vitit 2020 të kërcënimeve, sulmeve fizike, cenimit të sigurisë dhe pengimit të ushtrimit të lirë të profesionit. Përkundër rasteve kur policia dhe prokuroria kanë kryer punën e tyre në identifikimin e kryerësve të veprave kundrejt gazetarëve dhe i kanë proceduar tutje në organet e sistemit të drejtësisë, Avokati i Popullit tërhoq vëmendjen tek pandëshkueshmëria e rasteve kur gazetarët sulmohen, kërcënohen apo u pamundësohet kryerja e punës, gjë që krijon ambient të pasigurt për punën e mediave dhe tërthorazi e hap rrugën edhe për vetëcensurën e gazetarëve dhe të mediave. Në këtë frymë, Avokati i Popullit bëri thirrje për rrjedhë të lirë të mendimit, të fjalës dhe të informacionit dhe për reflektim përballë mendimeve të shprehura ndryshe, duke i konsideruar ato vlerë thelbësore të demokracisë, sistem të cilin Kosova e ka përqaftuar si shtet.

Më 17 maj 2020, me rastin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, Avokati i Popullit doli me deklaratë me anë të së cilës tërhoqi vëmendjen tek garantimi i të drejtave të personave të komuniteteve LGBTI, të cilët vazhdojnë të jenë ndër grupet më të cenuara në shoqërinë tonë. Nëpërmjet kësaj deklarate, Avokati i Popullit rikujton se garantitë kushtetuese për të drejtat e njeriut janë vlera themelore të një shoqërie demokratike, që i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë, dhe se këto vlera janë baza themelore për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Më 5 qershor 2020, Avokati i Popullit, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Mjedisit, publikoi komunikatën për media, nëpërmjet së cilës tërhoqi vëmendjen e të gjitha institucioneve në vend për nevojën e angazhimit më të thelluar për ndërmarrjen e masave konkrete dhe të nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen nga degradimi i mjedisit në vend, në mënyrë që të respektohet e drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Duke theksuar se e drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm është e garantuar me Kushtetutën

e vendit dhe si e tillë është e renditur ndër vlerat në të cilat bazohet rendi kushtetues, Avokati i Popullit i ftoi institucionet e vendit, e veçanërisht Kuvendin e Republikës së Kosovës, që të ushtrojë kontrolle efektive lidhur me zbatimin nga qeveria të standardeve dhe të legjislacionit mjedisor. Thirrja iu drejtua edhe organeve të pushtetit gjyqësor që qytetarëve t'u ofrojnë mbrojtje efektive gjyqësore lidhur me trajtimin e rasteve të iniciuara në gjykatë për cenim të të drejtave mjedisore.

Më 8 qershor 2020, Avokati i Popullit u takua me drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), nga i cili u njoftua lidhur me situatën e fundit e shkaktuar nga pandemia dhe numrin e madh të qytetarëve të infektuar me virusin COVID-19. Pas këtij takimi, Avokati i Popullit iu drejtua me apel qytetarëve të vendit për respektimin e masave kundër pandemisë, duke kërkuar respektimin në mënyrë rigorozë të masave të rekomanduara nga qeveria dhe nga IKShPK-ja.

Në shënimin e Ditës Ndërkombëtare në Mbështetje të Viktimave të Torturës, më 26 qershor 2020, Avokati i Popullit, përmes komunikatës për media, ua tërhoqi vëmendjen institucioneve përgjegjëse për zbatimin e nenit 27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cila thekson : *“Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.”* Gjithashtu, Avokati i Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, rikujtoi edhe Deklaratën e Parimeve për trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë globale COVID-19, e publikuar nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), më 20 mars 2020.¹⁶

Më 12 tetor 2020, në kuadër të shënimit të Javës së Krenarisë në Kosovë, Avokati i Popullit, nëpërmjet një deklarate për media, tërhoqi vëmendjen për garantimin e të drejtave themelore të njeriut për pjesëtarët e komunitetit LGBTI, të cilët janë ende një nga grupet më të cenueshme në shoqërinë tonë. Të angazhuar fuqishëm me idenë se qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në aspektin e dinjitetit dhe të të drejtave, Avokati i Popullit rikujtoi që të gjithë qytetarët e këtij vendi janë të barabartë dhe se shteti e ka për detyrë t'i mbrojtë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Më 25 nëntor 2020, Avokati i Popullit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, dhe me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik, ua rikujtoi institucioneve shtetërore detyrimet e tyre për t'u ofruar viktimave të dhunës mbrojtje të përshtatshme dhe të menjëhershme nga rreziku i dhunës. Me këtë rast, Avokati i Popullit konsideron si hap pozitiv përfshirjen e Konventës së Stambollit (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje) në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Konventa e përshekruan dhunën ndaj grave si “shkelje të të drejtave të njeriut” dhe si “formë diskriminimi”. Avokati i Popullit gjithashtu u bëri

¹⁶ <https://rm.coe.int/16809d569f>

thirrje të gjithë qytetarëve që dhuna në familje të raportohet te autoritetet, në mënyrë që t'u jepet mundësi institucioneve të veprojnë edhe gjatë kohës së pandemisë, sipas bazës ligjore ekzistuese.

Me rastin e fushatës “16 Ditët e Aktivizimit”, IAP-ja ka qenë pjesë e shumë aktiviteteve të organizuara nga institucionet vendore, ndërkombëtare dhe nga shoqëria civile.

Më 10 dhjetor 2020, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, Avokati i Popullit organizoi konferencën virtuale me karakter regjional, me temën: *“Të drejtat e njeriut në periudhën e pandemisë dhe roli i institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut”*. Qëllimi i konferencës ishte që të diskutohej për gjendjen e të drejtave të njeriut gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, si dhe për rolin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, dhe ishte një mundësi ku pjesëmarrësit do të mund t'i shkëmbenin përvojat dhe sfidat në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Në këtë konferencë morën pjesë autoritetet më të larta të vendit, ombudsmanët nga regjioni, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare.

Më 10 dhjetor 2020, në ceremoninë online të ndarjes së çmimit, e organizuar nga Zyra e Komisionarit për Gjuhët (ZKGj) në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), komisioni vlerësues shpërbleu Institucionin e Avokatit të Popullit me çmimin “Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve”.

Gjatë vitit raportues, vend të veçantë zuri promovimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet mediave. Temat që u prezantuan ishin: të drejtat e njeriut dhe roli i IAP-së, privatësia në periudhën e pandemisë, liria e lëvizjes, trajtimi pa diskriminim, dhuna në familje në periudhën e pandemisë, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara etj. Rol me rëndësi në promovimin e të drejtave të njeriut luajtën edhe publikimi në TV i video-spotëve me tema për të drejtat e njeriut.

Bashkëpunimi me institucionet vendore, me organizatat ndërkombëtare në Kosovë, me organizatat joqeveritare dhe promovimi i të drejtave të njeriut

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë organizuar dhe kanë marrë pjesë në tryeza diskutimi, në konferenca, në punëtori, në trajnime, në debate publike, në takime konsultative e tematike si dhe në aktivitete kulturore. Po ashtu, IAP-ja ka mbështetur aktivitete dhe fushata të organizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe nga organizatat joqeveritare. Shumë prej ngjarjeve të lartcekura janë realizuar në mënyrë virtuale.

Ka vazhduar bashkëpunimi dhe mbështetja e IAP-së nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, si: Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), UNICEF, Përfaqësuesi i Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), agjencitë e Kombeve të Bashkuara etj.

Në janar të këtij viti, IAP-ja dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit për vendosjen e bashkëpunimit institucional në fushën e statistikave dhe të indikatorëve për vlerësimin e progresit në të drejtat e njeriut dhe në zbatimin e Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030. Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet IAP-së dhe ASK-së synon grumbullimin e të dhënave statistikore dhe zbërthimin (disagregimin) e tyre, si një mënyrë për t'i adresuar sfidat me të cilat ballafaqohen grupet e synuara dhe të lëna anash. Treguesit janë mjet thelbësor për vlerësimin e progresit në të drejtat e njeriut dhe në zbatimin e Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

Më 23 tetor 2020, Avokati i Popullit priti në takim njoftues përfaqësuesit e agjencive të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i njohur ndryshe si Ekipi i Kombeve të Bashkuara i Kosovës (UNKT). Në këtë takim palët u pajtuan për rritjen e bashkëpunimit me qëllim të avancimit të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Më 26 nëntor 2020, Avokati i Popullit priti në takim shafen e zyrës së UN Women në Kosovë dhe bashkëpunëtorët e saj, i cili u mbajt në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizimit”, fushatë kjo e cila synonte të rriste vetëdijen për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Gjatë këtij takimi, theks i veçantë iu kushtua rëndësisë për përkrahjen e viktimave të dhunës në baza gjinore si dhe sigurimin e respektimit të të drejtave të viktimave të dhunës në familje. Bashkëpunimi mes Avokatit të Popullit dhe zyrës së UN Women në Kosovë për arritjen e progresit në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe përmirësimin e respektimit të të drejtave të grave në vend do të jetë i pashmangshëm.

Ka vazhduar projekti i financuar nga BE-ja: “*Mbështetja e BE-së për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës*”, i mbështetur nga Instrumenti për Ndhimë të Para-anëtarësimit (IPA II) për Kosovën. Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i kapaciteteve të IAP-së në mbrojtjen efektive dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në Kosovë dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, të autoriteteve publike dhe të shoqërisë civile për rolin e IAP-së në promovimin dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.

Ka vazhduar mbështetja e IAP-së nga OSBE-ja, në kuadër të projektit për fuqizimin e kapaciteteve të IAP-së. Ky projekt ka mbështetur IAP-në me tri video-spote promovuese kundër gjuhës së urrejtjes, kundër krimeve të urrejtjes dhe për ndërgjegjësimin e publikut kundër diskriminimit. Qëllimi i videove është rritja e ndërgjegjësimin të përgjithshëm lidhur me bazat e diskriminimit, për krimet e urrejtjes, për gjuhën e urrejtjes, si dhe inkurajimi i viktimave për raportimin e rasteve të diskriminimit dhe të krimit të urrejtjes tek institucionet kompetente. Gjatë muajit dhjetor 2020, video-spotet janë transmetuar në disa kanale televizive si dhe rrjete sociale.

Gjithashtu, në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizimit”, OSBE-ja në bashkëpunim me IAP-në kanë publikuar video-spote ndërgjegjësuese kundër ngacmimit seksual në vend të punës dhe ndërgjegjësimin e opinionit për bazat e mbrojtjes nga diskriminimi dhe nga trajtimi jo i barabartë.

IAP-ja po ashtu është njëra ndër përfitueset e projektit për Zhvillimin e Kapaciteteve Njerëzore (HCDF), për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), i cili mbështetet nga Qeveria e Luksemburgut dhe nga ajo e Norvegjisë.

IAP-ja është njëra nga përfitueset e projektit të Këshillit të Evropës, qëllimi i të cilit është fuqizimi i institucioneve të Kosovës në luftën kundër torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues. Në kuadër të këtij projekti synohet mbështetja e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në kuadër të IAP-së, në përmirësimin e kapaciteteve dhe të aftësive të stafit të MKPT-së në monitorimin e institucioneve të paraburgimit dhe ngritjen e aftësive të tyre për raportim, komunikimin dhe media, rritjen e bashkëpunimit dhe të ndërgjegjësimin midis palëve të interesuara përkatëse, duke siguruar se do të respektohen të drejtat e personave të privuar nga liria.

Po ashtu, nën mbështetjen e Këshillit të Evropës, IAP-ja është njëra ndër përfitueset e projektit “Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Ballkanin Perëndimor”.

Avokati i Popullit, me qëllim të luftimit të diskriminimit dhe të stigmatizimit të njerëzve të cilët kanë qenë ose janë të infektuar me COVID-19 dhe promovimin e rolit të IAP-së në luftimin e diskriminimit, nëpërmjet video-spotit u bë pjesë e fushatës “#dashniekujdes”.

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

Më 24 shkurt 2020, Avokati i Popullit me përfaqësuesit e tij priti në takim 30 fëmijë të shkollës fillore “Pavarësia” në Prishtinë. Në këtë takim fëmijëve iu dha mundësia që të shprehin mendimet, qëndrimet apo shqetësimet e tyre për probleme të ndryshme me të cilat ata ballafaqohen.

Më 25 shkurt 2020, IAP-ja zhvilloi fushatën informuese: “*Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit*”, për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës fillore dhe të mesme të ulët në fshatrat Vranidoll, Tenezhdoll dhe Sharban.

Gjatë muajit maj, IAP-ja së bashku me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me Lidhjen e Qendrave për Punë Sociale, publikuan Qëndrimin e Përbashkët për Grantin Specifik për Shërbime Sociale dhe Familjare. Ky qëndrim përmban propozimin dhe arsyetimin për krijimin dhe përfshirjen e Grantit Specifik për shërbime Sociale dhe Familjare, në kuadër të Ligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal.

Më 22 maj 2020, si rezultat i situatës me COVID-19, Avokati i Popullit në bashkëpunim me UNICEF-in dhe me KOMF-in dolën me një deklaratë të përbashkët për institucionet përkatëse përgjegjëse: “*T’u japim një shans të miturve*”, me thirrje që në afat sa më të shpejtë të mundshëm, aty ku janë plotësuar kushtet ligjore, të ndërmerren vendime, qoftë për zëvendësim apo shqyrtim të masave edukative institucionale, zëvendësim të paraburgimit, lirim të parakohshëm, lirim me kusht, apo edhe falje e dënimeve.

Më 25 maj 2020, IAP-ja iu bashkua fushatës #vizapërfëmijë dhe thirrjes për gjithpërfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara organizuar nga UNICEF Kosovo Programme dhe HANDIKOS.

Më 1 qershor 2020, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Avokati i Popullit doli me një deklaratë me të cilën tërhoqi vëmendjen e të gjithë akterëve dhe të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe kërkoi angazhim maksimal për mbrojtjen dhe garantimin e interesit më të mirë për fëmijët në Republikën e Kosovës.

Më 9 gusht 2020, IAP-ja, KOMF-i, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Lidhja e Qendrave për Punë Sociale publikuan Qëndrimin e përbashkët me propozimin për Hartimin e Draft Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Më 20 nëntor 2020, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Avokati i Popullit u bëri thirrje institucioneve të kujdesen për respektimin e të drejtave dhe për mirëqenien e fëmijëve. Posaçërisht kërkoi nga institucionet që me rastin e miratimit të pakove mbështetëse, të përfshijnë masa specifike për të mbështetur fëmijët në situatë rruge, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në gjendje të rëndë ekonomike, me kërkesë që këto masa të përcillen me financim të qëndrueshëm për t'iu përgjigjur krizës shëndetësore, sociale dhe ekonomike të shkaktuar nga COVID-19.

Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit

IAP-ja, për çdo ditë pune (nga e hëna deri në të premten) nga ora 08:00-16:00, në zyrat e saj pret qytetarët të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë ankesat e tyre me kujdes, me konfidencialitet dhe me profesionalizëm. Shërbimet e IAP-së janë falas dhe ofrohen nga stafi profesional.

Për ta lehtësuar qasjen në IAP të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP-ja ka edhe zyrat rajonale: në Gjilan, në Ferizaj, në Prizren, në Gjakovë, në Pejë, në Mitrovicën Jugore, në Mitrovicën e Veriore dhe në Graçanicë.

Përveç qasjes fizike të qytetarëve në zyrat e IAP-së, ekzistojnë edhe forma tjera të qasjes, siç janë: qasja nëpërmjet postës, nëpërmjet telefonit, nëpërmjet rrjetit social Facebook, nëpërmjet postës elektronike, e cila po përdoret gjithnjë e më shumë për parashtrimin e ankesave nga qytetarët. Në Zyrën Qendrore të IAP-së në Prishtinë ekziston edhe linja telefonike falas për rastet urgjente, por edhe për raste të tjera të zakonshme.

Zyrtarët e IAP-së realizojnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet, në qendrat e ndalimit policor dhe në qendrat e paraburgimit. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, me të paraburgosurit dhe me të ndaluarit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP-ja, qysh nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje,

përkatësisht në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur ta vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në entet dhe në qendrat e shëndetit mendor, gjë që lehtëson qasjen e ankuesve në IAP.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, pas përhapjes me ritme të shpejta dhe me pasoja të virusit COVID-19, shpalli gjendjen e pandemisë botërore.¹⁷ IKShPK-ja, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës që të merrte masa në përputhje me gjendjen e krijuar. Në zbatim të rekomandimeve të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim kishte shpallur “*emergjencë për shëndetin publik*” dhe kishte nxjerrë vendime për ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe kontrollimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, ku mes tjerash kishte kufizoi edhe lëvizjen e qytetarëve gjatë pandemisë. Në harmoni me rekomandimet të IKShPK-së dhe të vendimeve të qeverisë, edhe Avokati i Popullit ndërmori veprime në drejtim të reduktimit të stafit duke funksionuar vetëm me staf esencial dhe me punë nga distanca, si dhe pezullimin e punës së drejtpërdrejtë me ankues. Qytetarët janë njoftuar me kohë për mundësinë e parashtrimit të ankesave nëpërmjet postës elektronike dhe nëpërmjet telefonit.

¹⁷ <https://www.who.int/director-general/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-COVID-19,11-march-2020>

II. Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

II. Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

Pushteti legjislativ

Në Programin Legjislativ për vitin 2020¹⁸, Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë shqyrtimin dhe miratimin e 135 projektligjeve (97 ligje të reja dhe 38 projektligje për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese), mirëpo nuk ka arritur ta realizonte në tërësi programin. Në këtë program ishin planifikuar për ndryshim dhe plotësim 38 projektligje, apo 39.2% të tërë Programit Legjislativ. Për dallim nga vitet e fundit (viti 2018 - 31%, viti 2019 - 26%), në vitin 2020 vërehet ngritja e përqindjes së projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese, që në praktikë paraqet regres në qëndrueshmërinë e ligjeve, ngase ka numër më të madh të nismave për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese.

Avokati i Popullit ka vërejtur se Kuvendi i Republikës së Kosovës në aktivitetin e tij në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve në vitin 2020 ka miratuar 17 ligje. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se numri i vogël i ligjeve të miratuara nga Kuvendi është rezultat i funksionimit jo të mirëfilltë të Kuvendit dhe të qeverisë, për shkak të rrethanave politike dhe të atyre të shkaktuara nga pandemia COVID-19.

Një ndër ngjarjet më të veçanta që kanë ndodhur në procesin legjislativ gjatë vitit raportues është miratimi i Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 14 gusht 2020. Ligji ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 dhe është nxjerrë si rezultat i vlerësimeve të Gjykatës Kushtetuese me rastin e vendosjes në kërkesën e ngritur nga presidenti ndaj vendimit të qeverisë për masat kufizuese, respektivisht ndaj kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe të lirisë së tubimit.

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Avokati i Popullit, më 12 gusht 2020, ka publikuar Raport me rekomandime në lidhje me parandalimin e martesave të fëmijëve dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshimin dhe plotësimin e nenit 16, paragrafët 2 dhe 3, të Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht fshirjen e paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 16. Megjithatë Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të implementimit të rekomandimit në fjalë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 4 dhjetor 2020, ka miratuar Ligjin nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19. Ky ligj ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e disa ligjeve, me qëllim të mundësisht të rimëkëmbjes së ekonomisë së Republikës së Kosovës pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia COVID-19.

¹⁸ Programi Legjislativ për vitin 2020 është miratuar në mbledhjen e 5-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 1/05, të datës 15.6.2020, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin nr. 1/20, të datës 5.8.2020, me Vendimin nr. 9/24 dhe nr. 10/24, të datës 14.8.2020, me Vendimin 3/28, të datës 28.8.2020, me Vendimin 5/29 dhe nr. 12/29 të datës 9.9.2020, dhe me Vendimin 4/24, të datës 7.10.2020.

Avokati i Popullit, në Raportin Vjetor të vitit 2018¹⁹ dhe në Raportin Vjetor të vitit 2019²⁰, kishte vlerësuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të marrë masa në drejtim të ngritjes profesionale të stafit mbështetës të komisioneve, me qëllim të aftësimit të tyre për interpretimin e ligjeve. Një vlerësim i tillë ishte bazuar në faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e bën interpretimin e ligjeve dhe po shkaktonte paqartësi dhe moskuptim të frymës së ligjeve. Avokati i Popullit vazhdon ta përsërisë qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje, në mënyrë që Kuvendi të sigurojë ngritjen profesionale të stafit të tij, me qëllim të aftësimit të tyre në drejtim të interpretimit të ligjeve.

Avokati i Popullit, në Raportin Vjetor 2019, kishte theksuar se në ligjet e publikuara në Gazetën Zyrtare mungon njoftimi se dispozitat e ndonjë ligji janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Një rast konkret është identifikuar tek rasti i vlerësimit të përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese, me Aktgjykimin KO 157/18, më 28 mars 2018, kishte vlerësuar se dispozitat e sipërpërmendura të Ligjit për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës nuk ishin në pajtim me Kushtetutën dhe të njëjtat i ka shfuqizuar. Mirëpo një njoftim të tillë nuk e hasim në Gazetën Zyrtare ku rezulton se Ligji për Kryqin e Kuq, përkatësisht neni 14, paragrafi 1.7, gjendet në zbatim pa marrë parasysh se kjo dispozitë është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Të njëjtën situatë e kemi edhe te Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dispozitat e të cilat janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KO171/18, datë 20 maj 2019. Bëhet fjalë për nenin 4, paragrafi 1, në lidhje me nenin 3, paragrafi 1.1, nenin 6, paragrafi 1.3, dhe nenin 19, nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8, për të cilat Gjykata Kushtetuese kishte vendosur se nuk ishin në pajtim me Kushtetutën, e të cilat ende figurojnë në Gazetën Zyrtare sikur të ishin në fuqi.²¹

Sidoqoftë, kohëve të fundit vërehet se Gazeta Zyrtare ka filluar t'i vendosë njoftimet për aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me ligjet përkatëse. Vërehet se Gazeta Zyrtare ka vendosur në Gazetën Zyrtare njoftimin lidhur me Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, në të cilin figuron edhe Aktgjykimi KO 203/19 i Gjykatës Kushtetuese, me ç' rast ka vendosur për moszbatimin e disa dispozitave të këtij ligji nga institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës, mirëpo një gjë e tillë nuk haset edhe te rasti i Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të cilin Gjykata Kushtetuese ka publikuar aktgjykim me të cilin ka shfuqizuar disa dispozita të këtij ligji.

Prandaj Avokati i Popullit e sheh të nevojshme që ta përsërisë qëndrimin lidhur me këtë çështje, në mënyrë që ligjet të cilat shfuqizohen tërësisht ose pjesërisht nga Gjykata

¹⁹ Raporti Vjetor 2018 i Avokatit të Popullit, faqe 31.

²⁰ Raporti Vjetor 2019 i Avokatit të Popullit, faqe 22

²¹ Po aty, faqe 24.

Kushtetuese e Kosovës, në çastin e publikimit në Gazetën Zyrtare, të figurojë njoftimi për dispozitat e shfuqizuara me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese.

Sistemi gjyqësor

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut gjatë pandemisë COVID-19

Paraqitja e virusit COVID-19 në Republikën e Kosovës, në muajin mars të vitit 2020, paraqiti nevojën e ndërmarrjes së masave mbrojtëse shtetërore për ruajtjen e shëndetit publik. Qeveria e Republikës së Kosovës nxori vendime për gjendjen emergjente në shëndetin publik, me të cilat u kufizua puna e institucionet publike, e në disa edhe u ndalua plotësisht.²² Këto vendime patën ndikime negative edhe në funksionimin e gjyqësorit të vendit dhe u reduktua puna në gjykata²³ dhe në prokurori vetëm në shqyrtimin e rasteve ku përjashtohet publiku, në rastet urgjente dhe me staf të reduktuar të punëtorëve.²⁴

Kjo situatë e re në gjyqësor ndikoi në përkeqësimin e mëtejshëm, në efikasitetin e vendosjes së lëndëve gjyqësore në afate ligjore dhe ndikoi në rritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura në nivel vendi. Kjo do të afektojë në pakënaqësi të qytetarëve për të drejtat dhe për liritë e njeriut, për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre.

Sa i përket mandatit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në lëmin e gjyqësorit është i përcaktuar me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste dhe në procedurë ligjore të cilat janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me pretendimet për administrimin e drejtësisë, përkatësisht me rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore dhe mosekzekutim të vendimeve gjyqësore.²⁵

Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në procedurat gjyqësore të rasteve individuale, të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, me

²² Vendimi nr.01/07, datë 15.3.2020 dhe Vendimi nr.01/11, datë 15.3.2020, të Qeverisë së Republikës së Kosovës. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-nr.01-11.pdf>

²³ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Vendimi KGJK.nr. 52/2020, i datës 12 mars 2020 (linku: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/13755_Vendimi_Nr_52_2020_Kufizohen_perkohesisht_veprimtarit_gjyqesore.pdf); Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Vendimi KGJK.Nr. 83/2020*, maj 2020, burimi: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/57454_Vendimi_KGJK_Nr_83_2020_Shtohet_aktiviteti_punes_se_Keshillit_Gjyqesor_te_Kosoves_dhe_te_gjitha_Gjykatat_vendit.pdf

²⁴ Këshilli Prokurorial i Kosovës, “Vendim-Reduktohen esencialisht aktivitetet në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit”, mars 2020, burimi: <https://prokuroria-rks.org/kpk/lajm/4638> dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, Vendimi KPK.nr.462/2020, maj 2020, burimi: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Vendime/Vendim%20Nr.462.2020%20-%20Shtohen%20aktivitetet%20e%20pun%C3%ABs%20n%C3%AB%20sistem%C3%AB%20prokurorial.pdf>

²⁵ Shih Ligjin nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 8.

barazinë dhe me mbrojtjen nga diskriminimi si dhe të iniciojë konflikt administrativ atëherë kur është në interes të publikut të përgjithshëm.²⁶

Po ashtu Avokati i Popullit mund të ngre çështje në Gjykatën Kushtetuese në përputhje me Kushtetutën dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, të kërkojë prej Gjykatës Kushtetuese kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjeve, të dekreteve të presidentit dhe të kryeministrit, të rregulloreve të qeverisë dhe statuteve të komunave.²⁷

Zvarritja e procedurave gjyqësore

Avokati i Popullit, sikurse në vitet paraprake, vazhdon të pranojë ankesa ndaj gjykatave, me pretendimet për zvarritje të pajustificueshme në shqyrtimin/vendosjen e lëndëve të tyre nga gjykatat.

Ankesat e pranuar kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave lidhur me kontestet e natyrës civile, konteste pronësore, konteste nga marrëdhënia e punës, konflikte administrative, si dhe ankesa për moszekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore. Kjo gjendje vjen si pasojë e numrit të madh të rasteve të vjetra të pazgjdhura, pastaj nga paraqitja e rasteve të reja, nga prishja e vendimeve të gjykatave të shkallës së parë dhe kthimi i tyre në rishqyrtim dhe në rivendosje, me ç' rast lënda merr numër të ri dhe trajtohet si lëndë e re, nga numri i kufizuar i gjykatësve, kalimi i tyre në pozita dhe në nivele të tjera të gjykatës. Për më shumë, duhet theksuar se pandemia COVID-19 ishte një sfidë shtesë për sistemin gjyqësor, pasi për një periudhë të caktuar kohore, si pasojë e emergjencës shëndetësore, gjykatat i pezulluan seancat gjyqësore dhe punuan vetëm e staf esencial. Më tej u paraqiten situata kur gjykatat kishin staf të infektuar me COVID-19, prandaj të njëjtët u detyruan të mjekoheshin, disa të tjerë të karantinoeshin dhe të vetëzioloheshin, prandaj deri me lirimimin e masave dhe përmirësimin e gjendjes epidemiologjike, gjykatat punuan vetëm me raste të natyrës urgjente, prandaj kjo situatë solli ngarkesa të reja në gjykata dhe si rrjedhojë zvarritje të mëtutjeshme.

Sipas Raportit statistikor të KGjK-së, në fillim të vitit 2020 ishin gjithsej 248.250 lëndë të pazgjdhura, në të gjitha nivelet e gjykatave. Ndërsa në fund të vitit 2020 kanë arritur t'i zgjidhnin 72.145 lëndë të pazgjdhura, kishin mbetur 176.105 lëndë. Këto shënime sipas raportit janë tregues të qartë për gjendjen e rëndë në gjyqësorin e vendit lidhur me moszgjidhjen e lëndëve gjyqësore.

Në bazë të numrit të ankesave të paraqitura në IAP gjatë këtij viti raportues rezulton se qytetarët vazhdojnë të mos kenë besim në sistemin gjyqësor. Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar, ankesat ndaj gjykatave zënë vendin e dytë me 25% të numrit të përgjithshëm të ankesave. Ndërsa kur flasim për rastet e hapura dhe hetimet e zhvilluara, gjykatat janë me 27% të rasteve. Pra qytetarët edhe më tutje po vazhdojnë të përballen me

²⁶ Shih Ligjin nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, neni 10, par. 2, dhe neni 18.

²⁷ Shih Kushtetutën, neni 113, paragrafi 2.

zvarritje të procedurave për vendosjen e rasteve të tyre, në të gjitha shkallët të gjykatave. Sa u përket gjykatave të rregullta, duhet cekur se qytetarët kryesisht ankohen për zvarritje procedurash me vite të tëra.²⁸ Në këtë drejtim, Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka hetuar raste edhe për mosekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore²⁹, të cilat me vite nuk ishin përmbtuar nga gjykatat, prandaj këto vonesa ndikojnë negativisht në realizimin e të drejtave të garantuara dhe e zbehin edhe më shumë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Avokati i Popullit vëren se numri i madh i kërkesave për monitorim është tregues se ekziston edhe më tutje përshtypja e qytetarëve për mungesë të objektivitetit të gjyqtarëve gjatë vendosjes së rasteve të tyre.³⁰ Avokati i Popullit ka publikuar dy raporte me rekomandime dhe një Letër rekomandimi ndaj gjykatave.

Avokati i Popullit, sipas ligjit³¹, gjatë periudhës raportuese, në 4 raste është paraqitur në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, me çështjet e barazisë dhe me mbrojtjen nga diskriminimi.

Avokati i Popullit ka pranuar disa ankesa edhe ndaj prokurorive dhe nga rastet e hetuara në katër ankesa kanë përfunduar me raporte me rekomandime ndaj Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Avokati i Popullit edhe në këtë vit raportues vëren se ka pasur raste kur palëve ankuese u janë bllokuar llogaritë bankare si rezultat i procedurës përmbtuar nga gjykata, për shkak të shlyerjes së borxheve. Nga rastet e hetuara është konstatuar se edhe pse kreditori ishte shfrytëzues i pensionit, të hyrat monetare nga pensioni u janë bllokuar në procesin e ekzekutimit, në kundërshtim me ligjin përmbtuar³², ku përcaktohen kufizimet ligjore për shumatat të cilat nuk mund të jenë objekt i ekzekutimit. Këtë vit vlen të përmendet nxjerrja e udhëzimit nga Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me sqarimin e kompetencave mes gjykatave dhe përmbtuarve privatë. Me nxjerrjen e këtij udhëzuesi është sqaruar në mënyrë të qartë se vendimet gjyqësore lidhur me çështjet familjare, kthimin në punë të punëtorëve dhe të shërbyes civilë, si dhe kompensimin e të ardhurave personale, ekzekutohen nga gjykatat³³.

²⁸ Shih: IAP, A.nr.717/2020, kontest juridiko-civil vërtetim pronësie, i filluar në vitin 1992, pa një vendim përfundimtar deri në vitin 2009, me ç' rast pezullohet procedura, sepse vdes pala paditëse dhe në vitin 2019 vazhdohet procedura nga trashëgimtarët e tij, por tash me numër të ri të lëndës C.nr.150/19.

²⁹ Shih: IAP, A.nr.99/2020.

³⁰ Shih: IAP, A.nr.365/2020, IAP: A.nr.675/2020, IAP: A.nr.674/2020, IAP: A.nr.617/2020, IAP: A.nr.609/2020, IAP: A.nr.599/2020, IAP: A.nr.588/2020.

³¹ Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 9, përcakton: "Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi."

³² Ligji nr.04/L-139 për Procedurën Përmbtuar, neni 112, Kufizimi i përmbtuarit, paragrafi 1, përcakton: "Përmbtuarimi në të ardhurat personale, për shpërblimin në vend të pagës dhe për pensionin, mund të caktohet dhe zbatohet deri në gjysmën e lartësisë së tyre. Shuma që sekuestrohet do të kufizohet në pjesën që tejkalon shumën e ndihmës më të lartë sociale që paguhet brenda territorit ku debitori ka vendbanimin."

³³ Udhëzim nr.55/2020, datë 2.10.2020, Gjykata Supreme e Kosovës.

Një gjyqësor transparent, efikas dhe i pavarur është mekanizmi kryesor për të siguruar sundimin e ligjit, si një nga vlerat më të larta kushtetuese të Republikës së Kosovës, e cila konkretizohet përmes vendimeve gjyqësore, duke krijuar një kornizë për shoqëritë demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Bazuar në Ligjin për Gjykata³⁴, të gjitha gjykatat e vendit janë të obliguara që vendimet përfundimtare gjyqësore t'i publikojnë në faqet e tyre zyrtare duke caktuar edhe afatet ligjore. Publikimi i aktgjykimeve të gjykatave rrit transparencën e sistemit gjyqësor, që të jetë sa më llogaridhënës ndaj qytetarëve. Avokati i Popullit vëren se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një trend rritjeje të numrit të aktgjykimeve të publikuara. Sipas statistikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), deri më tash janë publikuar gjithsej 37.729 aktgjykime.

Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve

Ligji nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i jep kompetenca shtesë Avokatit të Popullit, ndër të cilat edhe: 1) kompetencën për t'i kërkuar Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës fillimin e procedurës disiplinore; 2) kompetencën për të ushtruar ankesë të Gjykata Supreme, në raste individuale.

Avokati i Popullit edhe në Raportin Vjetor për vitin 2019 ka theksuar se të dyja kompetencat e lartpërmendura janë kompetenca shtesë të Avokatit të Popullit, duke marrë parasysh Ligjin për Avokatin e Popullit, ligjet e tjera në fuqi dhe opinionin e Komisionit të Venecias.

Për sa i përket kompetencës për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore, Ligji 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 25, paragrafi 2, e njeh këtë kompetencë vetëm në një situatë specifike - në rastet e dështimit për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”* Megjithatë, siç u pa më sipër, ligji në diskutim e tejkalon këtë dispozitë dhe i jep Avokatit të Popullit kompetencën për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore edhe në raste të mosrespektimit të afatit për marrjen e vendimeve, si dhe në raste të hedhjes poshtë të ankesave pa plotësuar kushtet ligjore. Ndërsa për sa i përket kompetencës për të ushtruar ankesë tek Gjykata Supreme, situata qëndron edhe më e dallueshme, pasi duke i dhënë Avokatit të Popullit kompetencën për të iniciuar ankesa drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme në raste të caktuara, ligji në diskutim tejkalon jo vetëm standardet ndërkombëtare

³⁴ Ligji nr.06/L-054 për Gjykatat, neni 6, Vendimet e Gjykatës, paragrafi 3, përcakton: *“Gjykatat publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.”*

sipas Komisionit të Venecias³⁵, por edhe kompetencat e deritanishme të Avokatit të Popullit, sipas ligjeve të mëparshme të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16, paragrafi 8, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe nuk mund të ndërhyjë në rastet dhe në procedurat e tjera ligjore të cilat janë duke u zhvilluar nëpër gjykata, përveç rasteve kur ka zvarritje të procedurave. Sipas ligjeve në fuqi, Avokati i Popullit në raport me pushtetin gjyqësor ka të drejtë: 1) t'i iniciojë rastet gjyqësore në raste të përgjithshme, por jo në raste të individëve, ose 2) të ndërhyjë në raste të individëve, por jo të iniciojë ankesa në raste të tilla. Për shembull, Avokati i Popullit:

- mund të paraqesë argumente në mbështetje të ndonjë pale në procedurë gjyqësore, në cilësinë e *amicus curiae*,³⁶ por jo edhe të iniciojë ankesa në emër të asaj pale;
- mund të iniciojë konflikt administrativ në mbrojtje të interesave publike,³⁷ por jo edhe në rastet e individëve; dhe
- mund të kërkojë prej Gjykatës Kushtetuese kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, të dekretëve të presidentit dhe të kryeministrit, të rregulloreve të qeverisë dhe të statuteve të komunës³⁸.

Gjatë vitit raportues, duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Avokati i Popullit ka pranuar 15 ankesa, të cilat i ka proceduar ashtu siç e përcakton ligji i lartpërmendur. Prej këtyre ankesave, 11 ankesa janë shpallur të pranueshme dhe 4 ankesa janë shpallur të papranueshme. Vlen të theksohet se Avokati i Popullit në të gjitha këto raste, brenda afatit ligjor, ka pranuar përgjigje nga autoritetet përgjegjëse dhe ka pasur bashkëpunim të mirë.

Pushteti ekzekutiv

Puna e pushtetit ekzekutiv për vitin raportues pa dyshim është karakterizuar në masë të madhe me pandeminë COVID-19 dhe ndikimin e saj në punën e pushtetit ekzekutiv.

Pandemia COVID-19 paraqet një sfidë të paprecedent për të drejtat e njeriut në mbarë botën. Rrethanat e krijuara me virusin COVID-19 dhe rrezikshmërinë që ai paraqet për jetën dhe për shëndetin e qytetarëve kërkojnë një balancim në mes të së drejtës për jetën, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë dhe të drejtave të tjera për të cilat Kushtetuta dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut i lejojnë kufizimet, në rrethana të caktuara. Avokati i Popullit konsideron se pandemia COVID-19 bie në fushën e përkufizimeve të kërcënimit të shëndetit dhe të jetës së qytetarëve dhe shteti është i obliguar që të ndërmarrë masa në

³⁵ CDL-AD(2007) 024, *Opinion on the draft law on the People's Advocate of Kosovo adopted by the Venice Commission at its 71st Plenary Meeting* (Venecia, 1-2 qershor 2007), §19).

³⁶ Shih Ligjin për Avokatin e Popullit, neni 16, par. 9, dhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 9, par. 2, nënpar. 13.

³⁷ Shih Ligjin për Konfliktet Administrative, neni 10, par. 2.

³⁸ Shih Kushtetutën, neni 113, par. 2.

mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të tyre, ku mes tjerash dhe në përgjithësi ishte edhe qëndrimi i Avokatit të Popullit i shprehur në dy opinione, të cilat ia ka dërguar Gjykatës Kushtetuese lidhur me vendimet e qeverisë, që kishin të bënin me kufizimin e së drejtës së lëvizjes dhe të lirisë së tubimit.

Më 31 janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) shpalli gjendjen e emergjencës shëndetësore globale, për shkak të përhapjes së virusit COVID-19. Më pas, si pasojë e përhapjes së tij me ritme e pasoja të paparashikuara, më 11 mars 2020, OBSh-ja shpalli gjendjen e pandemisë botërore.

Më 13 mars 2020 u konfirmuan dy rastet e para me COVID-19 në Kosovë dhe si rrjedhojë Qeveria e Republikës së Kosovës filloi marrjen e masave të para për parandalimin e përhapjes së këtij virusi.

Më 30 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendim nr. 01/19, me të cilin ka aprovuar Pakon Emergjente Fiskale. Më 3 prill 2020 ka nxjerrë Vendimin nr. 31/2020, me të cilin ka aprovuar Planin operues të Pakos Emergjente. Ndërsa më 17 prill 2020 ka nxjerrë Vendimin nr. 06/25 për plotësimin e Pakos Emergjente Fiskale.

Ajo që vërehet nga raportimet në media lidhur me zbatimin e Pakos Emergjente Fiskale është se aplikimi për përfitim nga disa masa ka qenë procedurë e komplikuar.³⁹ Po ashtu, nga raportimet në media është vërejtur se ka pasur vonesa në zbatimin e pagesave për masat përkatëse të Pakos Emergjente Fiskale. Pastaj ka pasur vonesa të pagave të disa punëtorëve nga Pakoja Emergjente Fiskale për faktin se të dhënat e tyre janë ngarkuar gabimisht në sistem gjatë aplikimit për të përfituar nga kjo pako etj. Në këtë çështje, edhe te Avokati i Popullit janë paraqitur ankesa individuale, të cilat janë në hetim.

Më 15 prill 2020, me vendim të qeverisë kanë hyrë në fuqi masa rigoroze të kufizimit të lëvizjes. Avokati i Popullit e ka ndjekur me vëmendje nxjerrjen e vendimeve nga qeveria, me qëllim të vendosjes së masave kufizuese për mbrojtjen e shëndetit publik nga pandemia COVID-19.

Avokati i Popullit, nga data 15 mars deri më 31 dhjetor, ka pranuar 64 ankesa që ndërlidhen me pandeminë, prej të cilave 39 janë hapur për hetim. Ndërsa sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*) ka hapur 9 raste lidhur me situatën e pandemisë, si në vijim:

Rasti i arrestimit të qytetarëve për mosrespektim të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë, i datës 14 prill 2020:⁴⁰

Bazuar në kërkesën urgjente të Gjykatës Kushtetuese për paraqitje të komenteve lidhur me caktimin e masës së përkohshme që ka të bëjë me kërkesën e presidentit të Republikës së Kosovës, përmes së cilës presidenti, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës, ka kërkuar nga

³⁹ <https://kosovotwopointzero.com/brengat-karshi-pakos-emergjente-fiskale/>

⁴⁰ Rasti nr. 310/2020.

gjkata që të bëjë: “Vlerësimin e çështjes së përputhshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/15, dt. 23/03/2020, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore që mbrohen me Kushtetutë.”⁴¹ Lidhur me rastin, Avokati i Popullit ka dërguar Opinion në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me lëndën nr. KO 54/20, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për regjistrimin e kërkesës për paraqitjen e komenteve me nr. reference KK 57/19, të datës 24 mars 2020.

Rasti lidhur me vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë për kufizimin e lirisë së lëvizjes gjatë kohës së pandemisë (Vendimi nr. 2381IV/2020, datë 14.4.2020, Vendimi nr. 229/IV/2020, datë 14.4.2020, Vendimi nr. 2141IV/2020, datë 12.4.2020, Vendimi nr. 2391IV/2020, datë 14.4.2020).⁴² Avokati i Popullit ka dërguar Opinion lidhur me lëndën nr. KO 61/20, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për regjistrimin e kërkesës për paraqitjen e komenteve me Nr. ref. : KK 82/20, datë 20 prill 2020.

Rasti lidhur me kufizimin e së drejtës së privatësisë së qytetarëve të afektuar me COVID-19, nga publikimi i të dhënave të tyre nga mediat dhe nga gazetarët.⁴³

Rasti lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19.⁴⁴

Rasti lidhur Vendimin e nr.31/2020, i datës 3.4.2020, i Ministrisë së Financave për aprovimin e Planit Operacional për Pakon Emergjente Fiskale.⁴⁵

Rasti lidhur licencimin e laboratorëve privatë për testime PCR dhe serologjike nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.⁴⁶

Rasti i A. G., i cili humbi jetën më 3 maj 2020 derisa po mbahej në karantinë në Qendrën e Studentëve, në kohën e pandemisë COVID-19.⁴⁷

Rasti përkitazi me cenimin e të drejtave të personave që janë të afektuar nga HIV/AIDS dhe Tuberkulozi (TB) në Kosovë në kontekst të SDG3, gjegjësisht të Mbulueshmërisë Universale të Shëndetit (Universal Health Coverage), duke përfshirë edhe të drejtat e tyre gjatë pandemisë me COVID-19 në Republikën e Kosovës.⁴⁸

Avokati i Popullit ka dërguar rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë dhe për IKShPK-në, që kanë të bëjnë me ankesën e RTV “KiM” nga Çagllavica,⁴⁹ sipas të cilës MSh-ja dhe IKShPK-ja, nëpërmjet ueb-faqeve të tyre zyrtare, nuk informojnë edhe në gjuhën serbe

⁴¹ Rasti nr. 252/2020.

⁴² Rasti nr. 287/2020.

⁴³ Rasti nr. 256/2020.

⁴⁴ Rasti nr. 434/2020.

⁴⁵ Rasti nr. 488/2020.

⁴⁶ Rasti nr. 489/2020.

⁴⁷ Rasti nr. 704/2020.

⁴⁸ Rasti nr. 698/2020.

⁴⁹ Rasti nr. 250/2020.

qytetarët dhe publikun lidhur situatën emergjente për shëndetin publik të shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar MSh-së dhe IKShPK-së që të veprojnë në përputhje me dispozitat e nenit 5, paragrafi 1, të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, në mënyrë që qytetarët dhe publikun, në kohën e duhur dhe të menjëhershme, përmes ueb-faqeve të tyre zyrtare, t'i informojnë në të dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e lartpërmendura kushtetuese dhe ligjore.

Avokati i Popullit ka lëshuar edhe një Opinion lidhur me kërkesat për lirim të burgosurve të kategorive të caktuara në kohë pandemie COVID-19.⁵⁰ Përmes këtij Opinioni, Avokati i Popullit, mes tjerash, ua ka rikujtuar të gjitha organeve kompetente të Republikës së Kosovës, të cilat janë përgjegjëse për personat e privuar nga liria, natyrën absolute të ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, e cila parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin relevant vendor, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Sa u përket çështjeve që nuk ndërlidhen me pandeminë COVID-19, Avokati i Popullit ka nxjerrë në vijim rekomandime dhe ka shprehur qëndrimet e tij lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut:

Për Komunën e Prishtinës, për Inspektoratin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në lidhje me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm⁵¹, me ç' rast u ka rekomanduar autoriteteve përgjegjëse që ta sanojnë burimin e ndotjes, në mënyrë që t'u sigurohet banorëve të lagjes⁵² mjedis i pastër, i sigurt dhe i shëndetshëm.

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, në lidhje me çështjen e prezumimit të pafajësisë. Avokati i Popullit ka tërhequr vërejtjen për detyrimet kushtetuese dhe ligjore të organeve kompetente për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si një nga të drejtat themelore dhe garancitë kryesore për çdo person, si dhe respektimin e prezumimit të pafajësisë lidhur me njohjen efektive të të drejtave të personave të dyshuar dhe të akuzuar, siç është *e drejta e tyre për punësim*.⁵³

Për Komunën e Graçanicës, për Komunën e Prishtinës dhe për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në lidhje me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si pasojë e ndotjes së lumit Graçanka. Avokati i Popullit u ka rekomanduar autoriteteve përgjegjëse që

⁵⁰ Rasti nr. 38/2020.

⁵¹ A.nr. 342/2018.

⁵² Lagja Mati 1.

⁵³ A.nr. 314/2018.

t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe efektive për frenimin e ndotjes dhe pastrimin e lumit Graçanka.⁵⁴

Për Ministrinë e Infrastrukturës lidhur me mungesën e ofrimit të qasjes së barabartë në transportin ndërrurban të personave të verbër, në pajtim me Ligjin nr.04/L-092 për Personat e Verbër në Kosovë.⁵⁵

Për Komunën e Kamenicës dhe për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në lidhje me riorganizimin në arsimin parauniversitar në komunën e Kamenicës.⁵⁶

Për komunat e Kosovës (Komuna e Prishtinës, Komuna e Graçanicës, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Mitrovicës së Jugut, Komuna e Vushtrrisë, Komuna e Ferizajt, Komuna e Pejës, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Gjakovës, Komuna e Klinës dhe Komuna e Istogut) në lidhje me identitetin ligjor për personat e paregjistruar.⁵⁷

Për Komisionin e Ankesave për të Huajt, në lidhje me refuzimin e kërkesës së ankuesit për leje qëndrimi në Republikën e Kosovës.⁵⁸

Për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe për të gjitha komunat e Kosovës, në lidhje me rrezikun që u kanoset qytetarëve nga qentë endacakë.⁵⁹

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me konfirmimin e saktësisë dhe vërtetësisë e diplomave të fituara jashtë vendi, si kriter i konkurseve që shpallen nga kjo ministri.⁶⁰

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me aplikimin e parimeve kryesore përkitazi me detyrimet themelore për hetime efektive brenda një afati të arsyeshëm kohor. Avokati i Popullit i ka rekomanduar MPB-së nxjerrjen e një udhëzimi me të cilin do të kërkojë nga IPK-ja që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, me Kodin Penal, me Kodin e Procedurës Penale, si dhe me ligjet dhe me aktet nënligjore në fuqi dhe t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të IPK-së, në kuptim të zbatimit praktik të ligjit dhe të respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.⁶¹

Për Policinë e Kosovës, lidhur me zbatimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për masën e sigurisë (C.nr.1140/17, i datës 8 nëntor 2017).⁶²

⁵⁴ Rasti ex-officio nr.631/2019.

⁵⁵ A.nr. 899/2018.

⁵⁶ Rasti ex-officio nr.720/2019.

⁵⁷ Rasti ex officio 148/2020.

⁵⁸ A.nr. 555/2020.

⁵⁹ Rasti ex officio 517/2019.

⁶⁰ A.nr. 737/2019.

⁶¹ A.nr. 717/2019.

⁶² A.nr. 866/2019.

Për Drejtorinë Komunale të Arsimit në Vushtri lidhur me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për sigurimin përkatës të transportit publik për fëmijët e ankuesit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.⁶³

Për Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë dhe për Inspektoratin e Arsimit, lidhur me ankesën individuale, me ç' rast mes tjerash u është rekomanduar të veprojnë në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe me Ligjin për Inspektoratin e Arsimit të Republikës së Kosovës.⁶⁴

Për Ministrinë e Drejtësisë, lidhur me miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të Udhëzimit Administrativ për tarifat për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbaruesit privatë, i cili rrjedh sipas obligimeve të Ligjit nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (neni 32).⁶⁵

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, lidhur me çështjen e verifikimit të diplomave dhe të miratimit të udhëzimeve unike që çështja e njohjes së diplomave të shkollave të mesme të shqyrtohet nga institucionet kompetente, me qëllim të inicimit të aktiviteteve të caktuara dhe gjetjes së një zgjidhjeje të zbatueshme për të gjithë qytetarët, të cilët kanë marrë diploma të shkollave të mesme në Kosovë në gjuhën serbe.⁶⁶

Për Komunën e Prishtinës, lidhur me mungesën e kushteve adekuate për realizimin e procesit mësimor në shkollën “Nëna Terezë” në fshatin Vranidoll, komuna e Prishtinës.⁶⁷

Për Komunën e Ferizajt, me rastin e manifestimit të vullneti të tyre nëpërmjet aktit administrativ, t'i përmbahen në përpikëri Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.⁶⁸

Për Ministrinë e Infrastrukturës, për Komunën e Prishtinës, për Komunën e Fushë Kosovës, për Komunën e Kllokotit, për Komunën e Gjilanit, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, lidhur me shkeljen e së drejtës për qasje në dokumente publike.⁶⁹

Reforma në administratën publike

Avokati i Popullit, në fund të vitit 2019, kishte ngritur në Gjykatën Kushtetuese çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.

Gjatë vitit për të cilin po raportohet, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur lidhur me kërkesat e Avokatit të Popullit.

⁶³ A.nr.457/2019.

⁶⁴ A.nr.953/2019.

⁶⁵ A.nr.396/2017.

⁶⁶ A.nr.210/2019.

⁶⁷ Rasti ex officio nr. 249/2020.

⁶⁸ A.nr.185/2020.

⁶⁹ A.nr.763/2019; A.nr.508/2019; A.nr.314/2019; A.nr.694/2019; A.nr.280/2020.

Më 30 qershor 2020, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë Aktgjykimin KO 203/19 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Gjykata vendosi që kërkesa të pranohej për shqyrtim në merita; që nenet e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të kontestuara nga Avokati i Popullit, nuk janë në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 108, 109, 110, 115, 132, 136, 139, 140 dhe 141 të Kushtetutës; që ligji i kontestuar nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; me Këshillin Prokurorial të Kosovës; me Gjykatën Kushtetuese; me Institucionin e Avokatit të Popullit; me Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë; që ligji i kontestuar nuk cenon dispozitat e Kushtetutës në raport me Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës; dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në harmoni me gjetjet e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, sa u përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën (iii) të aktgjykimit.

Më 30 qershor 2020, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë Aktgjykimin KO219/19 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, Gjykata vendosi: kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; që Ligji i kontestuar, në tërësinë e tij, nuk është në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 103, 108, 109, 110 të Kapitullit VII, as me nenin 115 të Kapitullit VIII të Kushtetutës; as me nenet 132, 136, 139 dhe 141 të Kapitullit XII të Kushtetutës, si dhe shpalli të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.

Institucionet e pavarura dhe agjencitë

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka lëshuar rekomandime për institucionet e pavarura dhe për agjencitë, si në vijim:

Për Bankën Qendrore të Kosovës, në lidhje me ndryshimin e nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores mbi Implementimin e Sistemit Bonus-Malus. Rregullorja mbi Implementimin e Sistemit Bonus-Malus, e cila ka dalë nga Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nuk e ka bartur frymën e ligjit sa i përket sistemit bonus-malus. Avokati i Popullit ka vërejtur se dispozita e Rregullores mbi Implementimin e Sistemit Bonus-Malus (neni 4, paragrafi 1) është në kundërshtim me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, por edhe në kundërshtim me Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, sa i përket çështjes së dëmshpërblimit. Prandaj i ka rekomanduar BQK-së ta ndryshojë Rregulloren mbi Implementimin e Sistemit Bonus-Malus, përkatësisht ta ndryshojë nenin 4, paragrafi 1, duke e riformuluar si në vijim: *“E drejta për një shkallë të caktuar të premisë (bonus-malus) lidhet me pronarin e automjetit dhe nuk kalon te pronari i ri.”* Kjo për shkak

se sipas Rregullores, kompanitë e sigurimeve, në rast të aksidentit në komunikacion, në situatat kur ngasësi i automjetit nuk është pronar, e gjobisin ngasësin dhe pronarin e automjetit. Rekomandimi i Avokatit të Popullit nuk është zbatuar nga BQK-ja gjatë vitit raportues.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil (ACC), në lidhje me ankesën për diskriminim në punë. ACC-ja ka nxjerrë Rregulloren e Organizimit të Brendshëm, me anë të së cilës fillon me risistemimin e stafit menaxhues në pozita të reja, duke nxjerrë vendime individuale, me ç' rast janë degraduar dhe janë ulur pozitat e 4 nga 6 drejtorët e departamenteve në ACC. Avokati i Popullit ka konstatuar se zbatimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm, datë 9 korrik 2019, në ACC nuk është në përputhje me Ligjin nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Prandaj Avokati i Popullit kishte i rekomanduar ACC-së t'i anulonte vendimet kontestuese, ta zbatonte legjislacioni në fuqi dhe t'i eliminonte të gjitha shkeljet ligjore të konstatuara nga Avokati i Popullit si dhe ta respektonte Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë zbatuar nga ACC-ja gjatë vitit raportues.

Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), lidhur me zbatimin e Ligjit nr.05/L-020 për Barazi Gjinore përkitazi me kuotën gjinore minimale prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, në pozitat drejtuese dhe vendimmarrëse në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Rekomandimi i Avokatit të Popullit nuk është zbatuar nga AKP-ja gjatë vitit raportues.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, në vitin 2015 miratuan 17 objektivat, si pjesë e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e cila përcaktoi një plan 15-vjeçar për t'i arritur këto qëllime. Në fakt, 17 objektivat kërkojnë të ndërtojnë dhe të plotësojnë atë që nuk është arritur me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, miratuara në vitin 2000.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, nga këndvështrimi i Avokatit të Popullit, si pikënisje ka Deklaratën e Meridas, me të cilën është përcaktuar edhe roli i Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut në zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Me organizmin e Komisionit Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në Meksikë, në bashkëpunim edhe me Zyrën e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në Merida, Jukatan, Meksikë, nga data 8 deri më 10 tetor 2015 u mbajt Konferenca e 12 e Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut. Në këtë konferencë u miratua edhe Deklarata e Meridas.

Sipas përmbajtjes së deklaratës, pjesëmarrësit e konferencës mirëpritën miratimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, si rezultat i një procesi global. 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe 169 synimet e

tyre pasqyrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë standardet e të drejtave të njeriut⁷⁰ dhe integrojnë parimet ndërsektoriale të të drejtave të njeriut, siç janë: pjesëmarrja, përgjegjësia dhe mosdiskriminimi.

Republika e Kosovës ka treguar përkushtimin e saj në zbatimin e këtij plani global. Në këtë drejtim, më 25 janar 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me propozimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ka nxjerrë Rezolutë Nr. 06-R-001 për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke marrë përsipër edhe angazhimin për të ndihmuar zbatimin e *“...kësaj kornize të re globale nëpërmjet miratimit të legjislacionit, duke përfshirë edhe miratimin në kohë të buxhetit të nevojshëm.”*

Kuvendi i Republikës së Kosovës rithemloi Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili kishte filluar punën në vitin 2018, por për shkak të zhvillimeve politike nuk kishte arritur planifikimet e parapara. Riaktivizimi i Këshillit u mundësua bazuar në bashkëpunimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuar. Duke treguar përkushtimin e Kuvendit, siç e theksoi edhe kryetarja e Kuvendit me këtë rast: *“... zbatimi i agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm është një obligim moral për të siguruar një të tashme më të mirë dhe për një të ardhme më të sigurt me mirëqenie pa dallim.”*

Avokati i Popullit, si institucion kushtetues me mandat për mbrojtje dhe promovim të të drejtave dhe të lirive të njeriut në Kosovë, dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), si institucion profesional dhe i pavarur, i cili bashkërendon sistemin statistikor të Kosovës, më 17 janar 2020 nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim të identifikimit dhe të prodhimit të treguesve përkatës, përfshirë treguesit kontekstualë relevantë, të cilët bazohen në udhëzimet mbi treguesit e të drejtave të njeriut dhe në Qasjen ndaj të Dhënave të Bazuara në të Drejtat e Njeriut (HRBAD), të përpiluar nga Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (OHCHR).

IAP-ja dhe ASK-ja janë mbështetur nga Zyra për të Drejta të Njeriut e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, respektivisht nga OHCHR-ja në Gjenevë, nëpërmjet një punëtorie, me temën: *“Operacionalizimi i qasjes bazuar në të drejta të njeriut ndaj të dhënave dhe indikatorëve në Kosovë”*, si rezultat i së cilës është përpiluar formati fillestar i Memorandumit të Mirëkuptimit i finalizuar me nënshkrimin dypalësh.

Treguesit janë mjet thelbësor për vlerësimin e progresit në të drejta të njeriut dhe në zbatimin e Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030. Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet IAP-së dhe ASK-së synon grumbullimin e të dhënave statistikore dhe zbërthimin e tyre, si një mënyrë për t'i adresuar sfidat me të cilat ballafaqohen grupet e synuara dhe të lëna anash. Të dy grupet punuese janë duke zhvilluar takime dhe janë në vazhden e angazhimit dhe të bashkëpunimit reciprok për t'i arritur qëllimet e përbashkëta.

⁷⁰ Shih: <http://www.humanrights.dk/human-rights-guide-sdgs>

Në janar të vitit për të cilin po raportohet, IAP-ja realizoi tri sesione informuese për Agjendën 2030. Në tri tryeza të organizuara nga IAP-ja në bashkëpunim me UNDP, para gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve për të drejtat e njeriut të nivelit qendror dhe lokal, përveç Platformës për të Drejtat e Njeriut, u prezantua edhe Agjenda 2030 dhe 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm. Theks i veçantë gjatë informimit dhe promovimit për synimet e Agjendës 2030 u vu mbi rëndësinë dhe përgjegjësinë e akterëve shtetërorë drejt përmbushjes dhe zbatimit të saj në vend.

Duke qenë se OZhQ-ja mund të kontribuojë ndjeshëm në realizimin dhe në përmbushjen e të drejtave të njeriut, IAP-ja, në kuadër të Platformës për të Drejtat e Njeriut⁷¹, ka zhvilluar *“Udhëzuesin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në lidhje me të Drejtat e Njeriut”*. Ky udhëzues i formatit elektronik ofron lidhjen thelbësore të 169 synimeve në kuadër të 17 Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës dhe në legjislacionin e zbatuar parësor. Udhëzuesi është efikas për ta kuptuar lidhjen e OZhQ-së me të drejtat dhe me liritë themelore të njeriut dhe për t'i kuptuar lidhjet e strukturuara ndërmjet OZhQ-së dhe instrumenteve juridike të theksuara më lart. Përveç promovimit të OZhQ-së, udhëzuesi synon të ndihmojë në zhvillimin e programeve dhe të strategjive nacionale për zbatimin e Agjendës 2030, gjithashtu mund të ndihmojë në zhvillimin e projekteve të ndryshme, në hulumtime dhe në raportime drejt arritjes së Agjendës 2030.

Përgjegjësia për mjedisin jetësor

Përmirësimi i gjendjes në mjedis dhe në ambient, nevoja për investime në mjedis dhe mbrojtja e tij janë përgjegjësi kushtetuese të shtetit.⁷²

Përkundër nevojave të pashmangshme për orientimin e politikave të shtetit në parandalimin dhe sanimin e problemeve mjedisore, fakti që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), si organ kompetent për krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm të fushës së mjedisit, të ujërave, të planifikimit hapësinor dhe të ndërtimit e banimit, është fuzionuar me Ministrinë e Infrastrukturës (Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit) dhe më vonë me Ministrinë e Ekonomisë (Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit), tregon mungesën e politikave të qëndrueshme, të cilat do të shënonin hap para në ndryshimin e gjendjes së mjedisit në vend, duke mos i dhënë prioritet të veçantë çështjes së mjedisit.

Kanë vazhduar pakënaqësitë dhe reagimet e publikut lidhur me operimin dhe instalimin e hidrocentraleve. Problem më vete në këtë drejtim është mungesa e transparencës dhe e

⁷¹ Platforma për të Drejtat e Njeriut u publikua nga IAP-ja, më 10 dhjetor 2019, në bashkëpunim me UNDP-në dhe me mbështetje financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. E njëjta ofron dy udhëzues që do të shërbejnë për të siguruar qasje më të lehtë dhe praktike në juridiksionin vendor dhe në atë ndërkombëtar përmes lidhjeve të strukturuar mes instrumenteve juridike, të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, si dhe për të demonstruar lidhjet ndërmjet OZhQ-së dhe të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Në vazhdim linku për qasje në Platformë: <https://humanrights.oik-rks.org/>

⁷² Neni 52 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

llogaridhënies së organeve kompetente. Nuk është regjistruar përmirësim sa i përket çështjes së fragmentimit dhe ndërhyrjeve në tokën bujqësore⁷³ dhe shkatërrimit të sipërfaqeve pyjore. Respektimi i tri parimeve procedurale të së drejtës mjedisore, parimi i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, qasja në informata mjedisore, si dhe parimi i qasjes në drejtësi, kanë vazhduar të përcillen me pengesa dhe paqartësi. Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe respektimi i tri parimeve të lartpërmendura jo vetëm që do t'i parandalonte dhe do t'i zvogëlonte ndikimet negative të projekteve në mjedis, por në të njëjtën kohë do të kontribuonte në mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Organet kompetente edhe në këtë vit nuk ndërmorën veprime parandaluese, e as të sanimit të gjendjes së krijuar për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor. Nuk u vërejt ndonjë ndryshim në përmirësimin e koordinimit të bashkëpunimit të inspektorateve të nivelit qendror dhe lokal, e as të organeve të ndryshme kompetente për zbatimin e legjislacionit mjedisor dhe zgjidhjeve efektive të parregullsisë që kanë të bëjnë me mjedisin. Për më tepër, masat mbrojtëse nga pandemia ndikuan në zbehjen e punës së inspektorateve.

Taksa ekologjike, e paraparë me Ligjin për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve⁷⁴, e cila ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së ambientit vazhdon të mos shfrytëzohet sipas dedikimit të mbledhur.

Situata e krijuar nga pandemia reduktoi hapësirën për promovimin dhe edukimin e publikut për të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Edhe pse mbetet të fuqizohet roli i mediave në drejtim të vetëdijesimit dhe të edukimit të publikut për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, viti 2020 ka shënuar hap para. Është vërejtur hapësirë më e madhe mediale dhe forma të tjera të informimit lidhur me zhvillimet mjedisore në vend. Gazetaria hulumtuese ka sjellë në diskutim në publik debat për tema jo shumë të njohura për publikun dhe përbën progres në zhvillimin e demokracisë mjedisore. Edhe pse ende nuk është arritur të krijohet një rrjet i organizatave të shoqërisë civile të cilat merren me çështjet mjedisore, duhet vlerësuar rolin e shoqërisë civile, angazhimin dhe reagimet e tyre, si dhe nxitjen e debatit në publik përkitazi me ndikimet e ndryshme në mjedis.

Si hap para vlerësohet publikimi i dokumentit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës “Mjedisi i Kosovës 2020 - Raport i treguesve mjedisorë”, i cili është tregues për gjendjen e mjedisit dhe ndikimit në mjedis. Vazhdon të mungojë një hulumtim i institucioneve kompetente shëndetësore, i cili nëpërmjet indikatorëve do të tregonte ndikimin e gjendjes së mjedisit në shëndetin publik.

⁷³ Ligji për Tokën Bujqësore; neni 2, Qëllimi: “Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera përveç në rastet e përcaktuara më këtë ligj dhe me dispozitat e tjera të nxjerrura në bazë të tij.”

⁷⁴ Ligji nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, neni 1, par 2.

Më 5 qershor 2020, me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, Avokati i Popullit përmes komunikatës për media tërhoqi vëmendjen e institucioneve në vend për nevojën e angazhimit më të thelluar për ndërmarrjen e masave konkrete dhe të nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen nga degradimi i mjedisit në vend, në mënyrë që të respektohet e drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Avokati i Popullit ka theksuar se e drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm është e garantuar me kushtetutën e vendit dhe si e tillë është e renditur ndër vlerat në të cilat bazohet rendi kushtetues, ftoi institucionet e vendit e veçanërisht Kuvendin e Republikës së Kosovës që të ushtrojë kontrolle efektive lidhur me zbatimin e standardeve dhe të legjislacionit mjedisor nga ana e qeverisë së vendit. Po ashtu iu drejtua thirrje organeve të pushtetit gjyqësor që t'u ofrojnë mbrojtje efektive gjyqësore qytetarëve lidhur me trajtimin e rasteve të iniciuara në gjykatë për cenim të të drejtave mjedisore.⁷⁵

Përkundër sfidave të krijuara nga masat e pandemisë, Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit për të cilin po raportohet, ka vazhduar me hetimin e rasteve lidhur me të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe promovimin e këtyre të drejtave.

Ajri

Një ndër çështjet e evidentuara nga Avokati i Popullit, gjatë vitit për të cilin po raportohet, është edhe dështimi i organeve kompetente për ta zbatuar legjislacionin e planifikimit, të ndërtimit dhe të inspektimit për vënien nën kontroll të infrastrukturës së ajrosjes dhe të tymtarëve të objekteve dhe ndikimit të tyre në mjedis. Po ashtu problemet e planifikimit hapësinor dhe lëshimet në procesin e kontrollit të ndërtimit kanë bërë që ta kufizojnë të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e privatësisë dhe të gëzimit të shtëpisë së qytetarëve.

Avokati i Popullit publikoi Raportin me Rekomandime A.nr.342/2018 përkitazi me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si pasojë e ndikimit të ndotjes së ajrit. Hetimet lidhur me çështjen janë iniciuar në bazë të ankesës individuale të znj. L. P. përkitazi me ndotjen e ajrit, e shkaktuar nga oxhaku i objektit kolektiv, i cili gjendet në afërsi të pronës së ankueses në lagjen Mati 1, në Prishtinë. Raporti kishte për qëllim ta tërhoqte vëmendjen e autoriteteve kompetente për nevojën e ndërmarrjes së menjëhershme të masave, s'i obligime pozitive të shtetit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, si domosdoshmëri për t'u siguruar qytetarëve mjedis të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm dhe të drejtën e privatësisë. Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti i rekomandoi Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Komunës së Prishtinës, si autoritete përgjegjëse, që në pajtim me kompetencat dhe me autorizimet ligjore, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për eliminim e shkaktarit të ndotjes.

Uji

⁷⁵ <https://www.oik-rks.org/2020/06/05/deklarate-e-avokatit-te-popullit-me-rastin-e-dites-boterore-kombetare-te-mjedisit/>

Përkundër obligimeve ligjore për mbrojtjen e resurseve ujore, ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi i lumenjve ka vazhduar me ritëm pothuajse të njëjtë. Nuk është vërejtur ndonjë iniciativë në drejtim të përmirësimit të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore, si të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të vendit.

Masat parandaluese, masat për minimizimin e përdorimit dhe pengimin e ndotjes, parimi *ndotësi paguan dhe shfrytëzuesi paguan* vazhdojnë ende të mbeten dispozita ligjore të pazbatueshme. Duhet vepruar në drejtim të zvogëlimit të humbjeve e ujërave, veçanërisht të humbjeve komerciale⁷⁶.

Ka vazhduar nxjerrja e rërës, e zhavorrit, e gurëve, deponimi i dheut, hedhja e mbeturinave, e materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta të pa trajtuara, në ujë rrjedha, në liqene, në akumulime dhe në brigjet e tyre. Mungesa e kontrollimit të ndërhyrjeve arbitrare dhe pa kriter të eksploatorëve të rërës dhe të zhavorrit kanë rezultuar me degradim të shtretërve të lumenjve, madje duke ndryshuar edhe rrjedhën natyrale të këtyre lumenjve dhe duke rritur rrezikun nga përmbytjet. Ndër lumenjtë më të degraduar radhiten Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Ereniku, Ibri etj.

Sipas Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, ende nuk është arritur vënia nën kontroll e humbjeve të lumenjve⁷⁷. Institucioneve përgjegjëse u mbetet që të ndërmarrin masa serioze për t'i përmirësuar kriteret e sigurisë dhe të menaxhimit.

Kualiteti i ujërave të lumenjve nga burimi ndryshon, duke u përkeqësuar përgjatë rrjedhës. Ndotja nga shkarkimi i ujërave të zeza në lumenj dhe kundërmimi kanë vazhduar të kufizojnë jo vetëm të drejtën në mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, por edhe privatësinë e qytetarëve dhe gëzimin e pronës. Mungesa e trajtimit të lumenjve para fazës së shkarkimit të tyre vlerësohet të jetë një ndër ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësore.⁷⁸

Resurset ujore të vendit vazhdojnë të shfrytëzohen si nga operatorët po ashtu edhe nga industria. Shfrytëzuesit më të mëdhenj industrialë të ujërave vazhdojnë të jenë KEK-u, Feronikeli dhe Sharrçemi.

Avokati i Popullit, më 9 qershor 2020, publikoi Raportin me rekomandime Ex-officio nr. 631/2019 në lidhje me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si pasojë e ndotjes së lumit Graçankë. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e autoriteteve kompetente për nevojën e ndërmarrjes së menjëhershme të masave si obligime pozitive për mbrojtjen e lumit Graçankë nga ndotja, si domosdoshmëri për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Raporti argumenton në njërin anë përgjegjësitë e shtetit për mënjanimin e efekteve të dëmshme nga ndotja e lumit dhe në anën tjetër mosarritjen e

⁷⁶ Raporti për Kosovën* 2020, Komisioni Evropian, 6.20 Mjedisit dhe ndryshimi klimatik, fq. 106.

⁷⁷ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës - Mjedisit i Kosovës 2020, Raport i treguesve mjedisorë: *„...humbjet vitin 2019 ishin rreth 90 milion m3 ujë. Krahasuar me vitin paraprak.”*

⁷⁸ Po aty.

autoriteteve për t'i përmbushur obligimet e tyre në pengimin e ndikimit të ndotjes në të drejtat e njeriut, respektivisht në të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe në të drejtën e privatësisë. Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti u rekomandoi autoriteteve përgjegjëse që, në pajtim me kompetencat dhe me autorizimet ligjore, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme dhe efektive për mbrojtjen e lumit nga ndotja.

Hidrocentralet

Procesi i operimit të hidrocentraleve në vend është përcjellë me mangësi të vazhdueshme sa i përket aspektit procedural tredimensional, qasjes në informata, pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi. Procesi është përcjellë me mungesë të transparencës së institucioneve përgjegjëse për ligjshmërinë e operimit, e po ashtu edhe me paqartësi lidhur me procedurat e organizimit të dëgjimeve publike, si forma të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

Derisa në publik është zhvilluar vazhdimisht një debat i gjerë dhe gjithëpërfshirës lidhur me çështjen e ndikimit të ndërtimit të hidrocentraleve në mjedis, degradimit të shtretërve të lumenjve, tejkalimin e shfrytëzimit të përqindjes së lejuar të ujërave të lumenjve, mospërmbushjes së obligimeve kontraktuese nga operatorët⁷⁹ dhe ndikimin në ekosistem, veprimet e institucioneve kanë vazhduar të ngelin të zbehta në drejtim të zgjidhjes së çështjes.

Si rezultat i paqartësive, i reagimeve të qytetarëve dhe të shoqërisë civile, e posaçërisht ndikimit në mjedis, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 14 gusht 2020, ka formuar Komisionin Hetimor Parlamentar për Procesin e Licencimit, Operimit, Mbikëqyrjes dhe Operimit për Leje të Hidrocentraleve, në mënyrë që t'i adresonte parregullsitë dhe paqartësitë lidhur me operimin e hidrocentraleve në vend. Komisioni në fjalë nuk ka arritur ta përfundonte detyrën për të cilën është krijuar, në fund të vitit 2020 ka përfunduar punën pa e arritur qëllimin e formimit, për arsye të zhvillimeve politike.

Avokati i Popullit është duke zhvilluar hetime në 11 raste që lidhen me çështjen e hidrocentraleve në vend.

Toka

Nuk janë vërejtur zhvillime në drejtim të ndërtimit të politikave, të cilat do të ndikinin në mbrojtjen e tokave dhe në zhvillim të qëndrueshëm dhe të cilat do t'i parandalonin pasojat mjedisore dhe socio-ekonomike të degradimit të tokës.

Shqetësues mbetet mosangazhimi i organeve kompetente për vënien nën kontroll të konvertimit të shpejtë të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nga ndërtimet në

⁷⁹ Marrëveshja Kontraktuese nr. 937, datë 16.3.12, e lidhur ndërmjet Komunës së Deçanit, Republika e Kosovës, me Kelkos Energu Sh.P.K, lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Deçanit sipas Kontratës së Servitutit për ndërtimin dhe operimin e njësisë gjeneruese hidroenergjetike “Belaje”, “Deçan” dhe “Lumbardhi II”, fq. nr. 9, neni 5, par. 1 - Detyrimet e Kelkos Sh.P.K: “Sigurimin e një ndërtimi të ri të rezervuarit të liqenit Lumbardhi II, ...”

kundërshtim me kriteret e parapara në ligjin, përkundër kërkesave të dala nga Ligji për Planifikimin Hapësinor; për zhvillim të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar; për mbrojtje të tokës bujqësore dhe të mjedisit; vazhdon mosangazhimi serioz i organeve kompetente të nivelit qendror dhe lokal për vënien nën kontroll të konvertimit të shpejtë të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Problem më vete vazhdojnë të mbeten të dhënat për tokat. Si rezultat i mungesës së koordinimit të komunikimit mes nivelit qendror dhe lokal, ende nuk është arritur të kemi të dhëna të sakta, të cilat do të ishin indikatorë të një planifikimi të mirëfilltë për shfrytëzimin e tokave, si për prodhime bujqësore, ndërtim apo veprimtari ekonomike, nevojiten të kemi një bazë të dhënash të sakta.

Në hapësirat e operimit të KEK-ut vërehet deformimi i sipërfaqeve tokësore nga rrëshqitja e tokës.⁸⁰ Janë evidentuar mbetje në formë vajrash radioaktive, azbesti, metalike etj. Duhet të shqyrtohet mbyllja dhe rehabilitimi sa më i shpejtë i Liqenit të ashtuquajtur *i kaltër*, ku bëhen shkarkimet e hidraulikut (bartja e hirit)⁸¹, dhe të përmirësohet rikultivimi i hapësirave të degraduara.

Shqetësuese mbetet prerja dhe djegia e pyjeve. Ka vazhduar degradimi i pyjeve nga prerja, nga zjarret, nga ndërtimet ilegale dhe nga ndërtimet e rrugëve dhe të hidrocentraleve. Ripyllëzimi dhe rivitalizimi nuk po arrihet të bëhet në proporcion të përafërt me degradimin e sipërfaqeve të degraduara. Dështimi i institucioneve për t'i kontrolluar ndërtimet individuale, dhe po ashtu hidrocentralet, ka ndikuar në degradim të maleve të Sharrit, edhe pse qysh nga viti 2012 kanë statusin e Parkut Kombëtar. Edhe pse ende nuk ka të dhëna për prerjet ilegale, gjendja e pyjeve dhe ndërhyrjet arbitrare nga faktori njeri kërkon angazhim serioz nga institucionet qendrore, lokale dhe të rendit.

Operimi i gurishteve në vend, sidomos operimi i operatorëve ilegalë,⁸² mbetet njëri ndër problemet më të mëdha me ndikim serioz në mjedis. Situata në terren tregon organet kompetente nuk kanë arritur t'i mbajnë nën kontroll operatorët ekonomik lidhur me zbatimin e rregullave dhe të kriterëve, të cilat dalin nga legjislacioni mjedisor. Si rezultat i moskoordinimit të veprimeve të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), procesi i licencimit dhe i pajisjeve me leje për aktivitete minerare vazhdon të mos jetë në përputhje me vendet ku janë të përqendruara pasuritë minerale ndërtimore e industriale të vendit, të përcaktuara me Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës 2012-2025 e MEA-s. Mundësia ligjore që

⁸⁰ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2018-2019.

⁸¹ Raporti për Kosovën* 2020, Komisioni Evropian, 6.20, Mjedişi dhe ndryshimi klimatik, fq. 106.

⁸²<https://www.kosovo-mining.org/aktivitet/komunikate-per-media-prishtine-31-dhjetor-2019/>, "Gjatë vitit 2019, Inspektorati i KPM-së në aksionin për zbatimin e Planit Operativ për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale, së bashku me Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Mjedisit, Inspektoratin e Pyltariisë si dhe Inspektoratet Komunale. Pas përfundimit të këtyj aksioni në 194 vende të operimeve ilegale janë vendosur shiritat për ndalimin e punës prej të cilave janë 99 seperacione, 16 shfrytëzim, 78 baza betoni dhe asfalti si dhe një fabrikë përpunimi."

KPMM-ja të japë licencë dhe leje për shfrytëzim vetëm me pëlqimin mjedisor, pa leje mjedisore të lëshuar nga MEA-ja, është një vakum i cili mundëson arbitraritet të operatorëve dhe mundësi për shmangie nga veprimet e autoriteteve kompetente për monitorimin dhe inspektim të veprimtarisë, posaçërisht të kushteve mjedisore. Për më tepër, e drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, me theks të veçantë e drejta e privatësisë dhe e gëzimit të shtëpisë së qytetarëve, është cenuar nga mosrespektimi i distancës së përcaktuar me Ligjin nr. 03/l-163 për Minierat dhe Minerale, 500 metra nga objektet dhe nga infrastruktura për zhvillimin e aktiviteteve minerare. Po ashtu, kërcënim serioz për sigurinë publike paraqesin vendpunimet, të cilat jo gjithëherë janë të rrethuara, duke mundësuar qasje të papenguar dhe njëherësh bartje të rërës, të baltës etj, në rrugë publike.

Kriteret për programet për rehabilitimin e zonave të shfrytëzuara të parashtruara nga operatorët me rastin e aplikimit për leje mbetet të rivlerësohen dhe të shqyrtohen me seriozitet nga autoritetet kompetente. Përkundër gjendjes në terren, organet kompetente: MEA-ja dhe KPMM-ja, nuk arrijnë të monitorojnë dhe të inspektojnë mjaftueshëm zbatimin e kriterëve, të cilat do ta mbajnë nën kontroll mbrojtjen e mjedisit nga operimi i operatorëve. Edhe pse tre muaj para skadimit të licencës dhe të lejes duhet të fillojë rikultivimi apo rehabilitimi i vendpunimeve të gurishtës, gjendja në terren, me përjashtim të rasteve të radha, tregon ndërhyrje pa kriter dhe dëme mjedisore që kërkojnë investime të mëdha për rikultivim dhe kthim në gjendjen e mëparshme. Mosrehabilitimi i hapësirave të degraduara nga aktivitetet minerare nga operatorët kërkon shqyrtim serioz nga organet kompetente, madje adresim edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mbeturinat

Edhe pse janë duke u zhvilluar iniciativa individuale për riciklimin e mbeturinave nga metalet, plastika dhe letra, vendi ende nuk ka sistem të organizuar të përpunimit dhe të riciklimit të mbeturinave, i cili do t'i përgjigjej mjaftueshëm kërkesave të kohës dhe zhvillimit të metodave të qëndrueshme të deponimit përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Ende nuk është krijuar një sistem i të dhënave i cili saktë do të ofronte të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe eliminimin e mbeturinave. Mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve, kanë mbetur në fazë të njëjtë.

Marrë parasysh se mbulimi i përgjithshëm me shërbim për mbeturinat deri në fund të vitit 2019 në nivel vendi ishte 77.70% ⁸³, nënkupton se 22.3% e mbeturinave të vendit hidhet në tokë dhe në lumenj. Edhe pse është zvogëluar numri i deponive ilegale⁸⁴, dhe të tjera, ekzistimi

⁸³ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2018-2019, fq. 43, sasia e përgjithshme e mbeturinave industriale të gjeneruara ka qenë në vitin 2.5 tonë, (2.554.308kg)

⁸⁴ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2018-2019: *“Bazuar në raportimin e komunave, i cili është i mbështetur në hulumtimin në terren, në mars të vitit 2019,*

i 1489 deponive ilegale është tregues i mosarritjes së organeve kompetente për zgjidhje të qëndrueshme, si dhe për edukimin e qytetarëve për rëndësinë e trajtimit të duhur të mbeturinave.

Deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK-ja: Mirashi (Prishtinë), Dumnica (Podujevë), Velekinca (Gjilan) dhe Landovica (Prizren), dhe ato rajonale në Mitrovicë (Gërmovë), Pejë dhe Dragash, përkundër obligimeve për administrim të duhur për t'u zvogëluar rrezikshmëria nga mbeturinat dhe me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit të qytetarëve, vazhdojnë të operojnë me problemet, si: mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë; kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara dhe mbulimi jo i mjaftueshëm i mbeturinave; shkarkimi nga deponitë në tokë i ujërave të pa trajtuara, në lumenj dhe depërtimi i tyre në ujëra nëntokësorë.

Zhurma

Institucionet kompetente të nivelit komunal dhe qendror, edhe në këtë vit nuk arritën t'u ofrojnë qytetarëve mbrojtje efektive nga zhurma dhe nga efektet e saj. Përkundër efekteve të dëmshme në shëndetin e njeriut, qytetarët vazhduan të ballafaqohen me burime të ndryshme të zhurmës. Nuk u shënua ndonjë përmirësim i dukshëm në vendosjen e paneleve mbrojtëse nga zhurma në autostrada, të cilat do t'i mbronin vendbanimet nga zhurma. Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, i cili aktualisht është, nuk arriti qëllimin për zbatimin e masave për zvogëlimin e zhurmës.

Zona e interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”

Edhe në këtë vit nuk është arritur të zgjidhej çështja e shpronësimit për banorët e zonës me interes të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”. Edhe pse gjendja e mjedisit është larg standardeve të dëshirueshme dhe nga normat e ndotjes sipas raporteve ekzistuese, shpeshherë tejkalojnë kufijtë e lejuar të përcaktuar me legjislacionin vendor, përkundër obligimit pozitiv të shtetit, zhvendosja, shpronësimi apo lëvizja e një numri të konsiderueshëm të banorëve nga ato hapësira, si masë proporcionale dhe efektive për zgjidhjen e çështjes, që nga viti 2004, nuk është përfunduar ende. Vendimi për devijimin e vijës së mihjes duke tejkaluar pjesën e mbetur të fshatrave Hade dhe Sibovc, ka lënë qytetarët në situatë të vështirë dhe të papërfunduar, duke ua kufizuar të drejtën e tyre për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës, të privatësisë dhe të gëzimit të pronës dhe të lirisë së lëvizjes.

Planifikimi hapësinor

Edhe pse mjedisi përcaktohet si vlerë në të cilën mbështetet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, përkundër gjendjes së krijuar kaotike me ndikim negativ në kualitetin jetësor, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim, i cili dukshëm do ta përmirësonte konceptin e planifikimit

ndërlidhur me vitin 2018 në nivel vendi janë identifikuar 2529, respektivisht nga hulumtimi në terren në qershor të vitit 2020 ndërlidhur me vitin 2019, janë identifikuar 1489 deponi ilegale.”

hapësinor. Ndonëse gjendja e krijuar seriozisht është duke ndikuar në trajtim të pabarabartë, kufizim të lëvizjes së lirë, të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, çështja ende nuk është adresuar nga institucionet përgjegjëse.

Nga zhvillimet në terren vërehet se pavarësisht garancive ligjore që burojnë nga Ligji për Planifikimin Hapësinor, nuk është arritur të promovohen interesat e përbashkëta të qytetarëve të Kosovës për cilësi të lartë të jetesës dhe sisteme të qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve, si dhe të mbrohen burimet natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore. Ndikim serioz në të drejtat e njeriut vlerësohet mospërfshirja e interesave të të gjithë qytetarëve, në veçanti të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, të të moshuarve, të fëmijëve, të rinjve,⁸⁵ brenda planeve të hollësishme rregulluese.

Çështja e mosrespektimit të Kushteve Ndërtimore⁸⁶, si: *“Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike; lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale; përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale; përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale; kërkesat minimale për vendparkingje; e drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese; kushtet e qasjes adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike; kufizimet e ndotjes mjedisore dhe të zhurmës sipas legjislacionit përkatës në fuqi; masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore”*, dhe ndikimi i tyre në të drejtat e njeriut, tani më duhet të shqyrtohet me shumë seriozitet jo vetëm nga organet e planifikimit hapësinor, por edhe më gjerë.

Përkundër parregullive në objektet e ndërtuara, qeveria ende nuk ka arritur të miratonte Kodin Unik të Ndërtimit, i cili do t'i përcaktonte: *“Kërkesat minimale për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë dhe mirëqenies së përgjithshme. përmes rezistencës së nevojshme të strukturës së hapësirave të emergjencës, ekuilibrit dhe stabilitetit, sanitarisë, menaxhimit të mbeturinave ndërtimore, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, masave për efikasitet dhe kursim të energjisë, dhe sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri dhe rreziqeve tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor si dhe t'i krijoj siguri zjarrfikësve dhe përgjegjësve tjerë në raste të emergjencave.”*⁸⁷

Për më tepër, liria e lëvizjes dhe e drejta për mjedis të sigurt të shëndetshëm e personave me aftësi të kufizuara është duke u kufizuar vazhdimisht nga mospërmirësimi i infrastrukturës për qasje në objekte të banimit kolektiv, sidomos në objekte të institucioneve publike, ashtu

⁸⁵ Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

⁸⁶ Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, neni 21: “Kushtet e Ndërtimit”.

⁸⁷ Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtim.

sikurse është paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.⁸⁸

Mosvënia nën kontroll e përputhshmërisë së objekteve ndërtimore në ndërtim dhe e atyre të përfunduara me lejen e ndërtimit, dhe mosdhënia e lejeve/certifikatës së përdorimit, është dëshmi e mosarritjes së përmbushjes së obligimeve pozitive të organeve kompetente për zbatimin e legjislacionit të ndërtimit. Mungesa e mbikëqyrjes dhe e certifikimit final të përdorimit të objekteve paraqet nevojën imediate për ndërmarrjen e masave nga institucionet kompetente për vlerësimin e sigurisë së objekteve për përputhshmërinë me rregullat e përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, e mbi të gjitha me rregullat e sigurisë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, dhe me ato kundër ndotjes dhe degradimit të mjedisit.

Hapësirat e trotuareve/shtigjeve vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme në krahasim me numrin e banorëve; lartësia jashtë normave të caktuara; mangësi dhe mungesë e elementeve për qasje të papenguar dhe rampat të cilat do ta mundësonin lidhjen pa ndërprerje mes niveleve të ndryshme të trotuareve.

Vlerësim i përgjithshëm

Është me rëndësi të theksohet se në këtë vit është evidentuar ngritje e reagimit të qytetarëve dhe e shoqërisë civile lidhur me respektimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe respektimin e së drejtës kushtetuese të pjesëmarrjes në vendimmarrje mjedisore. Ka vazhduar më fuqishëm reagimi i qytetarëve dhe i shoqërisë civile lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve.

Edhe pse qasja në informata mjedisore në vend është e drejtë e garantuar me legjislacionin mjedisor po ashtu edhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike⁸⁹, Avokati i Popullit ka vërejtur se qasja në dokumente me përmbajtje mjedisore, apo me procese që kanë të bëjnë me mjedisin, ka vazhduar të mbetet në vullnetin e institucioneve.

Proceset e organizimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje janë duke u përcjellë me shumë paqartësi. Përderisa publiku ka reaguar për mungesë të informimit për organizimin e dëgjimeve publike, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur që nëpërmjet fakteve të dokumentojnë se thirrja/ftesa për pjesëmarrje është bërë përmes mjeteve të qasshme të informimit.

Parashkrimi, hedhja poshtë dhe zvarritja e lëndëve nga prokuroritë dhe nga gjykatat e vendit është çështje që përsëritet vazhdimisht. Mbeten të fuqizohen kapacitetet e prokurorëve dhe të

⁸⁸ Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.

⁸⁹ Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Nenin 17, par. 3.3, i ligjit cili rregullon: “Bazat e lejueshme për refuzimin e qasjes në dokumente publike”, saktëson prerazi se qasja në dokumente publike gjithnjë lejohet, nëse: “dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me mjedisin, mbeturinat, substanca të rrezikshme ose informata të raporteve të sigurisë në mjedis, ashtu si janë të parapara me ligjin përkatës për mbrojtjen e mjedisit.”

gjykatësve, të Policisë së Kosovës, në veçanti të inspektorateve të nivelit qendror dhe lokal, lidhur me nenet që dalin nga Kapitulli XXVIII - Veprat Penale Kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, i Kodit Penal. Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk kanë arritur ta ndërtojnë bazën e të dhënave, i cili do t'i filtronte rastet që kanë të bëjnë me mjedisin.

Ka vazhduar mosaplikimi i parimit *ndotësi paguan*, rehabilitimi i hapësirave të degraduara dhe moszbatimi i dispozitave të tjera të dala nga ligjet mjedisore ndaj shkaktarëve të dëmeve mjedisore.

Mosfunksionimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISh) është duke ndikuar në mungesë të dhënash faktike, të cilat do të pasqyronin ndikimin e ndotjes së mjedisit në jetën dhe në shëndetin e qytetarëve dhe njëherësh do të ishin indikatorë nëpërmjet të cilëve do të evidentoheshin sëmundjet ambientale. Mungesa e të dhënave nga SISh-i është duke ndikuar në mungesën e hulumtimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), të cilat qartë do ta pasqyronin ndikimin e ndotjes në shëndetin e qytetarëve.

Pavarësisht nevojave për reagime efektive në fushat e ndryshme të mjedisit, veprimet e inspektoratit të MEA-s dhe të inspektorateve mjedisore komunale mbesin të zbehta. Përkundër dëmeve dhe dëmeve serioze të shkaktuara në mjedis, shpeshherë inspektoratet orientohen në iniciimin e procedurave kundërvajtëse në vend të atyre penale, si forma sanksionimi.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i organeve kompetente për mbrojtje të mjedisit mbetet për t'u përmirësuar në drejtim të fuqizimit dhe të bashkërendimit të aktiviteteve mes inspektorateve, Policisë së Kosovës, prokurorive, gjykatave dhe institucioneve të tjera në vend, në drejtim të mbrojtjes së mjedisit.

E drejta për qasje në dokumente publike

E drejta për qasje në dokumente publike ia garanton secilit person të drejtën për qasje në dokumente publike, me përjashtim qasjen në informacione të kufizuara me ligj (neni 41 i Kushtetutës dhe Ligji për Qasje në Dokumente Publike). Kjo e drejtë nuk është e drejtë absolute, por është e drejtë e cila duhet të balancohet me të drejtat e tjera, pa i dëmtoar interesat e tjera.

Kjo e drejtë garantohet edhe me instrumente ndërkombëtare, të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në rendin juridik të vendit: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj. Këto instrumente ndërkombëtare, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të zbatuara drejtpërsëdrejti në rendin juridik të vendit dhe me përparësi ndaj legjislacionit vendor, në rast konflikti, garantojnë të drejtën për t'u informuar, përkatësisht të drejtën për qasje në dokumente publike.

Transparenca dhe llogaridhënia njihen si parime ndër më të rëndësishmet në botën demokratike, të dyja parimet janë në shërbim të qeverisjes së përgjegjshme dhe funksionale. Në një shtet demokratik, qeverisja transparente dhe llogaridhënese synohet të arrihet nëpërmjet promovimit të interesit publik. Në këtë drejtim, transparenca në funksion të përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies nënkupton qasjen e lehtë dhe të papenguar të publikut në të dhënat dhe në dokumentet e prodhuara, të pranuar, të mbajtura apo të kontrolluara nga institucionet publike.

Gjatë vitit 2020 e deri në ditën që po raportojmë, në IAP janë paraqitur 62 ankesa, të cilat kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, dy prej tyre janë shpallur të papranueshme, ndërsa 60 të tjerat janë hapur për hetim. Nga këto ankesa, 39 janë pranuar nga shoqëria civile dhe nga mediat, ndërsa të tjerat janë ankesa individuale. Palët përgjegjëse në këto ankesa janë kryesisht të nivelit qendror dhe lokal (19 për ministrinë dhe 19 për komunitet).⁹⁰

Gjatë hetimit të këtyre ankesave vërehet se në të shumtën e rasteve përgjigjet e institucioneve për pranimin e kërkesës janë me kohë dhe brenda afateve ligjore. Megjithatë, koha e vendosjes për lejimin apo për refuzimin për qasje i tejkalon afatet e parapara me ligj, pavarësisht rëndësisë për dhënien me kohë të informacioneve.

Po ashtu është vërejtur se vonesat në përgjigje për lejim, kufizim apo refuzim të qasjes shpesh janë shkak i mungesës së kapaciteteve njerëzore. Në rastet kur institucionet publike refuzojnë qasjen apo lejojnë qasje të kufizuara, në të shumtën e rasteve dështojnë të nxjerrin vendim dhe të japin arsyetim të bazuar në ligj.

Pastaj institucionet shtetërore, mbajtëse, hartuese apo pranuese të informacioneve, në shumicën e rasteve nuk i kanë klasifikuar me kohë dokumentet, ose nuk i kanë klasifikuar fare, ashtu sikurse e parasheh Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Mosveprimi sipas këtij ligji i hap rrugë arbitraritetit në vendosje për lejim apo për refuzim për qasje në dokumente publike. Avokati i Popullit këtë e ka raportuar edhe në vitet paraprake.

Që nga shpallja e gjendjes së pandemisë, një arsyetim për vonesat për përgjigje në kërkesat për qasje është përdorur edhe çështja se institucionet po punojnë me staf të reduktuar dhe me punë në distancë - nga shtëpia.

Pengesë në realizimin e së drejtës për qasje, gjatë vitit për të cilin po raportohet, ka paraqitur dhe vazhdon të paraqesë edhe moszgjedhja e komisionarit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP). Në korrik të vitit 2019 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, i cili e garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike. Ky ligj ia jep të drejtën kërkuarit të informacionit t'i drejtohet me ankesë AIP-së brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh, në rast se institucioni publik ka heshtur, nuk është përgjigjur, apo ka refuzuar kërkesën për qasje në

⁹⁰ Të tjerat: institucione shëndetësore, Policia e Kosovës, PTK-ja, gjykatat, prokuroritë, KPK-ja etj.

dokumente publike. Përzgjedhja e komisionarit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka dështuar tri herë.⁹¹ Mungesa e komisionarit të AIP-së ka ndikuar edhe në mosnxjerrjen e akteve nënligjore për organizimin e brendshëm të AIP-së, akte këto të domosdoshme për funksionimin e punës së AIP-së, që sipas të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duhet të nxirren 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Qasja e lehtë dhe pa pengesa në dokumente dhe në informacione është e rëndësishme, e cila ndikon në ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe qytetarëve në transparencë të veprimeve, në efikasitetin dhe në efektivitetin e administratës publike. Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është i rëndësishëm, përveç për transparencë dhe për llogaridhënie të qeverisjes, është edhe për ndërgjegjësimin e punonjësve të administratës dhe për detyrimin që kanë ata në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, por edhe për ndërgjegjësimin e qytetarëve për shërbimet që i pret nga administrata.

⁹¹ Në herën e parë, asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur të kualifikohej; në herën e dytë, përzgjedhja e tij ka dështuar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës; ndërsa në herën e tretë, asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur t'i merrte votat e nevojshme.

III. Të drejtat e fëmijëve

III. Të drejtat e fëmijëve

Të drejtat e fëmijëve përbëjnë një pjesë integrale të të drejtave të njeriut. Pra, fëmijët dhe të rinjtë kanë të njëjtat të drejta të përgjithshme njerëzore si të rriturit dhe gjithashtu të drejta specifike që u përshtaten nevojave të tyre të veçanta si fëmijë. Fëmijët konsiderohen si bartës të të drejtave dhe pjesëmarrës aktivë në realizimin e tyre. Realizimi i të drejtave ua mundëson fëmijëve të zhvillohen në potencialin e tyre të plotë, duke ua njohur dinjitetin themelor njerëzor dhe urgjencën për të siguruar mirëqenien e tyre. Pa dyshim, zhvillimi i shëndetshëm i fëmijëve është thelbësor për mirëqenien e ardhshme të çdo shoqërie.

Duke qenë se fëmijët janë të varur nga të rriturit, ata janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të mëdha shoqërore, siç është rasti i pandemisë COVID-19. Andaj veprimet ose mosveprimet e institucioneve, të shoqërisë dhe të prindërve mund të ndikojnë tek fëmijët më shumë se tek çdo grup tjetër shoqëror. Rrjedhimisht është e rëndësishme që këto veprime ta kenë parasysh interesin më të mirë të fëmijës gjatë hartimit të politikave dhe të legjislacionit.

Analiza e situatës së fëmijëve në Kosovë edhe në këtë vit tregon se fëmijët ende hasin në vështirësi për gëzimin e plotë të të drejtave të tyre. Këto vështirësi janë të shfaqura gati në të gjitha fushat e jetës së tyre, veçanërisht në realizimin e së drejtës për arsim dhe mbrojtje sociale dhe shëndetësore. Një jetë e lirë nga dhuna është e drejtë themelore dhe parakusht i domosdoshëm për mirëqenien dhe për shëndetin fizik dhe mendor të fëmijës. Pavarësisht kësaj, në Kosovë dhuna vazhdon të jetë e pranishme. Fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në situatë rruge janë veçanërisht të rrezikuar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, dhunës e diskriminimit. IAP-ja ka përfshirë rekomandime konkrete për secilën nga fushat e adresuara përgjatë raportit. Natyrisht është qenësore që këto procese të përfshijnë zërin dhe pikëpamjen e fëmijës në pajtim me zhvillimin gradual të aftësive të tij/saj.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron shprehimisht të drejtat e fëmijëve dhe imponon detyrime ligjore për shtetin për t'i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur këto të drejta, përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Plotësimi i kornizës ligjore me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe hyrjen e tij në fuqi në korrik të vitit 2020, shënon një hap të rëndësishëm drejt realizimit të të drejtave të tyre. Gjatë këtij viti, IAP-ja ka nisur hetimet Ex-officio 381/2020 lidhur me vlerësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF). LMF-ja ka autorizuar institucionet kompetente për nxjerrjen e 17 akteve nënligjore, e në fakt nuk është miratuar asnjëri prej tyre. Sidoqoftë, miratimi i ligjeve mbetet vetëm një hap simbolik nëse nuk përcillet me hapa konkretë dhe zbatim të suksesshëm. Përrjashtimisht, IAP-ja, në bazë të autorizimit të LMF-së dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka nxjerrë Rregulloren (IAP) nr. 01/2019 për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Rregullorja do të zbatohet nga stafi i IAP-së gjatë procedurave të ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, duke u bazuar në parimet e mosdiskriminimit, mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës, respektimin e dinjitetit dhe të personalitetit të fëmijës, marrjen e

mendimit të tij, adresimin me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme si dhe ofrimin e shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.⁹²

Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve

Avokati i Popullit gjatë vitit për të cilin po raportohet ka pranuar 55 ankesa, një numër i të cilave është parashtruar kryesisht nga prindër të fëmijëve. Nga ky numër, 14 janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë ato kanë qenë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, nuk ka shkelje të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike. Nga 41 ankesat e vendosura për hetim, për 11 prej tyre kanë filluar hetimet sipas detyrës zyrtare.

Të drejtat e fëmijëve gjatë pandemisë COVID-19

Gjendja e krijuar nga pandemia globale COVID-19 ka nxjerrë në pah edhe më shumë mangësitë për realizimin e të drejtave të fëmijëve si dhe ka thelluar pabarazitë ekzistuese. Efektet socio-ekonomike të virusit dhe masat e ndërmarra për ta kontrolluar pandeminë kanë ndikuar në mbijetesën dhe në shëndetin e fëmijëve, në sigurinë, në të mësuarit si dhe potencialisht në rrezikun nga varfëria. Këto efekte në ndërveprim me faktorë të tjerë, siç janë: gjinia, etniteti, aftësia e kufizuar dhe gjendja ekonomike kanë pasur ndikime të ndryshme tek fëmijët. Një shembull ishte kalimi nga mësimi në shkollë në mësimin online, ku u pa se shumë fëmijë nuk kishin qasje në pajisje teknologjike dhe në internet, veçanërisht fëmijët romë, ashkalinj, e egjiptianë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara, kjo qasje ishte më e vështirë duke qenë se nuk kishte planprograme të përshtatshme për nevojat e tyre.

Në përgjithësi, gjatë kësaj kohe janë vërejtur vështirësi për qasjen e fëmijëve në arsim, në shërbimet sociale dhe shëndetësore si dhe është rritur dhuna në familje, rrjedhimisht edhe dhuna ndaj fëmijëve. Më tutje, kufizimet e jetesës së zakonshme si dhe stresi psiko-social i shkaktuar nga mbyllja në shtëpi ose izolimi kanë ndikuar në shëndetin mendor të fëmijëve. Kjo pandemi ka theksuar më shumë se kurrë rëndësinë e programeve të shëndetit mendor dhe qasjen e të gjithë fëmijëve në shërbime psiko-sociale.

IAP-ja kërkon posaçërisht nga institucionet që me rastin e miratimit të pakove mbështetëse, të përfshijnë masa specifike për t'i mbështetur fëmijët në situatë rruge, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në gjendje të rëndë ekonomike. Këto masa duhet të përcillen me financim të qëndrueshëm për t'iu përgjigjur krizës shëndetësore, sociale dhe ekonomike të shkaktuar nga COVID-19, duke i përfshirë si masa shtesë me qëllim që të sigurohet jeta dhe shëndeti i fëmijëve.

⁹² IAP, Rregullorja Nr. 01/2019 për Procedurat e Veçanta për Pranimin, Trajtimin dhe Adresimin e Ankesave të Paraqitura nga Fëmijët apo Ankesave që kanë të bëjnë me të Drejtat e Fëmijëve, 2019, neni 3.

E drejta e fëmijëve për arsim

Rastet lidhur me të drejtën për arsim, të cilat janë hetuar nga Avokati i Popullit, duke përfshirë edhe rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: mungesën e kushteve për arsim për fëmijët e verbër; qasjen në institucione parashkollore; riorganizimin e arsimit në komunë; ndërprerje të shkollimit për shkak të largësisë së madhe të shtëpisë nga shkolla dhe rrezikut për kalimin e rrugës përmes malit; dhe diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Nga 15 raste të pranuar që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve në arsim, 9 prej tyre janë mbyllur pozitivisht, ndërsa 6 janë nën hetime.

Në një nga rastet e pranuar pas ankesës së prindit, IAP-ja i ka dërguar letër rekomandimi Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Vushtri për t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për sigurimin përkatës të transportit publik për fëmijët nga një fshat afër Vushtrrisë. Fëmijët për tri vjet nuk kanë shkuar në shkollë, e kanë ndërprerë shkollimin pasi shkolla më e afërt është rreth pesë kilometra larg nga shtëpia dhe rruga deri te shkolla kalon përmes malit, gjë që paraqet rrezik për jetën e tyre. Pas vlerësimit të informatave dhe të dokumenteve përkatëse, Avokati i Popullit ka konstatuar se çështja e zvarritjes së përgjigjes nga DKA-ja e Vushtrrisë ndaj kërkesave të ankuesit për sigurimin e transportit për nxënës, përveçse është në kundërshtim me detyrimet që ato të shqyrtohen brenda afatit ligjor, është në kundërshtim edhe me të drejtat e fëmijëve, në veçanti me të drejtën për arsim, e cila paraqet parakusht për realizimin e të drejtave të tjera të fëmijëve, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, lidhur me të cilat DKA-ja në Vushtri do të duhej të ndërmerre veprimet përkatëse. IAP-ja është njoftuar nga ankuesi së fëmijët tani janë duke vijuar mësimin, pasi Komuna ka pastruar klasën në shkollën e vjetër dhe ka angazhuar stafin mësimor për t'i mësuar fëmijët e tij.

Më 25 shkurt 2020, përfaqësuesi i IAP-së, në kuadër të fushatës informuese: *“Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit”*, e kishte vizituar shkollën *“Nëna Terezë”* në fshatin Vranidoll. Me këtë rast ai kishte vërejtur se shkolla në fjalë po përballej me mungesa dhe me vështirësi për realizimin e procesit mësimor në aneksin e vjetër të saj dhe nxënësve u rrezikohej edhe e drejta për jetë, për shëndet dhe për mirëqenie sociale. Avokati i Popullit i ka rekomanduar Komunës së Prishtinës që t'i ndërmerre urgjentisht veprimet përkatëse për rinovimin e objektit të shkollës. IAP-ja është informuar nga Komuna se ka filluar ndërtimi i shkollës së re.

Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë ende duke përjetuar vështirësi serioze dhe përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj. Fëmijët me aftësi të kufizuara i përkasin një prej grupeve më të rrezikuara të fëmijëve. Kjo rrezikshmëri dallon varësisht nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm siç janë: gjinia, banimi në zona rurale, etniteti apo të qenit fëmijë në situatë rruge. Vajzat me aftësi të kufizuara janë shpesh edhe më të rrezikuara, për shkak të diskriminimit gjinor. Andaj vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet atyre për t'i marrë masat e nevojshme, sidomos në aspektin e mbrojtjes nga dhuna në baza

gjinore, për të siguruar që ato të kenë qasje në të gjitha shërbimet dhe të përfshihen plotësisht në arsim e në shoqëri. Edhe Kosova synon ta zbatojë një model social të aftësisë së kufizuar ku pengesa nuk shihet në vetë aftësinë e kufizuar, por në një kombinim të pengesave sociale, kulturore, dhe fizike, me të cilat ndeshen fëmijët me aftësi të kufizuara në jetën e tyre të përditshme. Një përkufizim i tillë është përfshirë edhe në LMF-në, e cila përmban disa dispozita të veçanta të cilat adresojnë mbrojtjen e fëmijës me aftësi të kufizuara. Pavarësisht kësaj mbrojtjeje ligjore dhe dispozitave të shumta të tjera të shpërndara në ligje të ndryshme, hartimi i legjislacionit nuk është i mjaftueshëm që fëmijët t'i gëzojnë këto të drejta, por nevojitet zbatim i duhur i tyre. Mungesa e të dhënave vazhdon të mbetet problematike.

Avokati i Popullit vëren se ka mungesë të një hulumtimi gjithëpërfshirës dhe mungon mbledhja e të dhënave të sakta dhe të plota, të cilat pasqyrojnë gjendjen aktuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Një hulumtim i tillë dhe mbledhja e të dhënave është qenësore për krijimin e politikave efektive dhe shpërndarjen e burimeve të nevojshme për financimin e programeve.

Gjatë vendosjes së politikave dhe marrjes së vendimeve në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të sigurojnë që fëmijët të dëgjohen në të gjitha procedurat që i prekin ata dhe që pikëpamjet e tyre të respektohen në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive të tyre. Fëmijëve duhet t'u sigurohet çfarëdo mënyre e komunikimit që u nevojitet atyre për ta lehtësuar shprehjen e pikëpamjeve të tyre.

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar tri raste lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara, një të hapur ex-officio. IAP-ja ka nisur hetimet ex-officio ndaj Komunës së Pejës lidhur me vendkalimin tek shkolla për të verbër “Xheladin Deda”. Mungesa e vendkalimit rrezikon jetën e nxënësve të verbër çdo ditë dhe çdoherë kur e kalojnë rrugën, pavarësisht kërkesave të panumërta të cilat prindërit ia kanë drejtuar Komunës në dhjetë vjetët e fundit për ndërtimin e kësaj infrastrukture të nevojshme për rritjen e sigurisë së nxënësve.⁹³

Ndërsa rastet e tjera kishin të bënin me sigurimin e asistentëve mësues për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku në njërin rast ankuesja ishte ankuar kundër Komunës së Prishtinës – DKA-së dhe kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASh), lidhur me punësimin e asistentëve mësues për fëmijën e saj me aftësi të kufizuara. Në një rast të ngjashëm, IAP-ja ka pranuar ankesën e ankuesve kundër Komunës së Prishtinës, përkitazi me mosshpalljen e konkurseve për punësim në pozitat *Asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta*. IAP-ja ka filluar hetimet për të kontaktuar Komunën e Prishtinës dhe MASh-në për informacione më të detajuara.⁹⁴

Në vitin 2019, IAP-ja kishte publikuar Letër rekomandimin Ankesa 245/2012019 lidhur me mohimin e së drejtës për shkollim të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Qendrën Burimore

⁹³ Rasti 730/2020.

⁹⁴ Rasti 536/2020.

për Mësim dhe Këshillim “Xheladin Deda” në Pejë. Gjatë vitit 2020, IAP-ja i ka dërguar tri letra përsëritëse në MASH, por nuk ka marrë përgjigje.

Të drejtat e fëmijëve në procedurat e organeve gjyqësore

Edhe gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, në IAP janë pranuar një numër i ankesave kundër gjykatave dhe prokurorive. Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurës gjyqësore për ekzekutim të vendimit gjyqësor përkitazi me pagimin e alimentacionit, mosndërmarrje të veprimeve përkatëse për të vendosur për kallëzimin penal lidhur me pamundësinë e realizimit të kontaktit personal të fëmijës me prindin etj.⁹⁵

Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve

Avokati i Popullit gjatë periudhës për të cilën po raportohet, nga fusha e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore e fëmijëve ka hetuar tri raste. Rastet kishin të bënin: me kërkesën për strehim të të miturit pas përfundimit të masës edukative, lidhur me dyshimin për sulm seksual; si dhe ushtrim të dhunës ndaj fëmijëve nga ana e prindit.

Në raportet e mëhershme, Avokati i Popullit ka theksuar se zbatimi i nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë ka shkaktuar që shumë familje në gjendje të rëndë materiale të mbesin edhe pa ndihmën sociale, të cilën e gëzonin deri në momentin kur fëmija mbushte pesë vjet⁹⁶. Pavarësisht faktit se janë bërë ndryshime në nenin 4 të këtij ligji, kjo në fakt nuk e ka përmirësuar gjendjen e familjeve të varfra, për faktin e kufizimit të moshës së fëmijëve. Për më tepër, kushtet e përcaktuara për ndihmë sociale, me dispozitat ligjore në fuqi, kanë ndikuar në keqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familjeve, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në mirërritjen e fëmijëve dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi. Këto kushte në veçanti e vështirësojnë gjendjen tek familjet në rrethana të vështira socio-ekonomike, e kjo sidomos vlen për komunitetet e marginalizuara. Avokati i Popullit rithekson se neni 4 i këtij ligji, përtej çdo dyshimi, shkel interesin më të mirë të fëmijës, madje mungesa e ndihmës sociale për fëmijë dhe familje në nevojë kushtëzon dhe ndikon në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijës, si dhe në edukimin e në zhvillimin e mëtutjeshëm të tij. Avokati i Popullit ka konstatuar se neni 4 i ligjit është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me standardet ndërkombëtare, veçmas me KDF-në. Sipas të dhënave të siguruar nga përfaqësues të MPMS-së, Avokati i Popullit është njoftuar se ministria ka miratuar koncept-dokumentin për ndryshimin e skemës së ndihmës sociale, i cili eliminon këtë kriter diskriminues dhe procesi i ndryshimeve ligjore do të zhvillohet gjatë vitit 2021.

Në dhjetor të vitit 2019, Avokati i Popullit kishte publikuar raportin me rekomandime ex-officio, me të cilin kishte vlerësuar se ofrimi i shërbimeve sociale në Republikën e Kosovës është në pajtim me standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe jep rekomandimet

⁹⁵ Rastet: A.nr.211/2020. 149/2020. 7/2020. 713/2020.

⁹⁶ Përveç tjerash, shih Raportin Vjetor të IAP-së për vitin 2019.

specifike në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale. Raporti ka gjetur se punëtorët e asistencës sociale dhe të ndihmave ekonomike nuk janë punëtorë socialë, përjashtuar disa, dhe një shumicë e konsiderueshme e tyre ka kryer vetëm shkollën e mesme. Gjithashtu numri i tyre është i pamjaftueshëm për t'i kryer detyrat e QPS-ve, të parapara me ligj. Në veçanti, sa u përket fëmijëve, shumica e QPS-ve nuk janë në gjendje ta përmbushin obligimin ligjor rreth Organit të Kujdestarisë. Asnjë QPS nuk ka psikolog të licencuar, i cili mund të japë mendimin profesional për besimin e fëmijëve për çështjet e adoptimit si dhe për fusha të tjera. Po ashtu, QPS-të nuk përfshihen në hartimin e buxhetit komunal dhe komunitat nuk parashohin mjete për mbulim të nevojave për fëmijë, për prindër vetushqyes, për viktime të trafikimit etj. Veçanërisht problematike është mungesa e hapësirës/dhomës së kontaktimit për realizimin e kontaktit fëmijë-prindër për rastet kur prindërit janë të ndarë apo të shkurorëzuar, ose që janë në proces të ndarjes apo të shkurorëzimit, si dhe në rastet e dhunës në familje. Nga 38 QPS, 22 prej tyre nuk kanë fare dhomë kontaktimi. Meqë vendimi i gjykatës obligon që realizimi i kontaktit të kryhet brenda hapësirës së qendrës, për ta kryer detyrën e tij, shumë shpesh ndodh që punëtori duhet të qëndrojë bashkë me prindin dhe me fëmijën gjatë kohës së zhvillimit të kontaktit, apo ta lirojë zyrën që ata të qëndrojnë së bashku. Në disa qendra, punëtorët shumë herë detyrohen ta vendosin fëmijën me prindin në një hapësirë ku gjendet ndonjë karrige dhe asgjë tjetër, apo në dhoma pa ngrohje dhe pa kushte minimale për qëndrim, qoftë 1 orë apo më gjatë, apo detyrohen të mos mbahen kontaktimet e plota, për shkak të kushteve jo të mira. Raporti konstaton se QPS-të janë shndërruar në institucione administrativo-teknike, për shkak të mungesës së stafit profesional dhe mungesës së objekteve përcjellëse për ofrim të shërbimeve adekuate. Ka mungesë të mbikëqyrjes, të planifikimit, të financimit dhe të avancimit të shërbimeve në përputhje me nevojat e komunave.

Avokati i Popullit u ka rekomanduar qeverisë së Kosovës, MPMS-së dhe komunave që t'i adresojnë problemet e identifikuara dhe gjatë vitit 2020 ka monitoruar zbatimin e tyre. Mirëpo sa i përket rekomandimit për rikthimin e mbikëqyrjes, përgjegjësinë dhe kompetencat menaxhuese ndaj QPS-ve nën ministrinë përkatëse, ky rekomandim nuk është pranuar nga qeveria, përkatësisht nga MPMS-ja me arsyetimin, pos tjerash, se nuk është në përputhje me legjislacionin dhe as me iniciativat e qeverisë dhe MPMS-së për avancimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Sa i përket ndryshim/plotësimit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, përmes të cilit do të rregullohej në tërësi mandati, roli, kompetencat, përgjegjësitë dhe struktura e qendrave për punë sociale, MPMS-ja ka pranuar rekomandimin dhe ka pohuar se projektligji është paraparë në programin legjislativ për vitin e ardhshëm. Ndërsa sa u përket rekomandimeve të tjera, më 29 dhjetor 2020 MPMS-ja e ka njoftuar Avokatin e Popullit se i ka pranuar rekomandimet e IAP-së për zbatim. Pos tjerash, ajo ka informuar IAP-në lidhur me afatet rreth aprovimit të iniciativave të QRK-së dhe të ministrive të linjës, të cilat do të ndikojnë në avancimin e shërbimeve sociale dhe adresimin e problemeve sipas raportit: Aprovimi i Ligjit për Shërbimet Sociale nga Qeveria e Republikës së Kosovës (2021); Aprovimi i Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal nga Qeveria e

Republikës së Kosovës (2021); Hartimi dhe aprovimi i udhëzimeve administrative sipas Ligjit të ri të Shërbimeve Sociale dhe Familjare (2022-2023); Hartimi dhe aprovimi i Udhëzimit Administrativ për formulën e financimit Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale (2021); Hartimi i Rregullores së Sistematizimit dhe Riorganizimit të Brendshëm të MPMS-së (2021); Hartimi i Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë (2021); Hartimi dhe aprovimi i udhëzimeve administrative sipas Ligjit të ri të Ndhmave Sociale (2022); dhe Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore sipas legjislacionit të ri (2022-2023).

Ndërsa sa u përket komunave, kryetari i komunës së Junikut e ka njoftuar Avokatin e Popullit: *“(...) QPS në Komunën e Junikut është tërësisht funksionale, ku ofrohen të gjitha shërbimet për qytetarë....si dhe është funksionuar organi i kujdestarisë që vepron në kuadër të QPS-së (...).”* Komuna e Parteshit e ka njoftuar Avokatin e Popullit se e ka filluar procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, ku midis tjerash është paraparë edhe krijimi i një administrate/drejtorie të re për shëndetësi dhe mbrojtje sociale, ku brenda kësaj drejtorie do të funksionojë edhe Qendra për Punë Sociale dhe Qendra e Mjekësisë Familjare. Komuna në buxhetin për vitin 2020 e ka parashikuar numrin e stafit të nevojshëm dhe mbështetjen financiare për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës në këto dy qendra dhe çdo ndryshim i statutit do të varet nga miratimi i buxhetit të shtetit, miratimi i kërkesës për personel dhe i mbështetjes financiare. Komuna e Kllokotit ka njoftuar: *“Objekti për Qendër për punë sociale është ndërtuar, mirëpo edhe më tutje nuk është funksionalizuar, sepse hapja e kësaj qendre nuk varet nga komuna, por nga Ministria përkatëse.”* Komuna e Graçanicës ka kthyer përgjigje, por jo për zbatim të rekomandimit, por ka kërkuar takime shtesë me IAP-në; dhe Komuna e Mamushës, e cila, përkundër dërgimit të dy letrave përsëritëse, nuk është përgjigjur fare⁹⁷.

Drejtësia për të mitur

Drejtësia për të mitur në Kosovë rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur (KDM), i cili është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në shtator të vitit 2018. KDM-ja rregullon procedurën penale për të miturit, duke e siguruar realizimin e interesit të tyre më të mirë bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, ndalimin e diskriminimit në çfarëdo baze si dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve që të shprehin lirshëm mendimin e tyre. Po ashtu, KDM-ja ka për qëllim të evitojë kufizimin e lirisë personale të të miturve në masë sa më të madhe të mundshme dhe promovon qasjen e drejtësisë miqësore. KDM-ja është i drejtuar në dhënien e përparësisë së zbatimit të masave edukuese përballë dënimit me burgim, me fokus në dhënien përparësi edukimit dhe risocializimit, aftësimin dhe specializimit përmes një qasjeje shumëdisiplinore dhe bashkëpunimit institucional. Qasja në sistemin arsimor është veçanërisht e rëndësishme për

⁹⁷ Meqenëse Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mori përgjigje nga Komuna e Mamushës, si përgjigje ndaj rekomandimeve në fjalë, as në letrën përsëritëse, më 12 nëntor 2020, është dërguar letra e dytë përsëritëse për Komunën e Mamushës duke ia rikujtuar nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 18 e 25 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

ta realizuar risocializimin dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri.

Marrë parasysh situatën e krijuar me pandeminë COVID-19, në maj të këtij viti IAP-ja, Zyra e UNICEF-it në Kosovë dhe KOMF-i i dërguan një Deklaratë të përbashkët për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së të miturve të dënuar: presidentit, kryeparlamentares, Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial dhe Ministrisë së Drejtësisë.⁹⁸ Deklarata u bën thirrje institucioneve për t'i shqyrtuar mundësitë që janë në kuadër të ligjeve në fuqi, në afat sa më të shpejtë të mundshëm, aty ku janë plotësuar kushtet ligjore, të ndërmerren vendimet, qoftë për zëvendësim apo për shqyrtim të masave edukative institucionale, zëvendësim të paraburgimit, lirim të parakohshëm, lirim me kusht, apo edhe për falje të dënimeve.

Detyrimet pozitive të shtetit lidhur me të drejtën për jetë

Gjatë vitit 2020, Avokati i Popullit ka monitoruar zbatimin e Raportit me rekomandime ex-officio për shkeljen e detyrimeve pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetë në rastin e K. V., të cilit i është marrë jeta nga një person tjetër⁹⁹. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka njoftuar IAP-në se ndaj dy prokurorëve të dyshuar në rastin e K. V., është iniciuar procedura disiplinore në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Pas shqyrtimit të lëndës, Këshilli Prokurorial i ka shqiptuar njërit prokuror masën disiplinore *Zvogëlim i përkohshëm i pagës në tridhjetë përqind (30%) për një periudhë kohore gjashtë (6) muaj*, ndërsa ka konstatuar se prokurorja tjetër nuk e ka kryer shkeljen e supozuar disiplinore. Sa i përket policisë, IAP-ja është njoftuar se Policia e Kosovës (PK) në baza vjetore harton planin e trajnimeve për punonjësit e saj duke synuar që të gjithë punonjësit të marrin trajnime adekuate varësisht prej pozitës të cilën e ushtrojnë. Në këtë rast çdo hetues i cili është emëruar për të hetuar një rast ku fëmija është viktimë e dhunës seksuale, paraprakisht ai është trajnuar në këtë fushë si me trajnime bazike ashtu edhe me trajnime të avancuara.

Vetëm gjatë vitit 2019, PK-ja ishte fokusuar në mbajtjen e trajnimeve në bashkëpunim me Këshillin e Evropës lidhur me KEDNj-në, veçanërisht me obligimet pozitive të shtetit karshi mbrojtjes së këtyre të drejtave, duke përfshirë edhe të drejtën për jetë si dhe trajnime të tjera lidhur me eksploatimin seksual të fëmijëve. Po ashtu, PK-ja ka theksuar se Divizioni i trajnimeve mban vazhdimisht aktivitete nga organizata vendore dhe ndërkombëtare në këtë

⁹⁸ Shih: Deklaratë e përbashkët e Avokatit të Popullit, UNICEF-it dhe KOMF-it (Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve) – Thirrje për veprim “T’u japim një shans të miturve”, 2020, në: <https://www.oik-rks.org/2020/05/22/deklarate-e-perbashket-e-avokatit-te-popullit-unicef-dhe-komf/>.

⁹⁹ IAP, Raporti me rekomandime Ex-Officio 567-2019 në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në rastin e K. V., 2019, në: <https://www.oik-rks.org/2019/12/09/raporti-me-rekomandime-ex-officio-567-2019-ne-lidhje-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-te-garantuara-me-ushtetuten-e-republikes-se-kosoves-si-dhe-menenin-2-te-konventes-evropjane-per-mbrojtjen-e-te-d/>.

fushë. Ndonëse në përgjigjen e tyre PK-ja ka njoftuar se njoftimi i Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave në rastet kur fëmija është viktimë e dhunës seksuale është praktikë që zbatohet vazhdimisht, IAP-ja rikujton edhe një herë se kjo nuk ka ndodhur në rastin e K. V. dhe në fakt kjo tregon se kjo praktikë nuk respektohet çdoherë. Gjithsesi, PK-ja ka theksuar se rekomandimet e IAP-së do të merren parasysh dhe do ta nxisin PK-në të kërkojë më shumë lidhur me ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve policorë në forma të ndryshme. Më 31.8.2020, IAP-ja ka pranuar një sqarim lidhur me Rekomandimin EX-officio nr. 567/2019 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), i cili nuk adreson rekomandimet specifike të raportit, por vetëm i diskuton ato në pika të përgjithshme. Andaj, më 20 nëntor 2020, i është dërguar letra përsëritëse MPMS-së duke ia rikujtuar nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 18 e 25 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, por deri më tani nuk është marrë përgjigje.

Parandalimi i martesave të fëmijëve

Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime ex-officio në lidhje me parandalimin e martesave të fëmijëve, me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të nenit 16, paragrafët 2 dhe 3, të Ligjit për Familjen.¹⁰⁰ Neni 16 i Ligjit për Familjen përcakton se martesa e një të mituri mbi 16 vjeç mund të lejohet nga gjykata kompetente nëse konstatohet se i mituri ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për t'i realizuar të drejtat dhe detyrimet martesore.

Studime të shumta dëshmojnë se martesat e hershme kanë ndikim negativ në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Martesa e hershme ndikon në fuqinë vendimmarrëse të vajzave brenda në familje dhe i bënë ato më të ndjeshme ndaj dhunës dhe keqpërdorimeve seksuale¹⁰¹. Në Kosovë, ky fenomen ndikon në mënyrë joproportionale tek vajzat dhe komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali, meqë më shumë fëmijë nga këto komunitete martohen më herët dhe më shumë vajza martohen sesa djem. Sipas Anketës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitet 2013-2014, 10.0% vajza dhe 1.0% djem të moshave 20-49 vjeç, për herë të parë janë martuar ose kanë hyrë në bashkëjetesë para moshës 18 vjeçe. Ndërsa 12% e vajzave nga komunitetet ashkali, egjiptian dhe rom janë martuar para moshës 15 vjeçe dhe 43% para moshës 18 vjeçe. Po ashtu, Analiza Gjimore e Kosovës raporton se në vitin 2014 janë martuar 95 vajza nën moshën 18 vjeçe, pasuar nga 109 të tilla në vitin 2015 dhe 63 në vitin 2016, kurse te djemtë e mitur nuk është raportuar asnjë rast i martesës.¹⁰²

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) nuk e ndalon shprehimisht martesën e fëmijëve, mirëpo Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, si autoritet interpretues i Konventës, ka theksuar se moshë minimale për martesë duhet të jetë moshë 18 vjeçe, si për djemtë ashtu edhe për vajzat.

¹⁰⁰ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport me rekomandime ex-officio, Rasti nr.206/2019 në lidhje me parandalimin e martesave të hershme, 2020, në: <https://www.oik-rks.org/2020/08/13/raport-me-rekomandime-ex-officio-rasti-nr-2062019-ne-lidhje-me-parandalimin-e-martesave-te-femijeve/>.

¹⁰¹ Po aty, fq.20.

¹⁰² Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjimore e Kosovës, 2018, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>.

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave dhe Komiteti për të Drejtat e Fëmijës në rekomandimin e përbashkët të tyre përcaktojnë martesën e hershme të fëmijëve si praktikë të dëmshme dhe u rekomandojnë shteteve të vendosin politika dhe mekanizma efektivë për parandalimin e tyre¹⁰³. Mes tjerash, rekomandimi thekson se martesat e fëmijëve shoqërohet shumë shpesh me shtatzëni të hershme dhe lindje të hershme të fëmijëve, kontribuon në shtimin e përqindjes së braktisjes së shkollimit, veçanërisht në mesin e vajzave, largimit me forcë nga shkolla dhe rrezikun e shtuar për dhunë në familje, përveç kufizimit të gëzimit të së drejtës për liri të lëvizjes. Më tutje Asambleja e Këshillit të Evropës u ka kërkuar parlamenteve të vendeve anëtare që ta rregullojnë apo ta rrisin moshën minimale të martesës për gra dhe për burra, deri në 18 vjeç.

E drejta për identitet ligjor

Çdo fëmijë ka të drejtë për identitet. Neni 8 i KDF-së, që ka të bëjë me emrin, kombësinë dhe marrëdhëniet familjare të një fëmije ose të të riu, thotë se qeveria nuk duhet të ndërhyjë në të drejtën e një fëmije ose të të riu për ndonjë nga këto. Gjithashtu thotë se qeveria duhet të jetë në gjendje të ndihmojë nëse kjo e drejtë u shkelet fëmijëve. Edhe LMF-ja ka paraparë se fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme¹⁰⁴.

Lidhur me këtë të drejtë, IAP-ja publikoi Raport me rekomandime Ex-officio, Rasti nr. 148/2020 në lidhje me identitetin ligjor për personat e peregjistruar¹⁰⁵, ku u bëri thirrje institucioneve shtetërore për trajtimin dhe ndërmarrjen e masave në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisë ligjore, që kanë lidhje me identitetin ligjor për personat e peregjistruar. Avokati i Popullit, në bazë të informatave të marra në terren dhe të ankesave të pranuar nga qytetarët, ka identifikuar 84 individë pa identitet ligjor, të cilët nuk mund të kenë qasje në të drejtat themelore të njeriut. Deri në publikimin e këtij raporti, 61 individë të moshave të ndryshme ishin duke pritur zgjidhje në nivelin administrativ, 23 në nivelin gjyqësor. Regjistrimi i lindjes, fitimi i shtetësisë si dhe pajisja me dokumente personale nga gjendja civile (regjistrimi civil) është një e drejtë themelore, e cila është e rregulluar nga shumë instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, njëkohësisht kjo çështje është normuar edhe me akte juridike ligjore dhe nënligjore vendore.

Regjistrimi në regjistrin civil dhe pajisja me dokumente personale ka një rëndësi të veçantë për këta individë, për arsye se pastaj do të shërbente si urë lidhëse për mundësinë e qasjes dhe gëzimit të të drejtave dhe të përfitimeve të tjera të parapara me akte juridike nacionale për shtetasit, si p.sh.: të drejtat civile politike, të drejtat ekonomiko-sociale, të drejtat kulturore

¹⁰³ Rekomandimi i përbashkët nr. 31 i Komitetit KEGFDG/ Komenti i përgjithshëm nr. 18 i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve mbi Praktikën e Dëmshme, 14 nëntor 2014.

¹⁰⁴ LMF, neni 33.

¹⁰⁵ IAP, Raport me rekomandime, Ex-officio, Rasti nr. 148/2020 në lidhje me identitetin ligjor për personat e peregjistruar, 2020.

etj. Pra, sikurse për personat të cilët kanë dokumente personale, përmes të cilave dëshmohet shtetësia e shtetit. GjEDNj-ja, në rastin Kuric dhe të Tjerë kundër Sllovenisë¹⁰⁶, gjeti shkelje të së drejtës për respektimin e “jetës private ose familjare” ose të të dyjave (neni 8 i Konventës), të drejtën për zgjidhje efektive (neni 13) dhe ndalimin e diskriminimit (neni 14, i lexuar bashkë me nenin 8) në lidhje me fshirjen nga regjistri i banorëve të përhershëm nga autoritetet sllovene, me ç’ rast rezultoi me humbjen e statusit ligjor të kërkuesve. GjEDNj-ja gjeti se shkelja në thelb kishte filluar me dështimin e zgjatuar të autoriteteve sllovene që ta rregullonin statusin e qëndrimit të kërkuesve pas “fshirjes” së tyre të paligjshme nga regjistri i banorëve të përhershëm dhe për t’ua ofruar atyre një zgjidhje të përshtatshme. Gjykata gjithashtu thotë se kërkuesit mund të pretendojnë se janë “viktima”, sipas nenit 34 të Konventës, për shkeljet e përmendura të të drejtave të tyre që rrjedhin nga Konventa. IAP-ja, pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që i ka, konstatoi se në rastin konkret, mospajtimi i identitetit ligjor për personat në fjalë përmban shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës në lidhje me sigurimin e identitetit ligjor për qytetarët e saj. IAP-ja i ka rekomanduar Komunës së Prishtinës, asaj të Graçanicës, të Fushë Kosovës, të Lipjanit, të Mitrovicës së Jugut, të Vushtrrisë, të Mitrovicës së Veriut, të Pejës, të Ferizajt, të Gjakovës, të Klinës dhe të Istogut t’i ndër marrin masat e nevojshme administrative dhe ligjore që t’ua mundësojnë këtyre individëve regjistrimin e faktit të lindjes dhe të shtetësisë.

Lidhur me këtë, IAP-ja ua ka drejtuar edhe një Mendim Juridik në Cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae): Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës Themelore në Pejë dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë.¹⁰⁷

Rreziku nga qentë endacakë

Gjatë vitit 2019 dhe 2020, IAP-ja kishte pranuar disa ankesa nga qytetarë dhe nga prindër, të shqetësuar për shëndetin dhe jetën e fëmijëve të tyre nga rreziku që shkaktonin qentë endacakë. Po ashtu, në takimet e përbashkëta, Avokati i Popullit ishte njoftuar nga vetë fëmijët se ata ndihen të rrezikuar dhe të shqetësuar vazhdimisht për jetën e tyre nga prania e qenve.¹⁰⁸

¹⁰⁶ Kuric dhe të tjerët kundër Sllovenisë, Kërkesa nr. 26828/06, Këshilli i Evropës: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 26 qershor 2012, në: <https://www.refworld.org/cases,ECHR,4fe9c88c2.html>.

¹⁰⁷ IAP, Mendim Juridik i IAP-së në Cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) drejtuar Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës Themelore në Pejë dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, 2020, në: <https://www.oik-rks.org/2020/08/11/mendim-juridik-ne-cilesine-e-mikut-te-gjykates-amicus-curiae-ex-officio-a-nr-1482020-drejtuar-gjykates-se-apelit-gjykates-themelore-ne-prishtine/>.

¹⁰⁸ Më 21 qershor 2019, Avokati i Popullit ka pritur në takim 20 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të komunës së Podujevës. Në këtë takim fëmijëve u dha mundësia që t’i dëgjonte Avokati i Popullit. Më 27 shtator 2019, Avokati i Popullit e ka vizituar Shkollën Fillore “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë, ku ishte pritur nga drejtori dhe mësimmëdhënësit e shkollës. Në këtë takim, ata e kanë njoftuar Avokatin e Popullit rreth punës dhe aktiviteteve

Numri në rritje i qenve endacakë paraqet problem të rëndësishëm për shëndetin publik dhe për mirëqenien e njerëzve dhe të kafshëve. Rreziku nga qentë endacakë, i cili u kanoset fëmijëve, është një rrezik real dhe serioz, i cili duhet trajtuar me kujdes nga të gjitha institucionet. Problemi i qenve endacakë është konsideruar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në aktgjykimin *Georgel and Georgeta Stoicescu v. Rumani*. Në rastin në fjalë, paraqitësja e kërkesës ishte ankuar për një sulm ndaj saj nga një turmë qensh endacakë dhe se autoritetet shtetërore kishin dështuar për zbatimin e duhur të masave ndaj qenve të shumtë endacakë, të cilët ishin rrezik për sigurinë e banorëve. Gjykata konstatoi se mungesa e masave të mjaftueshme të marra nga autoritetet në adresimin e kësaj çështjeje, së bashku me dështimin e tyre për të ofruar kompensim adekuat për dëmtime të qëndrueshme, paraqet një shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit të parashikuara me nenin 8 - “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare” të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁰⁹

Rrjedhimisht, për ta adresuar këtë problem, Avokati i Popullit në nëntor publikoi një raport me rekomandime, i cili, pas analizimit të gjendjes, praktikave ndërkombëtare dhe legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, konstatoi se në rastin konkret *ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut*, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës në lidhje me ndërmarrjen e të gjitha masave mbrojtëse.¹¹⁰

Masat e ndërmarra nga institucionet deri në publikimin e raportit nuk janë të mjaftueshme për të menaxhuar me efikasitet shtimin e qenve endacakë dhe për ta mbajtur atë nën kontroll, duke i parandaluar rreziqet për shëndetin dhe për mirëqenien e njeriut. IAP-ja ka vërejtur se përkundër përpjekjeve të disa komunave për trajtimin e qenve endacakë, gjendja nuk ka ndryshuar shumë, në mungesë të një plani kombëtar dhe koordinimi ndërkomunal dhe ndërinstitutional. Programi përfundimtar i menaxhimit duhet t’i përshtatet nevojave dhe karakteristikave të grupit lokal të qenve, duke shmangur një ndërhyrje të vetme për të gjitha situatat si dhe çdo metodë që përdoret duhet të bazohet në pikëpamjet etike dhe ligjore, duke shmangur vuajtjet e qenve. Raporti ofron rekomandime konkrete lidhur me veprimet që duhet t’i ndërmarrin institucionet për ta adresuar këtë rrezik ndaj qytetarëve dhe ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga shkeljet eventuale të të drejtave të tyre.

të Shkollës Filllore “Shtjefën Gjeçovi”, ku zhvillohej mësim nga nxënës të të tri komuniteteve njëkohësisht (shqiptar, kroat dhe rom).

¹⁰⁹ *Georgel and Georgeta Stoicescu v. Rumani*, Aplikacioni no. 9718/03, GjEDNj, 26 korrik 2011, para. 62.

¹¹⁰ IAP, Raport me rekomandime Ex-Officio, Rasti nr. 517-2019 në lidhje me rrezikun që u kanoset qytetarëve nga qentë endacakë, 2020, në: <https://www.oik-rks.org/2020/11/02/raport-me-rekomandime-ex-officio-rasti-nr-517-2019-ne-lidhje-me-rrezikun-qe-i-kanoset-qytetareve-te-republikes-se-kosoves/>.

IV. Barazia para ligjit

IV. Barazia para ligjit

Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm për mbrojtje nga diskriminimi

Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë, pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore, nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi si dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit, ku këto ligje përbëjnë pakon ligjore për të drejtat e njeriut dhe është në fuqi nga korriku i vitit 2015.

Në IAP, nga 1 janari 2020 deri më 31 dhjetor 2020, janë trajtuar 145 ankesa individuale, ku ankuesit pretendojnë se janë viktime të diskriminimit. Nga këto ankesa për hetim në pretendimet e ankuesve për diskriminim janë hapur 107 raste, ndërsa 38 ankesa janë shpallur të papranueshme.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka autorizim të hetojë ose të veprojë me vetiniciativë ex-officio kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik. Prandaj mbi këtë bazë, gjatë vitit për të cilin po raportohet, ka hapur për hetim 10 raste.

Pas hetimeve të rasteve të hapura vetëm në vitin 2020, ku ankuesit pretendojnë se janë viktime të diskriminimit, janë mbyllur 26 raste, ndërsa janë gjithsej 108 raste në procedurë të hetimit, të cilat janë mbyllur pas hetimeve gjatë vitit për të cilin po raportohet.

Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit u është drejtuar gjykatave në dy raste me mendime juridike, ua ka dërguar tri raporte me rekomandime si dhe dy letra me rekomandime.

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, në vitin 2020, është sfiduar për shkak pandemisë globale, virusi COVID-19, i cili ka ndikuar në thellimin e vështirësive në raport me garantimin e të drejtave të njeriut edhe në Kosovë, duke u hapur rrugë edhe sfidave të reja për institucionet në drejtim të përmbushjes së obligimeve ligjore, por edhe sa i përket zbutjes së pabarazive sociale.

Vlen të theksohet se, pavarësisht vështirësive të paraqitura gjatë pandemisë COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës u ka kushtuar vëmendje të shtuar detyrimeve pozitive të shtetit në raport me realizimin e të drejtave të njeriut. Gjatë vitit për të cilin po raportohet, Avokati i Popullit ka monitoruar të gjitha institucionet në nivelin qendror, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit ka vërejtur gatishmërinë e qeverise kundrejt respektimit të afateve ligjore për dhënien e përgjigjeve për IAP-në, përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve.

Sa i përket pushtetit gjyqësor, rastet e diskriminimit në procedurë gjyqësore vazhdojnë të jenë të pakta. Siç është thënë në raportin vjetor të mëparshëm, vazhdon të mungojë një sistem për monitorimin e duhur të rasteve të diskriminimit. Ende nuk është bërë identifikimi dhe kategorizimi adekuat i rasteve të diskriminimit.

Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që gjykatat e rregullta ta marrin parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut¹¹¹, kur vendosin për rastet e diskriminimit, me qëllim që të krijohet një praktikë e qëndrueshme kundër diskriminimit, bazuar në parimet primare të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë pjesë integrale rale e sistemit juridik të Kosovës. Avokati i Popullit vazhdon të jetë i përkushtuar drejt zhvillimit të marrëdhënieve që kontribuojnë në promovimin e barazisë duke përfunduar edhe me tej bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, si ato rajonale dhe ndërkombëtare, të cilat veprojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimin e mosdiskriminimit.

Diskriminimi në punë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton mbrojtje të barabartë ligjore dhe mosdiskriminim, të drejtën për punë dhe zgjedhjen e lirë të profesionit dhe lirinë e asociimit, përfshirë edhe lirinë për të formuar sindikata.¹¹² Kosova ka një kornizë themelore ligjore, e cila i rregullon çështjet e marrëdhënieve të punës¹¹³, mirëpo gjatë zbatimit të legjislacionit ekzistues të punës janë identifikuar disa mangësi.

Duke qenë se Kosova është një vend me aspirata të qarta për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian, qeveria tashmë e ka filluar procesin e reformës, në mënyrë që t'i eliminojë të gjitha mangësitë e identifikuara në fushën e legjislacionit të punës dhe përmes procesit legjislativ të harmonizohet me legjislacionin përkatës të BE-së, me qëllim që të përshpejtohet procesi i përafrimit ligjor.

Kjo vazhdon të nënkuptojë rritjen e kapacitetit të institucioneve mbikëqyrëse, forcimin e gjyqësorit dhe ndërmarrjen e masave të tjera përkatëse, të cilat do të kontribuojnë në mënyrë efektive dhe efektive në zbatimin e legjislacionit. Sa i përket reformës legjislative që ndërlihet me punën, Avokati i Popullit vlerëson faktin se nuk ka pasur vonesa dhe, gjatë kësaj periudhe, Zyra Ligjore e qeverisë përgatiti katër projektligje: Projektligjin për Inspektoratin e Punës, Projektligjin e Punës, Projektligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Prindërimit dhe Projektligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të cilat i janë dërguar qeverisë për shqyrtim dhe miratim. Po ashtu, në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë janë hartuar disa akte nënligjore, përkatësisht drafte të rregulloreve përkatëse.¹¹⁴ Avokati i Popullit e nënvizon

¹¹¹ Shih nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, shënimi 2, nenet 24, 44, 49.

¹¹³ Ligji i Punës (1 dhjetor 2010); Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë e Shëndetit në Punë (14 qershor 2013); Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt (5 shtator 2013); Ligji nr. 05/L-023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri (23 nëntor 2015); Ligji nr. 04/L-011 për Organizimin e Sindikatave në Kosovë (26 gusht 2011); Ligji nr. 03/L-200 për Greva (24 gusht 2010); Ligji nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-social (10 gusht 2011); Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve (17 korrik 2019); Ligji nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës (19 dhjetor 2002), me ndryshime - Ligji nr. 03/L-017 (10 shtator 2008).

¹¹⁴ Projekt-rregullorja për ndryshimet në Rregulloren Nr. 04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës; Projekt-rregullorja për ndryshimet në Rregulloren Nr. 05/ për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit kur përdorni pajisje pune në vendin e punës; Projekt-rregullorja për certifikimin dhe licencimin e personave që kryejnë veprimtari të sigurisë dhe shëndetit në punë; Projekt-rregullorja për vlerësimin e rrezikut.

domosdoshmërinë për miratimin dhe hyrjen në fuqi të këtyre akteve ligjore sa më shpejt që të jetë e mundur.

Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve gjatë pandemisë globale COVID-19

Avokati i Popullit, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, e monitoroi zbatimin e të drejtave në marrëdhëniet e punës, pranoi informacione nga institucionet përkatëse dhe mblodhi informacione nga terreni.

Shpallja e pandemisë botërore për shkak të COVID-19 e goditi rëndë edhe vendin tonë dhe ndikoi në funksionimin e rregullt të shumë sektorëve shoqërorë, posaçërisht atij ekonomik.

Autoritetet shtetërore, për shkak të detyrimit pozitiv në lidhje me sigurimin e së drejtës për shëndetin në vend, me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit, hartuan dhe vendosën rregulla të sjelljes dhe futën në fuqi masa mbrojtëse gjatë pandemisë. Për këtë qëllim, qeveria i miratoi propozimet e Ministrisë së Shëndetësisë, së bashku me Doracakun për mbrojtjen nga përhapja e virusit COVID-19, i cili e specifikon mënyrën e organizimit të punës në të gjitha ndërmarrjet private, në ndërmarrjet publike, në institucionet publike dhe gjatë çdo aktiviteti tjetër.¹¹⁵

Gjatë pandemisë COVID-19, e drejta për të punuar, dhe veçanërisht të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës¹¹⁶, kanë një lidhje të ngushtë me të drejtën për shëndetin.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit e vëren se stafi kyç në disa profesione ka punuar më shumë se kurrë dhe ka qenë më i ekspozuar se të tjerët ndaj rrezikut të infektimit në punë. Të punësuarit në profesione të caktuara kanë pësuar një barrë joproporcionale në përpjekje për ta ndalur përhapjen e virusit, për ta mbrojtur shëndetin dhe jetën e njeriut dhe për ta siguruar plotësimin e nevojave themelore të jetesës.

Të punësuarit në objektet shëndetësore, gjegjësisht personeli mjekësor dhe personeli jomjekësor në vendet e punës të ekspozuara ndaj pacientëve të infektuar¹¹⁷, përfshirë policët e Policisë së Kosovës, rojet e Shërbimit Korrektues, zjarrfikësit e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, ushtarët e FSK-së, punëtorët që kanë punuar në karantinë - Qendra e Studentëve në Prishtinë, inspektorët e Inspektoratit të Punës, inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës, doganierët e Doganës së Kosovës, inspektorët e Inspektimit të Tregut

¹¹⁵ Raporti tremujor i Qeverisë së RK, 3 qershor -10 shtator 2020, faqja12.

¹¹⁶ E drejta për kushte të dinjitetshme pune, e drejta për të zgjedhur lirisht ose për të pranuar punë, e drejta për kompensim adekuat, e drejta për një ditë pune të kufizuar dhe pushim me pagesë, e drejta për pagë të barabartë për punën me vlerë të barabartë, e drejta për trajtim të barabartë dhe e drejta për kushte të sigurta dhe higjienike pune.

¹¹⁷ Përfshin mjekë dhe infermierë, por edhe terapistë të frymëmarrjes dhe të gjithë profesionistët e tjerë shëndetësorë, të cilët kanë nevojë të hyjnë në dhomën ku qëndrojnë pacientët e infektuar, si dhe stafin bazë jomjekësor, i cili çdo ditë mirëmban higjienën e dhomave ku qëndrojnë pacientët e infektuar, punëtorët e mirëmbajtjes së dhomës për përgatitjen e ushqimit, ndihmësit e kujdesit për pacientin, teknikët për kujdesin ndaj pacientëve dhe administrata; të gjithë ata që vijnë rregullisht për të punuar në institucione me pacientë të infektuar për të kryer shërbime jetësore.

dhe inspektimet përkatëse komunale, si: shërbyesit e Inspektoratit të Mjekësisë së Punës, punonjësi socialë, policët, punëtorët në dyqane ushqimore, në prodhimin dhe përpunim e ushqimit, furnizuesit e ushqimit, shoferët në transportin publik, shoferët e taksive dhe të kamionëve, përkundër masave të përcaktuara të mbrojtjes, kanë qenë në rrezik më të madh nga infektimi, sepse mbrojtja e përshkruar nuk ka qenë gjithmonë e qasshme, e përshtatshme, as nuk ka mundur t'u siguronte atyre garanci për mbrojtje të plotë nga infeksioni.

Mirëpo nuk ka dyshim se disa punëtorë në sektorin shëndetësor të Kosovës, për shkak të përfshirjes së tyre të drejtpërdrejtë në luftën kundër pandemisë, iu ekspozuan rrezikut të lartë për shëndetin e tyre. Puna e institucioneve shëndetësore dhe stafit të punësuar, të cilët punuan pothuajse pa ndërprerje gjatë kësaj periudhe, u vështirësua edhe më shumë për shkak të numrit të madh të punëtorëve që u infektuan me COVID-19.

Me paketën e saj urgjente të masave, qeveria ka siguruar gjithashtu shtesa të caktuara të pagave për të punësuarit në institucionet publike, të cilët i janë ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punë.

Kur flasim për biznesin privat, ai ishte pothuajse i paralizuar për shkak të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim që ta mbronte popullatën nga përhapja e virusit, gjë që ndikoi në të ardhurat e shumë bizneseve private, sepse ky sektor është pothuajse plotësisht i varur nga tregu i brendshëm. Duke marrë parasysh që sektori privat kryeson në numrin e popullsisë së punësuar,¹¹⁸ vështirësitë e shkaktuara nga pandemia më së shpeshti i kanë goditur të punësuarit në këtë sektor.

Qeveria me vendim¹¹⁹ i ka kufizuar aktivitetet e disa bizneseve, si: kafenetë, baret, restorantet, qendrat tregtare, tregjet e hapura për kafshë dhe për automjete, me qëllim që të shmanget përhapja e virusit mes qytetarëve, gjë që ka shkaktuar mungesë të të ardhurave të tyre.

Ato biznese që operuan edhe gjatë kohës së pandemisë janë prekur nga vendime të tjera të qeverisë, të cilat e kufizuan lirinë e lëvizjes së qytetarëve për orë të caktuara dhe kjo masë kufizuese ndikoi edhe në punën e këtyre bizneseve.¹²⁰

Për shkak të përkeqësimit të situatës, reagimit të shoqërisë civile dhe të Odës Ekonomike të Kosovës, qeveria miratoi Pakon Emergjente Fiskale¹²¹ për tejkalimin e krizës, e cila, përveç sektorit publik, e përfshinte edhe sektorin privat. Me këtë pako, qeveria përfshiu tri kategori

¹¹⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e tregtisë së jashtme, shkurt 2020. 23.3.2020, qasja në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-sejashtme-stj-shkurt-2020>, e rishikuar nga IAP-ja më 22.4.2020.

¹¹⁹ Vendimi numër 01/09, i datës 13.3.2020. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Scan-14Mar-2020.pdf>.

¹²⁰ Vendimi 01/15, datë 23 mars 2020.

¹²¹ Vendimi numër 01/19, i datës 30.3.2020: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimii-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>

të punëtorëve të prekur ose të dëmtuar për shkak të mbylljes së biznesit ose mungesës së të ardhurave për ato biznese.

Avokati i Popullit thekson se në kohën e pandemisë, të gjithë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, edhe pse me staf të reduktuar, kanë punuar rregullisht dhe kanë qenë në dispozicion të punonjësve për të paraqitur parashtrësia për shkelje të të drejtave të punës që kanë të bëjnë me rishikimin e ligjshmërisë së vendimeve të punëdhënësve.

Me qëllim të forcimit të kapacitetit të institucioneve të shëndetit publik gjatë pandemisë, është punësuar një numër i ekspertëve shëndetësorë. Mungesa e punonjësve shëndetësorë është një sfidë serioze, kur bëhet fjalë për trajtimin adekuat të pacientëve jo vetëm të atyre të sëmurë me COVID-19, por edhe të atyre me sëmundje të tjera. Në këtë drejtim, qeveria ka paralajmëruar punësimin e një numri edhe më të madh të punëtorëve shëndetësorë.¹²²

Avokati i Popullit e mirëpret miratimin e Ligjit nr.07-L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke vlerësuar se është i rëndësishëm për ekonominë dhe rikuperimin e saj nga pasojat e pandemisë.

Avokati i Popullit shqyrtoi ankesën,¹²³ të cilën e kanë parashtruar disa punëtorë kundër Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), për shkak të shkeljeve që kanë të bëjnë me parimin e mundësive të barabarta, të meritës, të transparencës, të profesionalizmit dhe të paanësisë politike, përkitazi me degradimin e ankuesve në vendin e punës, në funksion dhe në pagë. Në këtë çështje, Avokati i Popullit gjeti shkelje, duke theksuar se sipas aktgjykimeve të GjEDNj-së: *“E drejta për të mos qenë të diskriminuar shkelet kur shtetet i trajtojnë njerëzit në mënyrë të pabarabartë [...] duke mos dhënë arsytetime objektive dhe të arsyeshme. Që një arsyetim i tillë të jetë "objektiv dhe i arsyeshëm" duhet të ndërmerren dy hapa: Së pari, duhet të ekzistojë "qëllimi legjitim" për pabarazinë në fjalë dhe së dyti, duhet të ekzistojë një "raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit, i cili synohet të arrihet.”*

Avokati i Popullit, duke vepruar në bazë të ankesave të ankuesve¹²⁴ kundër Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), parashtrroi Opinionin në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae),¹²⁵ dhe argumentoi bazën ligjore në lidhje me këtë rast. Natyra e ankesës ka të bëjë me diskriminim për shkak të përkatësisë politike dhe mendimit politik me rastin e ndërrimit të vendit të punës.

¹²² Raporti tremujor i Qeverisë RK, 3 qershor -10 shtator 2020, faqe 14.

¹²³ A.nr.993/2019.

¹²⁴ A.nr.520/2019 dhe A.nr.530/2019.

¹²⁵ <https://www.oik-rks.org/2020/09/24/mendim-juridik-i-avokatit-te-popullit-te-republikes-se-kosoves-ne-cilesine-e-mikut-te-gjykares-amicus-curiae-drejtuar-gjykares-themelore-ne-prishtine-a-nr-5292019-hamdi-hoxha-dhe-a-nr-5302019-flu/>

Në bazë të provave të paraqitura dhe të fakteve të mbledhura për rastin, si dhe ligjeve përkatëse, Avokati i Popullit ofroi një analizë ligjore të këtyre rasteve dhe e paraqiti mendimin e argumentuar se në rrethanat ekzistuese të rasteve, ricaktimi nga ATK-ja i vendeve të punës së ankuesve paraqet akt diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, sepse ATK-ja dështoi të ofronte dëshmi bindëse se me rastin e riorganizimit të ATK-së, në përputhje me Rregulloren e Brendshme, e miratuar më 17 maj 2019, ndaj parashtruesve të ankesës është vepruar pa diskriminim dhe në përputhje me ligjin në fuqi. Aq më tepër kur ATK-ja ka shpallur konkurs për tri pozita të zëvendësve të drejtorit të përgjithshëm dhe më pas ka emëruar disa drejtorë si ushtrues detyre, duke mos i sistemuar drejtorët e deritanishëm, të cilët i ka konsideruar si tepëricë e punëtorëve, përfshirë edhe parashtruesit e ankesës. Rrjedhimisht, një praktikë e tillë e ATK-së në rastin konkret përbën diskriminim, pasi parashtruesit e ankesës janë trajtuar ndryshe nga ana e ATK-së, për shkak të faktit se ata nuk janë vendosur në pozita ekuivalente të punës, të cilat ishin të lira dhe për të cilat ATK-ja ka shpallur konkurs. Gjithashtu këto veprime të ATK-së janë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe me parimin e sigurisë juridike.

Gjithashtu u nxor përfundimi se Rregullorja e brendshme e ATK-së, e datës 17 maj 2019, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.¹²⁶

Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të ankesës¹²⁷ kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjithashtu ka konstatuar se ekziston diskriminimi mbi bazën gjinore me rastin e punësimit në pozitat ekzistuese menaxhuese të nëpunësve civilë në AKP. Kjo çështje është shqyrtuar më hollësisht në pjesën e këtij raporti lidhur me barazinë gjinore.

Pozita e pensionistëve në kohën e pandemisë

Qeveria e Republikës së Kosovës, mes tjerash, përmes Pakos Emergjente Fiskale ka mbështetur pensionistët si dhe përfituesit e të gjitha skemave sociale. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur zvarritje, as vështirësi në pagesa të pensioneve dhe janë realizuar të gjitha përfitimet, bazuar në vendimet e qeverisë për luftën kundër COVID-19.

Në mënyrë që të shmangen tubimet para sporteve me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të pensionistëve, ministria përkatëse vendosi të mos i detyronte ata të paraqiteshin në administratën e pensioneve gjatë situatës së pandemisë. Gjithashtu, të gjithë pensionistët që e fitojnë të drejtën e pensionit për herë të parë, nëse nuk e kanë mundësinë e paraqitjes fizike në zyrat e pensionit, do ta kenë të drejtën e pagesës së pensionit nga dita e daljes në pension.¹²⁸

¹²⁶Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarur, neni 28, paragrafi 3, definon: “[...] 3. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat.”

¹²⁷ A.nr.550/2018.

¹²⁸ <https://mpms.rks-gov.net/sr/njoftim-i-mpms-per-te-gjithe-pensionistet-e-kosoves/>, qasja më 01.12.2020.

Megjithëse qeveria tashmë ka ndërmarrë disa hapa në reformën e sistemit të pensioneve dhe të përfitimeve, ajo planifikon të hartojë një ligj të vetëm për pensionet, i cili do t'i mbulojë dhe do t'i trajtojë të gjitha të drejtat e pensioneve në një dokument, si dhe krijimin e një Fondi të Sigurimeve Sociale, ligj me të cilin do të përcaktohet struktura organizative, forma e menaxhimit, shkalla e kontributeve dhe pensioni invalidor, të gjitha me qëllim të harmonizimit me praktikën evropiane, por mbetet e paqartë se kur do të zbatohet plotësisht kjo reformë.

Avokati i Popullit gjatë periudhës për të cilën po raportohet, më 26 maj 2020, e publikoi një raport në lidhje me ankesën ¹²⁹ e paraqitur nga një numër i madh ankuesish për mungesën e hetimeve efektive dhe për cenimin e dinjitetit të një numri relativisht të madh të policëve nën hetim.

Me këtë raport, Avokati i Popullit vlerësoi se ankuesit ishin subjekt i një hetimi themelor joefektiv, i përcjellë në vazhdimësi me shkrime në media pa bazën e një trajtimi/analize adekuate për të garantuar që liria e shprehjes, përkatësisht liria e mediave të mos abuzohet në kuptim të cenimit të dinjitetit të njeriut, të privatësisë, të përhapjes së gjuhës së urrejtjes, të mosdurimit dhe të pasojave të tjera të dëmshme.

Gjithashtu, publikimi përmes mediave i të dhënave personale dhe sidomos zbulimi i identitetit të personave të dyshuar, pa një kujdes të shtuar, cenon dinjitetin e palëve në procedurë penale dhe shkel parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurve.

Raporti konstaton shkelje të të drejtave të këtyre personave nën hetim dhe i rekomandon Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, që në pajtim me kompetencat dhe me autorizimet ligjore, sa më parë t'i përmbyllin hetimet lidhur me çështjen e zyrtarëve policorë që trajtoi ky raport, në mënyrë që kjo çështje të marrë epilog.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit vërejti se formularët e aplikimit për pension të të gjitha skemave të pensioneve në Kosovë janë të qasshme vetëm në gjuhën shqipe. Për më shumë, u informua se edhe vendimet për pensione për pensionistët nga komuniteti serb u dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe. Duke qenë se të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Republikës së Kosovës, lidhur me mangësinë e paraqitur, Avokati i Popullit njoftoi Komisionarin për Gjuhët, si mekanizëm për monitorimin e ushtrimit të të drejtave gjuhësore në Kosovë dhe për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

¹²⁹A.nr.717/2019

Personat me aftësi të kufizuara

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës në mënyrë të qartë e ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar.¹³⁰ Përveç ligjeve të veçanta,¹³¹ të cilat i rregullojnë çështjet e personave me aftësi të kufizuar, Kosova ende nuk e ka një ligj të harmonizuar gjithëpërfshirës, i cili do t'i adresonte të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, me qëllim të harmonizimit të legjislationit të Kosovës me instrumentet ndërkombëtare, të nevojshme për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Megjithatë, pavarësisht nga fakti se ministria e linjës ka filluar me hartimin e një dokumenti gjithëpërfshirës të ligjit për këtë fushë, nuk ka progres të dukshëm në këtë drejtim.

Mirëpo, përkundër kornizës ekzistuese legjislative, personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të përballen me diskriminim dhe me vështirësi të shumta për punësim, për qasje në hapësirat publike dhe në institucione, për qasje të barabartë në arsim, në transport publik dhe në shërbime të tjera.

Numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuar në Kosovë nuk është i njohur dhe është vështirë të përcaktohet, për shkak të përkufizimeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar dhe terminologjisë jo të përshtatshme dhe të vjetruar.

Shërbimet shëndetësore dhe rehabilituese, asistencë sociale dhe pajisjet ndihmëse për personat me aftësi të kufizuar mbeten edhe më tutje të pamjaftueshme. Kosova vazhdon të ketë mungesë të një sistemi adekuat për akomodimin dhe trajtimin e të paraburgosurve me probleme të shëndetit mendor, kurse objektet e shëndetit mendor nuk i plotësojnë standardet themelore dhe janë kryesisht të mbipopulluara. Shërbimet shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuar gjithashtu nuk janë të një cilësie të pranueshme dhe sistemi shëndetësor vazhdon të luftojë për t'ua siguruar atyre ilaçet themelore dhe pajisjet mjekësore.¹³² Pengesat për ta ushtruar të drejtën e informimit, në kuptimin e marrjes së informacionit përmes shkrimit Braille për personat me shikim të dëmtuar dhe për personat e verbër, si dhe mungesa e interpretuesve të gjuhës së shenjave për personat me dëgjim të dëmtuar gjatë transmetimit të programit informativ televiziv, i privon ata nga qasja në informacionet e rëndësishme të përditshëm dhe në një farë mase ndikon në përfshirjen e tyre të plotë shoqërore, si anëtarë të barabartë të shoqërisë. Njerëzit me nevoja të veçanta vazhdojnë ta vuajnë stigmatizimin e shoqërisë.

¹³⁰ Shih nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në mënyrë të qartë ndalon diskriminimin e bërë nga punëdhënësit dhe thekson nevojën për mundësi të barabarta dhe trajtimin e personave me aftësi të kufizuara në punësim, trajnim dhe rikualifikim dhe garanton mbrojtjen e tyre ligjore.

¹³¹ Ligji nr. 2003/23 për Personat me Aftësi të Kufizuara; Ligji Nr. 03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme; Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; Ligji nr.04/L-092 për Personat e Verbër; Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

¹³² Për këtë është raportuar me më shumë detaje në pjesë të veçanta të këtij raporti për të drejtat e fëmijëve dhe Mekanizmit Kombëtar për Mbrojtjen nga Tortura.

Midis grupeve të tjera të cenueshme, edhe personat me aftësi të kufizuar janë përballur gjithashtu me sfida të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë COVID-19.

Sa i përket mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, gjatë periudhës së pandemisë, qeveria në Paketën Fiskale¹³³ Emergjente ka siguruar përfitime të rregullta mujore. Për ata që marrin shumën më pak se 100 € në muaj, kanë pasur një pagesë shtesë prej 30 € për muajt: prill, maj dhe qershor, me kusht që të ishin përfitues të vetëm një skeme. Mirëpo, Avokati i Popullit ka vënë re se autoritetet kompetente i kanë neglizhuar nevojat e tyre të tjera, gjë që ka shpërfaqur pabarazi në raport me këtë grup specifik, siç është: ndikimi në mbrojtjen e tyre shëndetësore dhe qasjen në arsim.

Nisur nga situata ekonomike në vend, shumica e personave me aftësi të kufizuar jetojnë në kushte të rënda dhe varen nga ndihma sociale, gjë që e rrit edhe më shumë cenimin e tyre gjatë kësaj periudhe pandemie. Edhe në kohë normale, ata përballen me pengesa të konsiderueshme për qasje në kujdesin shëndetësor dhe në shërbimet e mbrojtjes sociale, të cilat ende nuk janë të kualitetit të përshtatshëm, as nuk u përshtaten nevojave të tyre specifike, kështu që masat e distancës sociale dhe të vetizolimi paraqesin një sfidë shtesë, përveç sfidave të rregullta, sepse një numër i konsiderueshëm i personave me aftësi të kufizuar ose nuk është i pavarur, ose në mënyra të ndryshme varet nga mbështetja e të tjerëve. Ndërkohë mund të pritet që ndikimi negativ i pandemisë në këtë popullatë të cenueshme të rritet edhe më shumë.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit, më 5 gusht 2020, e publikoi raportin me rekomandime,¹³⁴ sipas ankesës kundër Ministrisë së Infrastrukturës, lidhur me mungesën e ofrimit të qasjes së barabartë në transportin ndërurban për persona të verbër, në pajtim me Ligjin nr.04/L-092 për Personat e Verbër në Kosovë. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e MI-së për nevojën e ofrimit të qasjes së barabartë në transportin ndërurban për personat e verbër në Kosovë, në pajtim me Ligjin nr.04/L-092 për Personat e Verbër, përkatësisht me nenin 13, par. 1, dhe par. 2.

Avokati i Popullit, në bazë të dëshmive të paraqitura dhe të fakteve të mbledhura për rastin, si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, konstaton se ankesa është e arsyeshme dhe se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe në rastin konkret ka ardhur deri te shkelja e nenit 24, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe e theksoi se *çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve*, ashtu siç përcaktohet me nenin 21, par. 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se personat e verbër në rastin konkret janë vënë në pozitë diskriminuese mbi bazën e “aftësisë së kufizuar” në raport me udhëtarët e tjerë në

¹³³ Vendimi nr.31/2020, i datës 3.4.2020.

¹³⁴ A.nr.899/2018, qasja në <https://www.oik-rks.org>, pjesa “Raportet”.

mjetet e transportit ndërrurban (autobus), duke i privuar ata nga e drejta e tyre për t'i gëzuar përfitimet që burojnë nga Ligji nr.04/L-092 për Personat e Verbër, nenin 4, par. 1.¹³⁵

Me anë të këtij raporti, Avokati i Popullit i rekomandon MI-së ta bëjë plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.07/2015 për Licencimin e Operatorëve të Transportit Rrugor të Udhëtarëve me Autobus, në atë mënyrë që të përcaktojë se shërbimet e transportit ndërrurban për personat me aftësi të kufizuar duhet të kryhen me 50% të vlerës së biletës, në pajtim me Ligjin nr.04/L-092 për Personat e Verbër; në kriteret e licencimit të operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus të përcaktohet rezervimi i dy (2) ulëseve për persona me aftësi të kufizuar, së bashku me mjetet e tjera përcjellëse sinjalizuese; që MI-ja të përcaktojë minimumin se sa herë në muaj duhet bërë inspektimi i të gjithë operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve nga Departamenti i Inspektimit i MI-së. Avokati i Popullit ka rekomanduar po ashtu që deri në plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.07/2015 për Licencimin e Operatorëve të Transportit Rrugor të Udhëtarëve me Autobus, Departamenti i Inspektimit të bëjë kontrollë inspektimi më të shpeshta të operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve në autobusë urbanë dhe ndërrurbanë, me qëllim të zbatimit të plotë të obligimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.04/L-092 për Personat e Verbër dhe me akte të tjera nënligjore.

Gjithashtu gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit e shqyrtoi një ankesë lidhur me diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, e parashtruar kundër Komunës së Prishtinës, për shkak të dështimit të autoriteteve komunale për të ndërtuar dhe rregulluar hyrjen për personat me aftësi të kufizuar në ndërtesën e objektit të përbashkët nr. 14/2, në Dardani, Prishtinë, e cila nuk ka qasje të përshtatshme për njerëzit e kësaj kategorie. Megjithatë personi me nevoja të veçanta, i cili jeton në këtë ndërtesë, iu drejtua Komunës së Prishtinës disa herë me kërkesa për përshtatjen e qasjes së papenguar në objekt, në përputhje me nevojat e personave me nevoja të veçanta, Komuna nuk ndërmori ndonjë veprim.

Pas adresimit të kësaj çështjeje nga Avokati i Popullit, Komuna e Prishtinës njoftoi se është realizuar projekti i ndërtimit të qasjes për personat me aftësi të kufizuar në objektin në fjalë dhe është përshtatur qasja për nevojat e parashtruesit të ankesës.

Barazia gjinore

Pavarësisht zgjidhjeve të përmirësuara legislative dhe strategjike, gratë në shoqëri ende përballen me një varg problemesh në sfera të ndryshme të jetës private dhe publike, kështu që arritja e barazisë së grave në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe politike duhet të mbetet në

¹³⁵ Ligji nr.04/L-092 për Personat e Verbër, nenin 4, par. 1: “Personat e verbër mbrohen nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”) dhe paraqet shkelje të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi në Kosovë (neni 3, paragrafi 1, që e definon konceptin e diskriminimit: “Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Ligji”).”

krye të qëllimeve kryesore të shtetit. Pabarazia gjinore manifestohet nëpërmjet pjesëmarrjes ende të pamjaftueshme të grave në jetën politike, në pabarazinë ekonomike, në ndarjen e pabarabartë të përgjegjësisë në familje, dallimet në posedimin e pronës etj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me propozimin e 65 deputetëve, në seancën plenare të datës 25 shtator 2020, miratoi Amendamentin kushtetuese Nr. 26, me të cilin Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (apo siç quhet ndryshe edhe si Konventa e Stambollit) bëhet pjesë integrale e Kushtetutës.¹³⁶ Avokati i Popullit, duke qenë se edhe në raportet e mëhershme e ka shtruar nevojën e përfshirjes së kësaj Konvente në Kushtetutë, e konsideron hap pozitiv dhe është një tregues i vlerësimit të rëndësishëm që i është kushtuar kësaj të drejte nga Kuvendi. Konventa ua imponon shteteve nevojën e ndërmarrjes së veprimeve në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale dhe hartimin e politikave të integruara e që sigurisht do të ketë ndikim pozitiv në luftën kundër dhunës ndaj grave.

Konventa e Stambollit është traktati më i përparuar ndërkombëtar për të trajtuar të tilla shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Konventa synon të sigurojë tolerancë zero për këtë lloj dhune dhe është një hap i madh përpara për ta bërë Evropën më të sigurt.¹³⁷

Qëllimet e kësaj Konvente janë: mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave; hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

Rastet e diskriminimit gjinor rrallëherë raportohen qoftë për shkak të mosnjohjes së të drejtave, qoftë për shkak të mosbesimit në institucione. Praktika gjyqësore ende nuk është zhvilluar në masën e krijimit të një standardi i cili do të mundë të shërbente si orientues referimi për zgjidhjen e rasteve analoge të shfaqura. Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar 43 raste që lidhen me çështjet gjinore.

Niveli i lartë të papunësisë, rolet tradicionale gjinore dhe faktorët ekonomikë janë elementet kyçe që vështirësojnë pozitën e grave në tregun e punës. Varfëria, papunësia, mendësia të cilat janë përcjellë nga e kaluara, padyshim se ndikojnë në përfshirjen e barabartë në tregun e punës.

¹³⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31730>

¹³⁷ <https://rm.coe.int/168064d3f6>

Me miratimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 02/2019,¹³⁸ si një masë afirmative me synim që të vendosë raportet të barabarta mes dy bashkëshortëve dhe që ta avancojë të drejtën e gruas sa i përket çështjes së pronës dhe regjistrimit të saj në emër të të dy bashkëshortëve, duket sikur ka pasur ndikim pozitiv. Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 17 prill 2020, me Vendimin nr. 03/25 miratoi ndryshimet në këtë Udhëzim Administrativ, duke zgjatur afatin e vlefshmërisë së zbatimit nga periudha njëvjeçare, në periudhën pesëvjeçare.¹³⁹

Duke u bazuar në shoqërinë tonë tradicionale, ende praktikohet çështja e heqjes dorë nga trashëgimtarja në favor të trashëgimtarit, një situatë e tillë është e pranishme në të gjitha komunitetet në Kosovë. Në shumë raste, gratë heqin dorë nga trashëgimia, për arsye të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe për shkak të dëshirës për ruajtjen e lidhjeve të tyre me familjet e origjinës.

Të drejtat e komunitetit LGBTI

Përkundër faktit se ekziston kornizë ligjore e cila mbron të drejtat e këtij komuniteti, LGBTI, si pjesë e shoqërisë në Kosovë, konsiderohen të jetë kategori e marginalizuar. Është e evidente se qëndrimet homofobike ende janë të theksuara në shoqërinë e Kosovës. Edhe në raportet vjetore paraprake, Avokati i Popullit ka konstatuar se respektimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi mund të merret si tregues i zhvillimit demokratik të vendit, qoftë në nivelin legjislativ, qoftë në nivelin praktik. Personat LGBTI ende jetojnë me frikë për të shprehur orientimin e tyre seksual, për shkak të qasjes së shoqërisë dhe të homofobisë të përfaqësuesve të shoqërisë ndaj tyre dhe kjo është arsyeja që ata janë të diskriminuar në jetën e përditshme.

Sa i përket legjislacionit ekzistues, i cili rregullon të drejtat e personave LGBTI, është e evidente që kërkon plotësim lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor. Problem tjetër qëndron fakti se legjislacioni përkatës në këtë fushë nuk zbatohet në mënyrë adekuate. Është detyrim i veçantë i shtetit që t'i mbrojë të drejtat e njeriut, kryesisht përmes sistemit të vet ligjor, duke ofruar garanci shtesë për individin, që t'i gëzojë këto të drejta.

Kodi i ri civil, i dërguar në qeveri nga Ministria e Drejtësisë, ka paraparë disa ndryshime ligjore lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor.

Në ditën ndërkombëtare kundër homofobisë ishte mbajtur “Parada e Krenarisë”, e organizuar nga OJQ të cilat i mbrojnë interesat e qytetarëve të këtyre komuniteteve. Megjithatë, pandemia ka ndryshuar formën e marshimit në vitin 2020, dhe nën sloganin “Po, du”, këtë vit “Parada e Krenarisë” është organizuar me parakalimin e veturave nëpër rrugët e Prishtinës.

¹³⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19524>

¹³⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27729>

Kjo paradë ka bashkuar personat LGBTI dhe përkrrahësit e komunitetit për të kërkuar të drejta të barabarta për këtë komunitet.

Në kuadër të shënimit të “Javës së Krenarisë në Kosovë”, Avokati i Popullit përmes një deklarate ka kërkuar vëmendjen për garantimin e të drejtave themelore të njeriut për pjesëtarët e komunitetit LGBTI. Në këtë deklaratë, Avokati Popullit ka theksuar se ky komunitet është ende një nga grupet më të cenueshme në shoqërinë tonë. Gjithashtu ka rikujtuar se qëllimi i promovimit për drejtat e komunitetit LGBTI duhet të jetë efikas dhe për këtë shkak duhet të mbështetet me sanksionimin e vazhdueshëm të çdo veprë të kryer nga urrejtja në bazë të orientimit seksual.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë qenë të angazhuar në promovimin e të drejtave të personave nga këto komunitete edhe përmes pjesëmarrjes në disa takime, siç ishin edhe takimet e Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues në nivel Nacional në Republikën e Kosovës për të drejtat e komunitetit LGBTI, të organizuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Dhuna në familje

Gjatë periudhës së pandemisë është raportuar rritje e numrit të rasteve të dhunës në familje.¹⁴⁰ Në deklaratën e publikuar më 30 prill 2020 dhe më 25 nëntor 2020, Avokati i Popullit ka theksuar se derisa emergjenca shëndetësore ka bërë që puna në gjykata të ngadalësohet, siguria e viktimës dhe e fëmijëve të saj duhet të mbetet shqetësim parësor për institucionet e zbatimit të ligjit dhe për autoritetet gjyqësore për veprim të menjëhershëm, parandalim dhe mbrojtje.

Avokati i Popullit ka vënë re se në rastet e raportuara, reagimet dhe veprimet e organeve kompetente (policia, prokuroria dhe gjykata) vazhdojnë të mos jenë në nivelin e duhur. Këtë e dokumentojnë ankesat e pranuar në IAP përkitazi me zvarritjet e procedurave gjyqësore sa u përket rasteve të dhunës në familje. Por gjithashtu ka edhe raste ku viktimat e dhunës në familje hezitojnë t’i raportojnë rastet për shkaqe të ndryshme, e në mesin e të cilave edhe për shkak të lidhjeve emocionale me personin i cili ushtron dhunën, apo edhe për arsye se shoqëria vazhdon ta konceptojë dhunën në familje si një çështje private, e cila nuk duhet të paraqitet jashtë rrethit familjar.

Në Kosovë ekzistojnë tetë strehimore për viktimat e dhunës në familje dhe janë edhe dy strehimore të tjera, ku njëra nga to është e dedikuar për fëmijët të cilët u nënshtrohen dhunës në familje si dhe keqtrajtimit të tjera, ndërsa strehimorja tjetër është në funksion të viktimave nga trafikimi me qenieve njerëzore. Strehimoret luajnë një rol të rëndësishëm për rehabilitim dhe riintegrim e viktimave të dhunës në familje. Megjithatë, shqetësuese për Avokatin e Popullit është mungesa e mbështetjes institucionale për këto strehimore, sidomos problemi i pazgjidhur i financimit të qëndrueshëm, sepse mungesa e financimit të

¹⁴⁰ Deklarata e Avokatit të Popullit lidhur me dhunën në familje, më 30 prill 2020 dhe më 25 nëntor 2020.

qëndrueshëm për strehimoret përbën sfidën kryesore të punës së tyre gjatë ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje.

Faktorë të ndryshëm socialë, ekonomikë dhe kulturorë kanë ndikuar që niveli i dhunës në Kosovë të mbetet i pandryshueshëm. Megjithatë, bazuar në ankesat e ankueseve të paraqitura në IAP, një ndër problemet kryesore që e vështirëson pozitën e viktimave, del të jetë varësia ekonomike. Edhe pse ekziston një bazë solide ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje, duhet theksuar se zbatimi i ligjit nuk është në nivelin e duhur. Vlen të theksohet se zvarritja e procedurave gjyqësore në rastet e trajtimit të rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje është mjaft dekurajuese që raste e tilla të paraqiten. Në të shumtën e rasteve, gratë mbeten viktimat jo vetëm të dhunës së ushtruar nga bashkëshortët, por edhe të mosveprimeve dhe neglizhencës së institucioneve që për mandat kanë ofrimin e mbrojtjes dhe të ndihmës ndaj tyre.

Vazhdon edhe në këtë vit të mbetet i pazbatueshëm Ligji për mbikëqyrje të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës. Për zbatimin e këtij ligji në realizimin e mbikëqyrjes elektronike dhe raportim nga Policia e Kosovës të personave të cilëve u kufizohet lëvizja, Ministria e Punëve të Brendshme ka nxjerrë udhëzimin administrativ. Megjithatë, ky ligj edhe sot nuk është i zbatueshëm.¹⁴¹ Avokati i Popullit ka bërë hetim sipas detyrës zyrtare lidhur me moszbatimin e këtij ligji, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikonte në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, IAP-ja ka pranuar edhe rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.¹⁴² Me kërkesën e ankueseve, IAP-ja ka monitoruar proceset gjyqësore për viktimat e dhunës në familje.

Është inkurajues fakti se Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 20 shtator 2020, ka miratuar ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin Konventa e Stambollit përfshihet në Kushtetutë. Me përfshirjen e kësaj Konvente, përveçqë është zbatuar rekomandimi i Avokatit të Popullit, është plotësuar korniza ligjore dhe aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ky ndryshim obligon autoritetet shtetërore që në të ardhmen të angazhohen për t'i marrë masat e nevojshme dhe masa të tjera për të krijuar një sistem efektiv, gjithëpërfshirës dhe të koordinuar për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

¹⁴¹ Ligji nr. 05/L-003 për mbikëqyrje të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës.

¹⁴² A.nr.692/2020, A.nr.674/2020, A.nr.641/2020, A.nr.385/2020, A.nr.105/2020, A.nr.36/2020.

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

Avokati i Popullit, sikurse në raportet vjetore paraprake, vazhdon të shprehë shqetësimin e tij që Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nuk është pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁴³

Avokati i Popullit vlerëson se gjendja ekonomike dhe sociale në Kosovë vazhdon të jetë shqetësuese. Institucionet publike duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha në përmirësimin e situatës në aspektin social për grupet që konsiderohet si të marginalizuara në Kosovë.

Avokati i Popullit konstaton se sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë nuk është në nivel të kënaqshëm, si rezultat i mosfunksionimit adekuat të qendrave për punë sociale (QPS) në raport me ofrimin e shërbimeve sociale profesionale për të gjithë qytetarët e vendit, pa dallim.¹⁴⁴

Kosova vazhdon të ketë numër të lartë të papunësisë dhe mungesë të legjislacionit për sigurime shëndetësore. Gjatë kësaj periudhe raportuese, gjendja ekonomike dhe sociale në Kosovë është rënduar edhe më shumë si rrjedhojë e pandemisë globale COVID-19.

Avokati i Popullit edhe në këtë vit thekson nevojën që Qeveria e Republikës së Kosovës, në mënyrë urgjente, të ndërmarrë veprime përkitazi me zbatimin praktik të ligjit për Sigurimin Shëndetësor, i cili u miratua në prill të vitit 2014 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili vazhdon të mos gjejë zbatim në praktikë.¹⁴⁵

Më 14 gusht 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës.¹⁴⁶ Në nenin 10, paragrafi 2, përcaktohet se çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga COVID-19. Në kuadër të mbrojtjes së popullsisë nga pandemia COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës siguron mjete materiale shtesë për rastet emergjente, përfshirë mbulimin e shpenzimeve të izolimit, të ekzaminimit dhe të mjekimit në institucionet publike shëndetësore të personave të sëmurë dhe të personave për të cilët dyshohet se vuajnë nga COVID-19. Megjithatë, sipas informatave të cilat i ka Avokati i Popullit, një gjë e tillë nuk është duke u zbatuar në praktikë.

Më 21 gusht 2020, Avokati i Popullit hapi rast sipas detyrës zyrtare (ex-officio) kundër Ministrisë së Financave dhe kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkitazi me Vendimin nr.31/2020, i datës 3 prill 2020, sipas të cilit e ka aprovuar Planin Operacional për

¹⁴³ Shih <https://www.oik-rks.org/2020/04/02/raporti-vjetor-2019/> Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit, të vitit 2019, fq.74.

¹⁴⁴ Rasti Ex-officio nr. 59/2019 lidhur me vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë, Prishtinë, 17 dhjetor 2019.

¹⁴⁵ Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9450>

¹⁴⁶ Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=30819>

Pakon Fiskale Emergjente.¹⁴⁷ Në kuadër të këtij plani janë paraparë masat e asistencës për persona fizikë dhe juridikë, përfshirë edhe Masën nr.15, e cila ka të bëjë me pagesën e asistencës mujore në vlerë prej 130 eurosh për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar në institucionin kompetent si të papunë, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Republikës së Kosovës, për muajt: prill, maj dhe qershor, në vlerë deri në tre milionë euro. Për të qenë përfitues të kësaj mase, familjet në nevojë duhet t'i paraqesin kërkesat me shkrim dhe duhet t'i përmbushin kriteret e përcaktuara në kuadër të kësaj mase. Sipas informatave të cilat i ka Avokati i Popullit, shqyrtimin e kërkesave me shkrim të dorëzuara nga familjet në nevojë e kanë bërë qendrat për punë sociale në komunat nga vijjnë familjet aplikuese, të cilat janë obliguar bazuar në një vendim të MPMS-së.

Strehimi social

Avokati i Popullit vazhdon të pranojë kërkesa të shumta nga qytetarët në nevojë për mungesë të banimit.

MPMS-ja së bashku me komunat e Kosovës janë duke ndërtuar shtëpi për komunitetet joshumicë, të cilat janë përfituese të projektit kapital "Mbështetje për komunitetet joshumicë". Megjithatë, në bazë të informatave që i ka Avokati i Popullit, kërkesat për strehim janë ende të mëdha.

Avokati i Popullit ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me mospërgjigjen e komunave në kërkesat e ankuesve, të cilat i kanë parashtruar lidhur me pagimin e qirasë. Qytetarët që nuk kanë pronë të tyre, detyrohen të paguajnë qira dhe në disa raste ka zvarritje të procedurave për të vendosur lidhur me kërkesat e tyre nga komunat përkatëse. Në disa raste, komunat përkrahin financiarisht kërkesat e qytetarëve në nevojë për pagimin e qirasë, mirëpo kjo përkrahje financiare është e shkurtër për nga periudha kohore dhe qytetarët në nevojë detyrohen të parashtrjnë vazhdimisht kërkesa për këtë lloj përkrahjeje dhe në këtë mënyrë atyre nuk u ofrohet një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjate për strehim të tyre. Gjithashtu, në mungesë të pronës, qytetarët shpeshherë detyrohen t'i ndërrojnë vendbanimet e tyre dhe kjo situatë paraqet rrezik të vazhdueshëm në mirëqenien e këtyre familjeve.

Në fund të muajit nëntor 2020, Avokati i Popullit pranoi ankesë prej pesë familjeve kundër Komunës së Prishtinës.¹⁴⁸ Sipas pretendimeve të ankuesve, Komuna e Prishtinës i ka urdhëruar që ta lironin pronën komunale dhe komuna në fjalë ka nxjerrë vendime përmes së cilave do të bëhet subvencionimi i qirasë deri në zgjidhjen e çështjes së përhershme të banimit, por jo më tepër se 5 vjet, por ankuesit pohojnë se kanë kërkuar ndihmë nga komuna për sigurimin e banesave të përhershme, por nuk kanë hasur në mirëkuptim, me arsyetimin se nuk ka kushte e as mundësi. Avokati i Popullit është duke e hetuar këtë rast.

¹⁴⁷ Rasti i hapur sipas detyrës zyrtare (ex-officio) në IAP, me nr.488/2020.

¹⁴⁸ Rasti A.nr.689/2020.

Ndihmat sociale

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin lidhur me moszbatimin e rekomandimit të Avokatit të Popullit lidhur me mosndryshimin e Ligjit për Skema Sociale, përkatësisht kriterit për ndihmën sociale për familjet që nuk kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçe.¹⁴⁹ Megjithatë është shpresëdhënëse përgjigjja që Avokati i Popullit mori nga përfaqësuesja e MPMS-së, më 25 nëntor 2020, me njoftimin se koncept-dokumenti për ndryshimin e skemës së ndihmës sociale është miratuar dhe procesi i ndryshimeve ligjore do të zhvillohet gjatë vitit 2021.

Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave dhe Transfereve, mori Vendimin nr.38/2020, përmes të cilit përfituesit e skemës së ndihmës sociale do të marrin pagesë të dyfishtë të vlerës së skemës sociale për muajt: mars, prill dhe maj të vitit 2020. Një praktikë të tillë u përsërit edhe për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2020, e cila është duke u realizuar çdo muaj bashkë me pagesën e rregullt të kësaj skeme sociale. Një ndihmesë e tillë ka bërë të mundshme tejkalimin më të lehtë të situatës socio-ekonomike të familjeve përfituese në këtë kohë pandemie.

Ligji nr.07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike parasheh që pagat e punëtorëve në sektorin privat paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën kohore tetor-dhjetor 2020, të cilët si pasojë e pandemisë COVID-19, janë larguar apo pezulluar nga puna e tyre për periudhën jo më të shkurtër se tre muaj, pas datës 29 shkurt 2020 e deri më 30 dhjetor 2020.

Aktivitetet e Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Më 7 janar 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në konferencën: *“Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian”*, organizuar nga OJQ Balkan Sunflower.

Më 24 janar 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në takim: *“Integrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë”*, organizuar nga Kosovo Education Center (KEC).

Më 3 shkurt 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në tryezën: *“Matja e stigmës dhe diskriminimit ndaj popullatave kyçe në rrezik për HIV dhe personave që jetojnë me HIV në Kosovë”*, organizuar nga Integra, CDF-ja dhe nga Zyra e Avokatit të Popullit, dhe financuar nga Fondi Global.

Më 5 shkurt 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në takim me qytetarët e komunitetit serb në Lipjan, për të diskutuar për procedurat e ankimit në IAP.

¹⁴⁹ Rasti Ex-officio nr. 385/2016 në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/l-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, Prishtinë, 13 korrik 2018.

Më 6 dhe më 7 shkurt 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në trajnimin: *“Roli dhe mandatin i IAP në mbrojtjen e të drejtave të njeriut”*, i mbajtur në Graçanicë, organizuar nga Projekti IPA.

Më 27-28 shkurt 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në trajnimin: *“Roli dhe mandatin i IAP në mbrojtjen e të drejtave të njeriut”*, i mbajtur në Prizren dhe i organizuar nga Projekti IPA.

Më 8 mars 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, me ç’ rast është bërë publikimi i Amendamentimit të Kornizës Ligjore për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe prezantimin e draftit final të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore.

Më 11 mars 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në takimin me drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale i Komunës së Prishtinës.

Gjatë muajit prill 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u është drejtuar me shkresa zyrtare të gjitha gjykatave themelore në Kosovë, Policisë së Kosovës, drejtorëve të strehimoreve në Kosovë, mbrojtësve të viktimave në Kosovë, Ministrisë së Shëndetësisë, të cilëve u ka kërkuar informata për rastet e dhunës në familje gjatë kohës së pandemisë dhe për masat e ndërmarra nga ana e tyre, sipas kompetencave. Pas pranimit të përgjigjeve, në bazë të atyre informatave, Avokati i Popullit, më 30 prill 2020, ka publikuar në media Deklaratë lidhur me dhunën në familje gjatë pandemisë COVID-19.

Më 3 gusht 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në diskutimin publik, online përmes platformës ZOOM, me temën: *“Mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë”*, i organizuar nga OJQ *“Voice of Roma, Ashkali and Egyptians”*.

Më 8 dhe më 9 korrik 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në konferencën online, e organizuar nga Këshilli i Evropës, lidhur me shënimin e 70-vjetorit të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut.

Më 16 korrik 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në Konferencën mbi Projekt-Propozimin për Ndryshimet në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, organizuar nga OJQ Aktiv - Mitrovica e Veriut.

Më 6 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në takimin e Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT, organizuar nga Zyra e Qeverisjes së Mirë në Zyrën e Kryeministrit.

Më 16 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në takimin *“Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe Bashkëpunimi ndërmjet IAP dhe ASK lidhur me Agjendën 2030”*

12 tetor 2020, këshilltarja e lartë juridike ka marrë pjesë në takimin me përfaqësuesin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Më 16-17 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në Forumin e Shtatë Rajonal për Sundimin e Ligjit në Evropën Juglindore, organizuar nga Forumin për Sundimin e Ligjit në Evropën Juglindore.

Më 15 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në shënimin të Ditës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë, e organizuar nga Komuna e Prishtinës.

Më 15 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët me temën: “Parandalimi i drogave tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian”, e organizuar nga OJQ Labirinth.

Më 20 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit është përgjigjur në pyetësonin e Fondacionin Jahjaga në lidhje me rastet e ngacmimeve seksuale në vendin e punës.

Më 28 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në takimin me presidentin e Unionit Shëndetësor të Kosovës.

Më 30 nëntor, më 1 dhe 2 dhjetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë përmes platformës ZOOM në trajnimin “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, organizuar në kuadër të Projektit IPA dhe IAP-së.

Më 25 nëntor 2020, me qëllim të shënimit të “16 Ditët e Aktivizimit” kundër dhunës në familje dhe shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, Avokati i Popullit ka publikuar Deklaratën lidhur me Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave.

Më 26-27 nëntor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë përmes platformës ZOOM në Konferencën Rajonale “Akcesi në Drejtësi për Gratë Viktima dhe të Mbijetuarat të Dhunës në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi në Kohën e COVID-19”, organizuar nga UN WOMEN.

Më 2 dhjetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në publikimin virtual të projektit: “*Më shumë zgjedhje: Politikat e përgjegjshme gjinore për familjen për sektorin privat në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi*”, e organizuar nga Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara – UNFPA, përmes fondeve të Agjencisë Austriake për Zhvillim – ADA. Fokusi në këtë konferencë ka qenë lidhur me çështjet që lidhen me barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, si dhe promovimi i politikave miqësore për familjen, të cilat do të mundë t’i mbështesnin gratë për t’i realizuar aspiratat e tyre për karrierë, për familje dhe për fertilitet.

Më 3 dhjetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në diskutimin online i organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

në bashkëpunim me forumin ZFD - programi në Kosovë, në kuadër të “16 Ditët të Aktivizimit”, me ç’ rast është organizuar diskutimi: “*Përtej dhimbjes, drejt guximit: Dokumentimi i përvojave të dhunës seksuale nga lufta e fundit në Kosovë*”.

Më 9 dhjetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në Konferencën të Nivelit të Lartë për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Konventa e Stambollit, me titull: “*Zbatimi i Konventës së Stambollit: çfarë do të thotë në praktikë?*”, e organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Takimet me përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës lidhur me hetimin e rasteve të parashtruara në IAP.

Monitorimi i gjykimeve në Gjykatën Themelore në Prishtinë lidhur me ankesat e parashtruara në IAP (4 monitorime).

Më 3 dhjetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit është takuar me përfaqësuesin në Drejtorinë për Gjendje Civile si dhe me përfaqësuesin e Drejtorisë për Pronë dhe Kadastër në Graçanicë, përkitazi për rastet në hetim.

Të drejtat e komuniteteve

Nisur nga standardet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e pakicave, duhet theksuar faktin se të drejtat e pakicave nuk përfaqësojnë në vetvete ndonjë tipar të veçantë dhe privilegj, por diçka që është me shumë rëndësi është afirmimi, integrimi social dhe drejtësia. Në vendet ku shumëllojshmëria etnike shpesh çon në mosmarrëveshje, politizimi i problemeve, si dhe ndarja në shoqëri, respektimi i të drejtave të pakicave mundet ekskluzivisht dhe vetëm të kontribuojë në stabilitetin politik, shoqëror dhe në paqen. Kosova ka ligje të avancuara që synojnë avancimin dhe afirmimin e komuniteteve pakicë, megjithatë nevojitet vullnet më i madh politik në mënyrë që këto ligje të zbatohen dhe ta arrijnë qëllimin.

Avokati i Popullit, edhe gjatë këtij viti për të cilin po raportohet, me vëmendje ka ndjekur respektimin e të drejtave të komuniteteve.

Për periudhën për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit ka pranuar 149 ankesa nga anëtarët e të gjitha komuniteteve, prej të cilave 93 ishin ankesa individuale. Në këtë vit vërehet një rënie e lehtë e numrit të ankesave nga komunitetet, por që mund të lidhet me kufizimet e bëra në kuadër të luftimit të pandemisë të shkaktuar nga virusit COVID-19, kjo për faktin se edhe numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar në institucion shënon rënie.¹⁵⁰

¹⁵⁰ Numri i ankesave të pranuar, të cilat i kanë bërë pjesëtarët e komuniteteve pakicë: 47-serbët, 17-boshnjakët, 10-turqit, 5-ashkalinjtë, 3-egjiptianët, 13-romët, 3-goranët dhe 5-të tjerët, gjë që përbën 13% të numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar gjatë vitit 2020. Numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar në IAP gjatë vitit 2020 është 720, kurse janë hapur 43 raste ex-officio.

Përpjekjet e institucioneve për luftimin e pandemisë, mbase edhe urgjenca e veprimeve është përcjellë edhe me lëshime sa i përket ofrimit të informacionit në gjuhën serbe gjatë situatës emergjente, e cila ishte në fuqi nga mesi i marsit deri në qershor të vitit 2020. Një situatë e tillë, qytetarët të cilët nuk e flasin gjuhën shqipe i ka vënë në pozitë të pabarabartë për marrjen e informacioneve të sakta dhe relevante, dhe as informacionet që kanë të bëjnë me shëndetin publik.

Duke e pasur parasysh situatën në Kosovë gjatë pandemisë së virusit COVID-19, ka pasur progres në disa fusha lidhur me disa çështje kur bëhet fjalë për disa të drejta të pakicave, gjë që është për t'u lavdëruar, por ka pasur edhe ngecje ose aspak lëvizje kur bëhet fjalë për disa çështje të caktuara, të cilat drejtpërdrejt i kanë prekur pjesëtarët e komuniteteve pakicë, veçanërisht grupet e ndjeshme brenda këtyre komuniteteve, siç janë: pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe të kthyerit në Kosovë.

Shikuar në përgjithësi, komunitetet më të rrezikuara dhe të marginalizuara ende janë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Problemet më të shpeshta, me të cilat përballen pjesëtarët e këtyre komuniteteve, janë: gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale, pjesëmarrja e pakënaqshme në arsim, papunësia, prona e paluajtshme, të drejtat e pronësisë etj. Duke u përballur në mënyrë të vazhdueshme me këto probleme, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian u prekën veçanërisht gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë së virusit COVID-19. Duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve punojnë në punë jozyrtare, pas hyrjes në fuqi të gjendjes emergjente për shëndetin publik, ata u përballën me një situatë të vështirë ekonomike, e cila kontribuoi në rritjen e varfërisë. Si përgjigje ndaj kësaj situate, një numër i OJQ-ve kanë ndërmarrë disa iniciativa për t'u ndihmuar këtyre komuniteteve. Objektivat e këtyre iniciativave ishin që t'u ofrohej mbështetje komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sigurimin e pakove ushqimore dhe higjienike, përfshirë edhe paketat mbështetëse për zhvillimin e mësimin, mundësimin e mësimin elektronik për fëmijët - mësimi në distancë; mbështetje për mediat në gjuhën e këtyre komuniteteve dhe informimi i pjesëtarëve të komuniteteve dhe mbështetja e punës së OJQ-ve, të cilat merren me çështjen e këtyre komuniteteve të marginalizuara. Po ashtu, një numër komunash e filluan iniciativën e tyre për mbledhjen e pajisjeve të teknologjisë informative, të cilat ua shpërndanë fëmijëve të këtyre komuniteteve, në mënyrë që të njëjtët të mundë të marrin pjesë në mësimin në distancë.¹⁵¹

Qeveria e Republikës së Kosovës ofroi ndihmë dhe mbështetje për qytetarët dhe komunitetet, duke e miratuar një paketë të ndihmës në vlerë prej 130 eurosh për tre muaj për familjet që nuk kanë të ardhura nga shteti. Edhe pse kjo ndihmë nuk ishte e mjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet esenciale të jetës, ajo padyshim që pati një ndikim pozitiv në tejkalimin e vështirësive ekonomike në këtë periudhë kohore.

¹⁵¹ Informacionet e marra nga drejtori ekzekutiv i OJQ-së "VoRAE".

Kthimi dhe siguria

Edhe gjatë vitit 2020 nuk është arritur të zgjidhej çështja e strehimit të rreth 346 personave të cilët jetojnë në qendra kolektive në mjediset e banuara kryesisht me pjesëtarë të komunitetit serb. Edhe pse është shënuar progres në këtë drejtim, projekti për strehim banesor ende nuk ka përfunduar plotësisht.¹⁵² Edhe më tej shihet si e nevojshme që të punohet në ndërtimin e besimit të ndërsjellë midis komuniteteve, në mënyrë që rezultatet në të ardhmen të jenë më të mira.

Pavarësisht situatës me pandeminë COVID-19, është inkurajues fakti se në Kosovë janë kthyer 361 persona, që krahasuar me vitin e kaluar 2019, me ç' rast u regjistruan si të kthyer vetëm 190 persona,¹⁵³ tani numri i të kthyerve është pothuajse dy herë më i madh.

Një nga problemet më të mëdha për personat e zhvendosur dhe për personat e kthyer mbetet prona e uzurpuar dhe shfrytëzimi i lirë i pasurive të paluajtshme si dhe incidentet në vendet në të cilat janë kthyer kryesisht pjesëtarët e komunitetit serb, gjë që vazhdon edhe në periudhën e ardhshme të mbetet një sfidë për një klimë të favorshme lidhur me kthimin e qëndrueshëm.

Në fakt, edhe pse situata e sigurisë është mjaft e qëndrueshme, disa incidente që po përsëriten vazhdojnë të ndikojnë në perceptimin e sigurisë së pjesëtarëve kryesisht të komuniteteve serb dhe rom, qoftë të atyre që jetojnë në Kosovë, qoftë të atyre që janë të zhvendosur, kështu që ky perceptim ndikon në klimën e favorshme në procesin e kthimit të këtyre personave.

Gjatë vitit 2020 janë shënuar 62 incidente¹⁵⁴ në vendet e kthimit, ndërsa Policia e Kosovës hapi vetëm 11 raste në lidhje me incidentet me motiv të mundshëm ndëretnik.¹⁵⁵ Lidhur me këto incidente, është e nevojshme të shikohet fakti se është e nevojshme që Policia e Kosovës të fillojë të punojë në rritjen e kapaciteteve të tyre në kuptim të rritjes së numrit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në radhët e veta, veçanërisht në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb në komunën e Klinës dhe në atë të Istogut, në të cilat ka ndodhur numri më i madh i incidenteve gjatë vitit 2020. Në komunat në fjalë, sipas të dhënave zyrtare të Policisë së Kosovës, janë vetëm 8 policë të cilët u përkasin komuniteteve pakicë (në Klinë vetëm 1

¹⁵² Sipas statistikave të UNHCR-së, deri në fund të nëntorit 2020, gjithsej 408 njerëz jetojnë në qendrat kolektive në Kosovë: 21 në veri të Mitrovicës, 71 në Leposaviq, 20 në Zubin Potok, 27 në Zveçan, 247 në Shtërpcë dhe 22 në Graçanicë. Duhet të theksohet këtu se në fillim të vitit 2021, 87 familje u zhvendosën në ndërtesat e reja të ndërtuara në Shtërpcë, të cilat janë të destinuara për 87 familje që janë shfrytëzues të qendrës kolektive në Shtërpcë, ndërsa 15 familje të tjera (62 persona) kanë mbetur të jetojnë në qendrat kolektive në këtë vend dhe pritet që edhe atyre gjithashtu t'u sigurohet strehim gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, sipas pohimeve të MKK-së.

¹⁵³ UNHCR - Statistical Overview, Novembar 2020, Sipas statistikave të UNHCR-së, nga janari deri në fund të nëntorit të vitit 2020, janë kthyer 234 serbë, 63 ashkali dhe egjiptianë, 3 boshnjakë dhe 61 romë.

¹⁵⁴ Sipas të dhënave zyrtare të MKK-së, gjatë vitit 2020 janë evidentuar 15 raste të vjedhjes, 18 sulme fizike ndaj personave, 4 vënie të zjarreve, 7 raste të shkatërrimit të objekteve fetare, 13 raste të shkatërrimit të patundshmërive dhe 1 rast i shkatërrimit të objektit publik.

¹⁵⁵ Informatat e marra nga Policia e Kosovës, më 16.12.2020.

pjesëtar i komunitetit ashkali, ndërsa në Istog në Polici janë të punësuar 5 boshnjakë, 1 serb dhe 1 ashkali).¹⁵⁶

Përveç asaj që u tha më sipër, në kthim ndikon edhe situata e pafavorshme ekonomike në vend, pra pamundësia e punësimit dhe pamundësia e një sigurie të qëndrueshme ekonomike, e cila pasqyrohet me faktin se kthimi më i shpeshtë ndodh vetëm nga popullsia e moshuar dhe shumë rrallë nga popullsia më e re.

Në bazë të informatave të cilat i ka marrë IAP-ja nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), në fund të vitit 2020 po punohej në përfundimin e punëve për strehimin banesor të 162 personave nga gjithsej 408 persona, të cilët jetojnë në kushte të papërshtatshme tash e njëzet vjet, në pesë qendra kolektive në Shtërpcë. Në Shtërpcë, MKK-ja ka ndërtuar pesë ndërtesa banimi me 110 apartamente për këta persona dhe plani është që në vitin 2021 të mbyllet të gjitha qendrat kolektive në Kosovë dhe për shfrytëzuesit e të gjitha qendrave kolektive përfundimisht të bëhet zgjidhja për strehim të përhershëm.¹⁵⁷ Në fillim të janarit të vitit 2021, 87 familje u vendosën në shtëpitë e tyre të reja në Shtërpcë, ndërsa 15 familje janë ende duke pritur për strehim banimi. Avokati i Popullit i mirëpret veprimet e ndërmarra dhe planet e ardhshme për këtë çështje, por gjithashtu bën thirrje për reagim dhe veprim më të shpejtë, sepse është e papranueshme që pas 20 vjetësh të ketë akoma qendra kolektive ku personat e zhvendosur vazhdojnë të jetojnë në kushte çnjerëzore dhe të vështira. Duke raportuar për kthimin dhe dorëzimin e kërkesave për kthimin e personave të zhvendosur, në raportin të cilin MKK-ja ia ka dërguar IAP-së,¹⁵⁸ thuhet se një nga problemet më të mëdha në këtë drejtim ishte shkaktuar nga pandemia COVID-19, sepse situata është reflektuar në të gjitha aspektet e kthimit dhe e gjitha kjo për shkak të ndalimit të lëvizjes, mbylljes së vendkalimeve kufitare, kështu që të kthyerit nuk kanë pasur mundësi ta vizitojnë pronën e tyre, të paraqesin kërkesa dhe të marrin në komuna dokumentacionin e nevojshëm për paraqitjen e kërkesave për ndihmë në kthim, si dhe për të marrë dokumente personale. Kapaciteti i reduktuar institucional gjithashtu ka pasur një ndikim qoftë në nivelin lokal, qoftë në atë qendror, si dhe qasja e kufizuar në shërbimet komunale, të cilat merren me çështje administrative për lëshimin e dokumentacionit, që u nevojitet të kthyerve.

Në vitin 2020, MKK-ja ka pranuar gjithsej 186 kërkesa, prej të cilave janë aprovuar gjithsej 108 kërkesa për ndihmë në kthim dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme. Nga 186 kërkesa të paraqitura, 48 kërkesa u refuzuan, sepse nuk i plotësonin kriteret e përcaktuara në bazë të Rregullores për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme.¹⁵⁹ Ndërsa 30 familje janë lënë në pritje, për shkak të marrjes së dokumentacionit të nevojshëm, ose derisa ta zgjidhin çështjen e pronësisë në pronë (pronën e uzurpuar, konfirmimin e të

¹⁵⁶ Të dhënat janë marrë nga Policia e Kosovës, më 23.12.2020.

¹⁵⁷ Informatat në formë të raporteve janë marrë nga MKK-ja, më 18.12.2020.

¹⁵⁸ Po aty.

¹⁵⁹ Rregullore (QRK) - nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, e cila e rregullon në aspektin juridik çështjen e kthimit të personave të zhvendosur dhe shtëpive të tyre në Kosovë.

drejtave të pronës që janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore, procedura të papërfunduara të trashëgimisë etj.). Gjithashtu, gjatë vitit 2020, MKK-ja ka vazhduar t'i paguante shpenzimet e qirasë së apartamenteve për 51 familje, të cilat janë kthyer nga Mali i Zi dhe Maqedonia Veriore në Republikën e Kosovës.¹⁶⁰

Lidhur me Nismën Ndërinstitucionale për Personat e Zhvendosur nga Kosova, e njohur më mirë si “Nisma e Shkupit”,¹⁶¹ Avokati i Popullit e përshëndet vazhdimin e kësaj iniciative dhe rezultatin e mirë që po arrihet me të në kuptimin e kujdesit dhe gjetjes së zgjidhjeve për personat e zhvendosur, të cilët ende nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre në Republikën e Kosovës. Megjithatë nisma në fjalë kishte vështirësi në punën e saj për shkak të pandemisë COVID-19, megjithatë është gjetur një mënyrë për të organizuar takime dhe për ta koordinuar punën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme përmes platformave online, gjë që kësaj here mirëpritet si një shembull pozitiv dhe një lëvizje përpara në periudhën e punës së kufizuar me resurse të kufizuara në terren dhe organizimin e punës që kërkon praninë e një numri më të madh të njerëzve dhe punën me qytetarët. Avokati i Popullit gjithashtu e mirëpret përfundimin e draftit të parë të studimit të fizibilitetit, i cili e vlerëson mundësinë e krijimit të një mekanizmi për t'i dhënë përparësi procesit gjyqësor të çështjeve pronësore të personave të zhvendosur, përmes një njësie të veçantë të gjykatës.

Të drejtat pronësore

E drejta e pronës, si e drejtë themelore e njeriut, është e garantuar me Kushtetutë, me ligje si dhe me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, që janë ligjërish të detyrueshme dhe zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe të cilat i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes së të drejtave të pronës, si një e drejtë themelore e njeriut.¹⁶²

Zgjidhja e kërkesave pronësore paraqet hapin kryesor në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve pakicë, ndërsa respektimi efektiv dhe i qëndrueshëm i kësaj të drejte themelore të njeriut mund të ketë efekt pozitiv në krijimin e një rruge drejt sigurisë ligjore të atyre qytetarëve që ende nuk mund t'i ushtrojnë të drejtat e tyre pronësore.¹⁶³

¹⁶⁰ Informatat në formë të raporteve janë marrë nga MKK-ja, më 18.12.2020.

¹⁶¹ “Iniciativa e Shkupit” operon në 5 grupe punuese për implementim, për: 1. çështjet e pronës; 2. për sigurinë, dialogun dhe riintegrimin; 3. për dokumente personale; 4. për menaxhimin e të dhënave dhe 5. për planifikimin dhe zgjidhjet e qëndrueshme. Kjo iniciativë përbëhet nga Republika e Kosovës, Republika e Serbisë, Maqedonia Veriore, Mali i Zi, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR-ja dhe përfaqëson një platformë kryesore rajonale, e cila mundëson dialog të vazhdueshëm dhe koordinim rajonal.

¹⁶² Me nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), në dokumentin e parë që i përcakton të drejtat themelore të njeriut që mbrohen botërisht, thuhet: “Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkëpronësi me të tjerët.” dhe “Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.” E drejta e pronës njihet gjithashtu nga Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (ICPRD) dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Të drejtat e pronës janë të regjistruara në Protokollin e Parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj).

¹⁶³ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Raporti “Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave në masë për të drejtat pronësore: Përvoja e Kosovës”, qershor 2020 <https://www.osce.org/sr/mission-in-kosovo/454185> (në gjuhën

Avokati i Popullit vazhdimisht ka raportuar për çështjen e uzurpimit të pronës, për mangësitë e mekanizmave që t'i zbatojnë vendimet e marra, për zvarritjet e procedurave në organet gjyqësore dhe, si rrjedhojë, titullarët e të drejtave pronësore me vështirësi arrijnë ta kthejnë në dispozicion pronën e vet, siç e ka paraparë këtë korniza ligjore, duke krijuar pasiguri juridike tek qytetarët.

Në vitet e fundit ka pasur progres lidhur me këtë çështje, por ende ekziston një numër problemesh thelbësore në kthimin e pronave tek pronarët, për të cilën gjë duhet të insistohet të punohet me kujdesin e duhur dhe është e domosdoshme që kësaj çështjeje t'i jepet prioritet për zgjidhje. Këtu, si shembull pozitiv duhet t'i referohemi faktit se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i Republikës së Kosovës, në çështjen në lidhje me kthimin e pasurive të patundshme dhe rrënimin e ndërtesave të ngritura në mënyrë të paligjshme pas gjashtë vjetësh, më në fund u zbatua. Shkatërrimi i strukturave të ngritura në mënyrë të paligjshme u zbatua nga AKP-ja në tetor 2020. Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit, nëpërmjet një raporti me rekomandime, kishte tërhequr vërejtjen lidhure me vonesat dhe pasojat për palën nga mosekzekutimi i Vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, datë 16 prill 2014.¹⁶⁴

Kur bëhet fjalë për të drejtat pronësore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, nuk është bërë asnjë përpunim në regjistrimin e disa vendbanimeve joformale, përkatësisht një numri të madh të pasurive të patundshme, në të cilat jetojnë pjesëtarë të këtyre komuniteteve, të gjitha për shkak të marrëdhënieve të paqarta të pronësisë dhe të dokumentacionit të vlefshëm ligjor, gjë që e paraqet një problem të madh dhe një sfidë të madhe në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Për arsyt e mësipërme, disa komuna nuk arritën të realizonin projekte të caktuara banesore, ngase procedurat kërkonin një situatë të qartë të pronës me parcela, për të cilat disa qytetarë paraqitën kërkesa. Si një zgjidhje alternative, janë punuar rindërtimet e objekteve ekzistuese aty ku ishte e mundur.¹⁶⁵

Arsimi

Megjithëse arsimi duhet të jetë një shtyllë e kornizës ligjore për promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë, Avokati i Popullit konstaton se situata me arsimin në dy drejtime paralele vazhdon. Njëri prej tyre menaxhohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më saktësisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASh), që ofron arsim në shqip, turqisht dhe boshnjakisht. Tjetri menaxhohet nga Republika e Serbisë, gjegjësisht nga Ministria e saj e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik dhe ofron arsimim në gjuhën serbe. Shkollat që ofrojnë arsim në gjuhën serbe gjenden në gjashtë rrethe në Kosovë: Ferizaj, Gjilan,

serbe) dhe Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave në masë për të drejtat pronësore: Përvoja e Kosovës <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/454182> (në gjuhën shqipe).

¹⁶⁴ Ankesa nr.435/2013 N.J.kundër Agjencisë Kosovare të Pronës, Avokati i Popullit, më 6 maj 2015, ia dërgoi AKP-së një Raport me rekomandime nr. 435/2013, në të cilin i rekomandoi që t'i merrte masat e nevojshme dhe të domosdoshme me qëllim të përbarimit të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, datë 16.4. 2014, me qëllim që pa vonesa të mëtutjeshme ta mbrojë të drejtën e ankueses për pronë.

¹⁶⁵ Informacionet lidhur me këtë çështje, IAP-ja ia dha Komunës së Graçanicës në muajin janar të vitit 2021.

Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren, kurse mësimi zhvillohet në 69 shkolla fillore dhe 34 shkolla të mesme. Lidhur me këto probleme të sistemit arsimor në Kosovë, Avokati i Popullit ka raportuar në periudhat e mëparshme raportuese dhe që nga ajo kohë situata është përmirësuar fare pak. Përmirësimi ka të bëjë me njohjen jo vetëm të diplomave universitare nga Universiteti i Mitrovicës Veriore, i cili operon në përputhje me sistemin arsimor të Republikës së Serbisë, por është vërejtur përparim në lidhje me njohjen e diplomave të shkollave të mesme dhe fillore që ofrojnë arsim në gjuhën serbe, sepse zgjidhja e kësaj çështjeje ka një dimension më të gjerë, nga thjesht arsimi dhe për këtë arsye ekziston nevoja për progres të mëtejshëm në një drejtim pozitiv në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Në bazë të informacioneve, të cilat IAP-ja i ka marrë nga MASH-i,¹⁶⁶ qeveria ka zhvilluar një analizë paraprake në lidhje me këtë çështje dhe në mes të vitit 2019, me Vendimin nr. 08/102, e ka hartuar dhe miratuar Koncept-dokumentin *“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”*.

Qëllimi i këtij dokumenti është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës Veriore, me qëllim që të aplikojnë për një vend pune, të marrin licenca profesionale dhe të japin provime profesionale në institucionet publike. Me këto ndryshime dhe plotësime në Rregulloren nr. 21/2015 do të përcaktohen procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave jo vetëm për shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, por edhe për të gjithë shtetasit, të cilët kanë diplomuar në institucione të tjera arsimore parauniversitare dhe universitare, ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe. Prandaj, Avokati i Popullit shpreson që gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, qeveria do ta miratojë draftin e rregullores, në mënyrë që kjo çështje të rregullohet.

Përveç shembujve pozitivë, duhet të theksohet se ende nuk janë zgjidhur problemet që e prekin komunitetin turk dhe boshnjak ndër vite, e që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë dhe përkthimit të librave shkollorë dhe doracakëve ndihmës për shkollat fillore dhe të mesme në gjuhët e këtyre komuniteteve pakicë.¹⁶⁷ Kur flitet për sistemin arsimor, të cilin e ndjekin pjesëtarët e komunitetit goran, duhet thënë se ende ekziston një problem i madh i infrastrukturës së dobët në shkolla, mungesa e hapësirës për të gjithë nxënësit të cilët e ndjekin mësimin, posaçërisht tualetet jofunksionale janë një problem i madh në fshatrat në komunën e Dragashit, ku e ndjekin mësimin nxënësit e komunitetit goran. Pjesëtarët e komunitetit goran janë të ndarë në aspektin e çështjes së arsimit dhe një pjesë e pjesëtarëve të këtij komuniteti i

¹⁶⁶ Përgjigje në lidhje me rekomandimin dërguar nga IAP-ja për MASHT-in në lidhje me temën që lidhet drejtpërdrejt me njohjen e diplomave të shkollës së mesme në gjuhën serbe në Kosovë për lëndën A.nr.210/2019 Ž.B, përgjigja është marrë më 9.12.2020.

¹⁶⁷ Informacione të marra nga përfaqësuesja e komunitetit boshnjak në Këshillin Konsultativ për Komunitete, më 20.12.2020.

ndjekin mësimet në gjuhën serbe, sipas sistemit arsimor të Republikës së Serbisë, ndërsa të tjerët i ndjekin mësimet sipas sistemit të Republikës së Kosovës, në bazë të planit dhe programit mësimor për gjuhën boshnjake. Përveç atyre që u theksuan më sipër, ka vështirësi edhe në transportin e nxënësve deri në shkolla, i cili nuk është i rregullt, shpesh ndodh që prindërit të organizojnë transportin për fëmijët, gjë që paraqet një problem të madh në periudhën e dimrit, për shkak të rrugëve të këqija që i lidhin fshatrat, si dhe për shkak të pakalueshmërisë së tyre gjatë reshjeve të borës.

Masat afirmative që kanë të bëjnë me arsimin universitar janë të rregulluara me Ligjin për Arsimin e Lartë¹⁶⁸ si dhe me Udhëzimin Administrativ nr. 09/2016 mbi zbatimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrimin e studentëve nga komunitetet joshumicë në universitetet publike të arsimit të lartë.¹⁶⁹ Megjithëse masat afirmative për pakicat janë të parapara edhe me Ligjin për Arsimin e Lartë edhe me Udhëzimin Administrativ të lartpërmendur, masat pozitive për komunitetet pakicë nuk janë të parapara në Udhëzimin Administrativ për Arsimin Specialistik¹⁷⁰, i cili zbatohet bashkë me Ligjin për Shëndetësinë.¹⁷¹ Udhëzimi Administrativ i përmendur parasheh vetëm vende të rezervuara për caktimin e specializimeve për arsimim specialistik në kuadër të profesioneve shëndetësore për të diplomuarit e mjekësisë nga Lugina e Preshevës, ndërsa vendet e tilla nuk janë paraparë për pjesëtarët e komuniteteve pakicë.

Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se masat afirmative që kanë të bëjnë me pjesëtarët e komuniteteve pakicë janë të domosdoshme në të gjitha nivelet e arsimit, në të cilët për nga rëndësia bëjnë pjesë edhe studimet e specializuara në kuadër të profesioneve mjekësore, në mënyrë që të plotësohen nevojat për përfaqësim të shtuar të komuniteteve joshumicë në të gjitha sferat e shoqërisë, me integrimin e tyre dhe përfshirjen më të madhe në sistem.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë ankesë në lidhje me braktisjen e shkollës nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Sidoqoftë, IAP-ja është e vetëdijshme për faktin se një përqindje e madhe e nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk e ndoqën mësimin në distancë, për shkak të mungesës së mjeteve të teknologjisë informative. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron që MASH-i duhet të kishte siguruar mjete të përshtatshme teknologjike, të paktën për një numër të nxënësve me status të dobët socio-ekonomik, në mënyrë që ata të mundë ta ndiqnin pa problem mësimin në distancë. Për më tepër, duhet përsëritur përkrahjen që ka ofruar shteti për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në kuadër të iniciativës së MASH-it për dhënie e bursave për nxënësit e shkollave të mesme, me ç’ rast u dhanë

¹⁶⁸ Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, i datës 9.9.2011.

¹⁶⁹ Udhëzimi Administrativ nr. 09/2016 mbi zbatimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrimin e studentëve nga komunitetet joshumicë në universitetet publike të arsimit të lartë.

¹⁷⁰ Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 për Shkollim Specialistik.

¹⁷¹ Ligji nr.04/L-125 për Shëndetësi.

gjithsej 600 bursa në vitin shkollor 2020/21.¹⁷² Me këtë rast duhet të rishikohet dhe analizohet hulumtimi i bërë nga UNICEF-i në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës në lidhje me arsimin e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë. Hulumtimi tregoi se kur bëhet fjalë për arsimin, situata nuk ka ndryshuar aspak në 6 vjetët e fundit, kur u bë studimi i fundit i këtij lloji.¹⁷³ Pjesëmarrja dhe vijimi i mësimin në shkollën fillore është mjaft i mirë dhe i lartë, por informacioni negativ është se vetëm 31% e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë e përfundojnë shkollën e mesme, përkatësisht e ndjekin deri në fund mësimin në klasat e larta të shkollës së mesme dhe se situata në 6 vjetët e fundit është pa ndryshime pozitive, pavarësisht masave afirmative, të cilat promovohen dhe zbatohen nga viti në vit.

Përdorimi i gjuhës

Përveç mandatit të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligje, Avokati i Popullit ka monitoruar edhe zbatimin dhe respektimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve¹⁷⁴, nga aspekti i të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit dëshiron ta theksojë bashkëpunimin jashtëzakonisht të mirë me Komisionarin për zgjidhjen e ankesave të caktuara të dërguara nga qytetarët në të dy adresat, me qëllim që t'i mbrojnë të drejtat e veta për përdorimin e gjuhës në raport me organet shtetërore, qoftë në nivelin qendror, qoftë në atë komunal. Posaçërisht duhet theksuar qëndrueshmërinë dhe praktikën e mirë të institucionit të Avokatit të Popullit në përdorimin e barabartë të të dyja gjuhëve zyrtare, për të cilën gjë, më 10 dhjetor 2020 iu nda mirënjohje nga Komisionari për Gjuhët në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë për “Praktikën më të mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve”.

Kur bëhet fjalë për zbatimin e kornizës ligjore për përdorimin e barabartë të të dyja gjuhëve zyrtare, për fat të keq ka ende probleme në zbatimin e dygjuhësisë, e garantuar me Kushtetutë, por edhe me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.¹⁷⁵ Përparimi në këtë drejtim po bëhet ngadalë, qoftë në nivelin qendror, qoftë në atë komunal. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, i miratuar 13 vjet më parë, zbatohet vetëm pjesërisht për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, i cili shpesh shoqërohet me një kuptim të pamjaftueshëm të detyrimeve, si dhe me mungesë të vullnetit politik. Ky fakt doli në pah gjatë një emergjence të shëndetit publik, për shkak të pandemisë COVID-19 në Kosovë, në fillim të vitit 2020. Konkretisht, gjatë situatës emergjente në shëndetin publik, Avokati i Popullit e pranoi një ankesë¹⁷⁶ kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe kundër Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, me arsyetimin se të gjitha informatat relevante në lidhje me pandeminë COVID-19 dhe me situatën

¹⁷² Informacionet e marra nga drejtori ekzekutiv i OJQ-së “VoRAE” z. Isak Skenderi, më 26.1.2021.

¹⁷³ 2019-2020 Kosovo MICS and Roma, Ashkali and Egyptian Communities MICS SFR ALB v2 (mics-surveys-prod.s3.amazonaws.com) – arsimin parashkollor e ndjekin 45% të fëmijëve, 84% shkollën fillore, 64% klasat e ulëta të shkollave të mesme dhe vetëm 31% klasat e larta të shkollave të mesme. Informacione të njëjta IAP-së i ka dhënë edhe OJQ-ja “VoRAE” më 26.1.2021.

¹⁷⁴ Ligji nr. 02/L-037 për Përdorimin e Gjuhëve.

¹⁷⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 5 dhe 59, dhe Ligji nr. 02/L-037 për Përdorimin e Gjuhëve.

¹⁷⁶ Ankesa nr. 250/2020 Z.V. kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, e paraqitur më 24.3.2020.

epidemiologjike në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe lidhur me masat e përcaktuara, u publikuan vetëm në gjuhën shqipe, gjë që është në kundërshtim edhe me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, me Kushtetutën, por mbi të gjitha është në kundërshtim me informimin e barabartë të qytetarëve në të dyja gjuhët zyrtare.¹⁷⁷

Në lidhje me ankesën në fjalë, Avokati i Popullit konfirmoi pretendimet në ankesë dhe i rekomandoi¹⁷⁸ Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publik të Kosovës (IKShPK) që të veprojnë në përputhje me nenin 5.1 të Kushtetutës dhe me Ligjin nr. 02/L-037 për Përdorimin e Gjuhëve dhe që qytetarët dhe publiku, në kohën e duhur dhe pa vonesë, t'i informojnë përmes faqeve të tyre zyrtare në të dyja gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fjalë. Në përgjigjet që Avokati i Popullit i mori më 17 prill 2020, të dy palët përgjegjëse deklaruan se rekomandimet e dhëna do të zbatohen. Një pjesë e rekomandimeve u zbatua, siç janë: njoftimet për publikun që ua përcillen gazetarëve të mediave, të cilët raportojnë në gjuhën serbe, por gjithashtu është edhe platforma “Kosova.health”, e cila gjendet brenda faqes në internet të Ministrisë së Shëndetësisë (www.msh.rks-gov.net), e cila përmban informacione ekskluzivisht për COVID-19 në tri gjuhë: në gjuhën shqipe, në atë serbe dhe angleze. Mirëpo, që nga 31 dhjetori 2020, faqja e internetit e IKShPK-së edhe me tutje është vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa faqja e internetit e Ministrisë së Shëndetësisë nuk azhurnohet rregullisht.¹⁷⁹

Lidhur me çështje të ngjashme raportoi një përfaqësuese e komunitetit boshnjak në Këshillin Konsultativ të Komunitetit, duke deklaruar se gjatë pandemisë COVID-19, ky komunitet mori njoftime dhe udhëzime administrative vetëm në gjuhën shqipe në shkollat që punojnë në gjuhën boshnjake, kurse përkthimi në gjuhën boshnjake arriti me vonesë. Gjithashtu, Këshilli Konsultativ për Komunitete, nga ana e tij, tërhoqi vëmendjen dhe paraqiti vërejtje lidhur me njoftimet për ofrimin e ndihmave, por edhe informacionet se si mund të aplikonin qytetarët për ndihma, të cilat ishin në gjuhën shqipe, ndërsa linku të cilin qytetarët mund ta përdornin dhe ta plotësonin aplikacionin në gjuhën serbe ose boshnjake ose ishte jofunksional, ose i pakuptueshëm, përkatësisht njoftimet nuk ishin përkthyer me saktësi, siç ishte dhënë dhe publikuar në origjinal informacioni në gjuhën shqipe.¹⁸⁰

Kur të përmbliidhen të gjitha ato që u thanë më sipër, duhet të konstatohet se korniza ligjore është e mirë, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve është i gjerë në spektrin e të drejtave të dhëna, por problematik është aplikimi tij në praktikë. Zhvillime dhe shembuj pozitivë janë evidentë, por jo mjaftueshëm, prandaj është e nevojshme që në periudhën e ardhshme të punohet për ta

¹⁷⁷ Informacioni i marrë nga Komisionari për Gjuhët, më 28.12.2020.

¹⁷⁸ Ankesa nr. 250/2020 Z.V. Letër Rekomandimi Ministrisë së Shëndetësisë, dërguar më 15.4.2020.

¹⁷⁹<https://msh.rks-gov.net/sr/> qasja e realizuar më 4.1.2021.

<https://niph-rks.org/> qasja e realizuar më 4.1.2021.

¹⁸⁰ Informacione të pranuar nga përfaqësuesja e komunitetit boshnjak në Këshillin Konsultativ për Komunitete, më 20.12.2020.

bërë të dukshme barazinë efektive, në mënyrë që të përmbushet standardi i dhënë me kornizën ligjore.

Integrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe problemet me papunësinë

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali (2017-2021) kryesisht është një udhëzues për politikat publike, programet dhe veprimet në lidhje me mbrojtjen, arsimin, punësimin dhe politikat sociale, strehimin, shëndetësinë, gjininë, sigurinë dhe regjistrimin civil. Mirëpo, në bazë të informacioneve të cilat i ka në dispozicion IAP-ja, nuk është vërejtur progres në zbatimin e kësaj strategjie.

Një numër i madh i raporteve ndërkombëtare, përfshirë raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2020, theksojnë se situata e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian edhe më tutje mbetet problem serioz dhe përparimi në të drejtat e këtyre komuniteteve është i kufizuar. Me këtë rast duhet të theksohet se në fund të vitit 2020, BE-ja e miratoi një kornizë të re strategjike për periudhën 2020-2030¹⁸¹, e cila mund t'i shërbejë Qeverisë së Republikës së Kosovës si një pikë fillestare në hartimin e një strategjie të re, e cila do të ishte më efektive në zbatimin e saj sesa të gjitha ato të mëparshmet që nuk dhanë rezultate të kënaqshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.

Kur shikohet dokumenti në fjalë i BE-së, ndryshimi i parë që vërehet është se Korniza e re kalon nga qasja e “integrit” te “barazia, përfshirja dhe pjesëmarrja”. Theksohet se zgjidhja e problemit të romëve, dhe gjithashtu në kontekstin e Kosovës: edhe e ashkalinjve dhe e egjiptianëve, mund të punohet në mënyrë efektive vetëm nëse fenomeni i diskriminimit dhe anti-ciganizmit, i cili është faktor kyç strukturor i përjashtimit, luftohet së bashku me perspektivën socio-ekonomike. Kështu, në periudhën e ardhshme mbetet të shihet se si dhe në çfarë mënyre do ta harmonizojë Kosova politikën e saj të përfshirjes së komuniteteve të marginalizuara me strategjinë e re evropiane. Gjithashtu, në lidhje me këtë, OJQ “VoRAE” gjatë vitit 2020 e ngriti çështjen e ndryshimit të narratives në lidhje me situatën e këtyre komuniteteve, duke thënë se problemi kyç i këtyre komuniteteve është anti-ciganizmi, përkatësisht forma specifike e racizmit, për të cilën temë ka raportuar edhe shtypi kosovar si dhe një numër i madh portalesh në internet, ku një numër i figurave kryesore politike në pushtet po ashtu i ka shprehur mendimet e veta. Mbetet të shihet nëse diskursi në zgjidhjen e kësaj çështjeje do të përmirësohet dhe ndryshojë në periudhën e ardhme.¹⁸²

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në zbatimin e Deklaratës së Partnerëve Ballkanikë për Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të Bashkimit Evropian, ka vendosur të themelojë një Grup teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom,

¹⁸¹“EU Roma strategic framework for equality, inclusion and participation 2020-2030”, publikuar në fillim të tetorit të vitit 2020, shiko linkun në vijim: https://ec.europa.eu/info/publications/new-eu-roma-strategic-framework-equality-inclusion-and-participation-full-package_en

¹⁸² Informacionet e marra nga drejtori ekzekutiv i OJQ-së „VoRAE“ më 26.01.2021, po ashtu shih linkun <https://kosovapress.com/kerkohet-strategji-e-re-per-te-adresuar-antigjipizmin/>

ashkali dhe egjiptian.¹⁸³ Ky grup është përgjegjës për zbatimin e përgjegjësive që dalin nga Deklarata e Partneritetit të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, grupi në fjalë i ushtron përgjegjësitë si në vijim: bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, me qëllim të bërjes së ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për shkak të diskriminimit ndaj tyre dhe ua përcjell këto raste institucioneve kompetente; bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, me qëllim të sigurimit të mbështetjes ligjore për viktimat e pretenduara dhe i identifikon skemat e diskriminimit, përfshirë diskriminimin institucional dhe diskriminimin e fshehtë, në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë dhe realizon aktivitete të ndërgjegjësimit të publikut me qëllim të parandalimit të diskriminimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në bazë të këtij vendimi, IAP-ja e shfrytëzoi të drejtën e vet dhe e caktoi një zyrtar, i cili do të marrë pjesë në seancat dhe në punën e grupit në fjalë, në cilësinë e vëzhguesit.

Lidhur me papunësinë e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, situata edhe më tutje është alarmante, sepse shikuar në përgjithësi, shkalla e përgjithshme e papunësisë është e lartë. Duke folur në përgjithësi, problemi i përgjithshëm madhor në Republikën e Kosovës është shkalla e lartë e papunësisë për të gjithë popullsinë, megjithatë, komunitetet në fjalë e kanë veçanërisht të vështirë të përballen me këtë problem, i cili kërkon një qasje më sistematike. Siç është përmendur tashmë, pjesëtarët e këtyre komuniteteve kryesisht vetëpunësohen duke mbledhur gjësende dhe me punë sezonale, një numër i madh bën punë të rënda fizike për një kompensim të vogël monetar, kryesisht në të ashtuquajturën zonë gri, mbi të cilën shteti nuk ka mbikëqyrje përkatëse si dhe në kuadër të ndërmarrjeve komunale. Ata punësohen më rrallë në pozita menaxhuese, në shërbimin civil shtetëror, në arsimin zyrtar, në kujdesin shëndetësor, në sipërmarrjen private etj. Është fakt i mungesës së suksesit që në 56 institucionet shtetërore, ku janë të punësuar 30.635 punonjës, vetëm 113 punonjës janë nga radhët e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve.¹⁸⁴ Të ardhurat financiare dhe në përgjithësi situata materiale në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian u përkeqësuan edhe më shumë gjatë vitit 2020, gjatë pandemisë COVID-19, qoftë për shkak të humbjes së punësimit në sektorin joformal, qoftë për shkak të konkurrencës së lartë në tregun e punës në përgjithësi dhe papunësisë së gjithmbarshme në Kosovë, gjë që mund të vërehet edhe në bazë të rritjes së konsiderueshme të numrit të kërkesave për marrjen e ndihmës sociale për familjet në nevojë të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.¹⁸⁵

¹⁸³ Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 138/2020 i datës 11.09.2020.

¹⁸⁴ Informacioni i marrë nga drejtori ekzekutiv i OJQ-së "VoRAE", më 26.1.2021.

V. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT)

V. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës

Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Protokollit Fakultativ të kësaj Konvente, sepse ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe me instrumentet ndërkombëtare, garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Një ndër konventat e përfshira në këtë nen është edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, e cila u miratua më 10 dhjetor 1984 dhe hyri në fuqi më 26 qershor 1987.¹⁸⁶

Ndërsa më 18 dhjetor 2002, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në seancën e pesëdhjetë e shtatë (57), me Rezolutën A/RES/57/199, miratoi Protokollin Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Ky protokoll hyri në fuqi më 22 qershor 2006.¹⁸⁷ Qëllimi kryesor i protokollit në fjalë është krijimi i një sistemi të vizitave të rregullta, të cilat ndërmerren nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe nacionale, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, me qëllim të parandalimit të torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.¹⁸⁸

Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili hyri në fuqi më 26 qershor 2015, në nenin 17, paragrafi 1, përcakton se Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (në tekstin e mëtejme: MKPT).¹⁸⁹

Vizitat e rregullta dhe pa paralajmërim, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe në çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, janë detyra të MKPT-së të përcaktuara me ligj.¹⁹⁰

Ligji për Avokatin e Popullit përcakton se gjatë kryerjes së funksionit si MKPT, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, me pajtimin

¹⁸⁶ Zyra e Komisionarit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cat.aspx>.

¹⁸⁷ Zyra e Komisionarit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opcat.aspx>.

¹⁸⁸ Neni 1 i Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës.

¹⁸⁹ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.2.

¹⁹⁰ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.

e tyre, si dhe në të dhënat personale të këtyre personave.¹⁹¹ MKPT-ja u themelua zyrtarisht me vendimin e Avokatit të Popullit, më 16 janar 2016.

Metodologjia e vizitave e MKPT-së

Metodologjia e vizitave e MKPT-së konsiston në observim, në dokumentim dhe në intervistim të personave të privuar nga liria, të zyrtarëve korrektues dhe policorë, si dhe të atyre shëndetësorë. Neni 17 i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton se MKPT-ja kryen vizita, pa paralajmërim, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Kjo metodologji parasheh përgatitjen e vizitës, përcaktimin e llojit të vizitës, si dhe veprimet të cilat zbatohen me të arritur në institucionin i cili vizitohet.

Biseda përfundimtare me udhëheqësin e institucionit fokusohet në shqetësimet më të rëndësishme, siç mund të jenë: marrëdhëniet ndërmjet personelit dhe të burgosurve, incidentet ndërmjet të burgosurve, kushtet e akomodimit, kujdesi joadekuat shëndetësor, moszbatimi i garancive procedurale (qasja tek avokati, e drejta në shërbime mjekësore, kontaktet me familjen etj.).

Vizitat e realizuara

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19 në mbarë botën, edhe MKPT-ja reduktoi vizitat duke u fokusuar vetëm në çështje specifike (me ç' rast nuk janë realizuar vizita të përgjithshme në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit, por vetëm në stacione policore) dhe disa herë i ka pezulluar vizitat në vendet e privimit nga liria bazuar në parimin e mosshkaktimit të dëmit më të madh.

MKPT-ja ka kontaktuar vazhdimisht me të burgosurit përmes numrave të telefonit, përmes të cilëve ata kishin qasje gjatë tërë kohës, si dhe përmes familjarëve të tyre dhe burimeve të tjera. Po ashtu, MKPT-ja kishte komunikim të vazhdueshëm me autoritetet kompetente përmes postës elektronike zyrtare, përmes telefonit, si dhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta në raste të caktuara.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka realizuar 52 vizita *ad-hoc* në institucionet në vijim:

1. Qendra Korrektuese në Dubravë (QKD).
2. Burgu i Sigurisë së Lartë (BSL).
3. Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan
4. Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan.
5. Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan (QEKL).
6. Qendra e Paraburgimit në Gjilan (QPGj)

¹⁹¹ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 4.

7. Qendra e Paraburgimit në Lipjan (QPL).
8. Qendra e Paraburgimit në Prishtinë.
9. Stacionet policore në vijim: Qendra Rajonale e Mbjajtjes në Prishtinë; Stacioni Policor “Jug” në Prishtinë; Stacioni Policor “Veri”; Stacioni Policor në Fushë Kosovë; stacionet policore në Mitrovicë - Jug dhe Veri, Stacioni Policor në Suharekë; Stacioni Policor në Mamushë; Stacioni Policor në Prizren, ai në Gracanicë; në Drenas; në Skenderaj; Stacioni Policor në Obiliq; Stacioni Policor në Deçan; ai në Junik e në Pejë; në Gorazhdec; në Vitomiricë; në Ferizaj; në Viti; në Gjilan dhe në Kamenicë.
10. Qendrën Studentore në Prishtinë, e përdorur si karantinë gjatë një periudhe, për shkak të COVID-19.
11. Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP).
12. Instituti i Psikiatrisë Forenzike (IPFK).
13. Reparti i Urgjencave dhe i Kujdesit Intensiv Psikiatrik në kuadër të Klinikës Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (UKIP).
14. Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore (ShFAKM).
15. Institutin Special në Shtime (ISSh).
16. Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakocë dhe Skënderaj.
17. Shtëpinë me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime (ShBK).

Raport me rekomandime

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka publikuar raportin me rekomandime për vizitat në stacionet e lartpërmendura policore¹⁹². Raporti me rekomandime për vizitat në stacionet e ndryshme policore u është dërguar autoriteteve kompetente, me gjithsej 9 rekomandime.

Bashkëpunimi me institucionet e vizituara

Gjatë vizitave të MKPT-së në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria, në institucionet e shëndetit mendor dhe në ato të kujdesit social, zyrtarët e institucioneve të vizituara i kanë ofruar ekipit monitorues bashkëpunim të plotë dhe qasje të menjëhershme. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar, pa praninë e zyrtarëve korrektues, as të zyrtarëve

¹⁹² Shih në: <https://www.oik-rks.org/2020/09/16/raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-vizitat-ne-stacionet-policore/>

policorë, as të personelit mjekësorë dhe as të personelit të institucioneve psikiatrike dhe të kujdesit social.

Policia e Kosovës

Gjatë vizitave në vendet e privimit nga liria, MKPT-ja nuk mori ankesa nga personat e arrestuar dhe as prej atyre të cilët ishin në mbajtje në kohën e vizitës, për keqtrajtim fizik apo për mosrespektim të të drejtave themelore, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Në vitin 2020, IAP-ja ka regjistruar 6 raste për hetim të mëtejme kundër Policisë së Kosovës bazuar në pretendimet e qytetarëve se janë keqtrajtuar fizikisht,¹⁹³ 5 nga këto raste janë ende duke u hetuar, ndërsa në një rast iu rekomandua Inspektoratit Policor të Kosovës t'i kryente hetimet e mëtejme bazuar në mandatin që ka dhe të njoftonte IAP-në për epilogun e hetimeve.

Në përgjithësi, MKPT-ja, bazuar në vizitat e realizuara gjatë këtij viti dhe në vizitat e mëhershme, shqyrtimin e ankesave të pranuar, si dhe të hetimeve sipas detyrës zyrtare, vlerëson se nuk ka keqtrajtim fizik sistematik apo të përhapur nga Policia e Kosovës, por bëhet fjalë për raste të izoluar.

Garancitë procedurale kundër keqtrajtimit fizik

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (tani e tutje: KPT), në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia, të cilat janë: e drejta për ta njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën); e drejta për të pasur një avokat; e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).¹⁹⁴ Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përcaktohet çështja në kuadër të sistemit ligjor të një vendi.

KPT-ja më tej thekson se këto të drejta duhet të zbatohen jo vetëm në rastin e personave të ndaluar, por edhe në rastet e tjera kur qytetarët detyrohen të qëndrojnë në polici apo me policinë edhe për arsye të tjera (për shembull: për qëllime identifikimi). Të drejtat themelore të personave të arrestuar dhe në mbajtje nga autoritetet policore parashihen edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.¹⁹⁵

¹⁹³ Rasti A.nr. 670/2020 E.H. kundër Policisë së Kosovës, në hetim e sipër nga IAP-ja.

¹⁹⁴ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f/>

¹⁹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me personat e ndaluar dhe nga analizimi i dokumentacionit gjatë vizitave në stacione të ndryshme policore, nuk ka hasur në shkelje të këtyre të drejtave themelore nga autoritetet policore. Për më shumë, MKPT-ja vëren se Policia e Kosovës ka formularë standardë, përmes të cilëve të arrestuarit njoftohen për të drejtat e tyre dhe të cilët përmes nënshkrimit të tyre konfirmojnë se janë njoftuar për këto të drejta. MKPT-ja po ashtu ka vërejtur se Policia e Kosovës në përgjithësi mban evidencë dhe dokumentacion të bollshëm për çdo ngjarje lidhur me personat në ndalim policor. Këta formularë standardë janë të përpiluar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Video dhe audio incizimi i intervistave si garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik

KPT-ja konsideron se regjistrimi elektronik (audio dhe/ose video) i intervistave policore përbën një garanci të rëndësishme shtesë kundër keqtrajtimit të të arrestuarve dhe për mbrojtje të zyrtarëve policorë nga akuzat e rrejshme për keqtrajtim fizik.¹⁹⁶ Bazuar në njoftimin e mëhershëm nga Policia e Kosovës se ka filluar projektin për pajisjen me kamera të vëzhgimit të një numri të dhomave të intervistimit në disa stacione policore, më 24 nëntor 2020, MKPT-ja kërkoi informata nga Policia e Kosovës për progresin e arritur në projektin për instalimin e kamerave të vëzhgimit në dhomat e intervistuesve, siç ishte planifikuar më herët.

Më 23 dhjetor 2020, Policia e Kosovës, përmes postës elektronike zyrtare, e njoftoi MKPT-në se disa stacione policore i kanë të rregulluara dhomat mike për intervistimin e të miturve, të cilat janë të pajisura edhe me sistem për audio/video incizim. Më tej, në këtë njoftim theksohet se Policia e Kosovës ka lidhur kontratë për furnizim me pajisje për video/audio incizim, ndërsa për shkak të mungesës së buxhetit nuk ka filluar furnizimi dhe instalimi i këtyre sistemeve në dhomat e intervistimit. Sipas Policisë së Kosovës, planifikohet që në vitin 2021 të fillojë implementimi i këtij projekti për pajisje të dhomave të intervistimit me sisteme për audio dhe video incizim. MKPT-ja do të vazhdojë ta monitorojë situatën rreth zbatimit të projektit në fjalë në të ardhmen.

Kushtet fizike të stacioneve policore të vizituara

Sa u përket kushteve fizike në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria në stacione policore, MKPT-ja ka vërejtur se shumica e stacioneve policore të vizituara i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të ndaluar.

Përmes raportit për vizitat në stacione të ndryshme policore gjatë vitit 2020, MKPT-ja ia dërgoi Policisë së Kosovës edhe disa rekomandime të tjera lidhur me kushtet fizike dhe aspekte të tjera të të drejtave themelore të personave të arrestuar apo në ndalim policor.

¹⁹⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, ekstrakt nga raporti i 12 i Përgjithshëm, paragrafi 36. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/16806cd1ed/>

Sa i përket rekomandimit të MKPT-së që të instalohet sistemi i thirrjes në të gjitha vendet e ndalimit policor ku mungon ky sistem, Policia e Kosovës e kishte njoftuar Avokatin e Popullit se ky rekomandim ishte përfshirë në planin e veprimit dhe do të zbatonte deri në dhjetor të vitit 2020.

Lidhur me rekomandimin e MKPT-së që të ndaluarit të furnizohen me çarçafë dhe mjete higjienike, Policia e Kosovës e njoftoi Avokatin e Popullit se ky rekomandim tanimë është zbatuar. Megjithatë, gjatë vizitës në Qendrën Rajonale të Mbjajtjes, më 19 tetor 2020, MKPT-ja vërejtë se ka mungesë të çarçafëve dhe të mjeteve higjienike. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet ta mënjanojnë këtë mangësi sa më shpejt që të jetë e mundur.

Përmes vizitave gjatë periudhës për të cilën po raportohet, por edhe gjatë vizitave të mëhershme, MKPT-ja vërejtë se në asnjë qendër të ndalimit policor, të ndaluarve nuk u ofrohet dalja në ajër të pastër, nëse qëndrojnë në ndalim më shumë se 24 orë. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se legjislacioni vendor nuk përmban dispozita të cilat u garantojnë të ndaluarve daljen në ajër të pastër nëse qëndrojnë në ndalim më gjatë se 24 orë.

Po ashtu, MKPT-ja vëren se KPT-ja, në standardet e publikuara për ndalimin policor, thekson rëndësinë e daljes në ajër të pastër për personat të cilët qëndrojnë në ndalim policor më gjatë se 24 orë, sa herë që një gjë e tillë është e mundur.¹⁹⁷ Në njoftimin nga Policia e Kosovës theksohet se rekomandimi i MKPT-së që të ndaluarve të cilët qëndrojnë në ndalim më gjatë se 24 orë t'u ofrohet së paku një 1 orë qëndrim në ajër të pastër, nuk mund të zbatohet plotësisht për shkak të strukturës së ndërimit në disa objekte policore.

Sa i përket ushqimit, i cili duhet t'u sigurohet të ndaluarve, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton obligimin që nëse personi i privuar nga liria mbahet më shumë se 12 orë, duhet t'i sigurohen tri racione ushqim në ditë. MKPT-ja vërejtë se personave të arrestuar, të cilët dërgohen në mbajtje, u ofrohen tri racione ushqim brenda 24 orëve, sipas kontratës që ka Policia me kompaninë kontraktuese. Gjatë vizitave, MKPT-ja vërejtë se të tri racionet ushqimore janë të njëjta për nga përmbajtja dhe sasia. Bazuar në këtë, MKPT-ja i rekomandoi Policisë së Kosovës që të ndaluarve t'u ofrohet ushqim më cilësor dhe të rritet sasia e ushqimit. Më 2 tetor 2020, Policia e Kosovës e njoftoi Avokatin e Popullit se ky rekomandim tanimë është zbatuar dhe nuk ka ankesa lidhur me këtë çështje.

Po ashtu, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja, bazuar në gjetjet gjatë vizitave, i ka rekomanduar Policisë së Kosovës që të gjendet zgjidhje tjetër apo të kryhen rinovimet e nevojshme për të krijuar kushte adekuate për punë dhe funksionim të stacioneve policore në Prishtinë (Stacioni Policor Veri), Stacioni Policor "Jug", nënstationin policor në Gorazhdec, ai në Fushë Kosovë, në Mamushë, në Skenderaj, në Mitrovicë (stacioni në veri), në Vitomiricë

¹⁹⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Standardet lidhur me ndalimin policor, Raport i 12 i Përgjithshëm, paragrafi 47, Starsburg, 2002. Shih në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed>.

dhe në Viti. Policia e Kosovës e njoftoi MKPT-së se lidhur me këtë rekomandim u njoftua Drejtoria për Menaxhim të Objekteve.

Sa u përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të cilët arrestohen nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike, siç janë: Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e intervistuar lidhur me këtë të drejtë. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet e këtyre personale njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.

Sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, të arrestuarit kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë në stacionin policor ku mbahen, si dhe në IPK. Përveç kësaj, të arrestuarit mund t'i drejtojnë ankesë edhe Avokatit të Popullit. Për t'u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t'ua mundësuar të arrestuarve parashtrimin e ankesës në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka instaluar kuti të ankesave në stacionet policore ku ekzistojnë qelitë për mbajtjen e të arrestuarve.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka zyrtar regjionale në çdo qytet të Kosovës dhe zyrtarët regjionalë i vizitojnë stacionet policore, i hapin kutitë e ankesave dhe i trajtojnë ankesat individuale. Përveç kësaj, të gjitha stacionet policore mund të vizitohen pa paralajmërim edhe nga organizatat joqeveritare, të cilat nënshkruajnë marrëveshje me Policinë e Kosovës për të monitoruar respektimin e të drejtave themelore të personave të arrestuar apo në ndalim policor.

Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Kufizimi i të drejtave të caktuara të të burgosurve në kohë pandemie COVID-19

Pas paraqitjes së COVID-19, më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) deklaroi se shpërthimi i virusit COVID-19 ka arritur nivelin e pandemisë globale. Me këtë rast, OBSH-ja u bëri thirrje qeverive të ndërmarrin masa urgjente dhe agresive për të ndaluar përhapjen e virusit. Në pajtim me këtë deklaratë të OBSH, Qeveria e Republikës së Kosovës filloi t'i ndërmarrë masat e para, të cilat u pasuan në ndërkohë me masa të tjera edhe më të ashpra për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e qytetarëve dhe për të parandaluar përhapjen e virusit në fjalë. Masa të tilla të kufizimit të lirive dhe të të drejtave u ndërmorën edhe në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit.

Disa të drejta të të burgosurve, të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. -04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (tani e tutje: LESP) dhe me ligjet e tjera në fuqi, varësisht nga situata me COVID-19 u kufizuan dhe sërish u rikthyen pas përmirësimit të gjendjes me COVID-19. Këto të drejta në përgjithësi janë: kontaktet me botën jashtme, realizimi i vizitave familjare dhe i vizitave të lira, zhvillimi i aktiviteteve brenda burjeve etj.

Vizitat e realizuara në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka kryer vizita *ad-hoc* në Qendrën Korrektuese në Dubravë, në Burgun e Sigurisë së Lartë, në Qendrën Korrektuese për të Mitur, në Qendrën Korrektuese për Femra, në Qendrën Korrektuese Edukuese, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë dhe në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Qëllimi i këtyre vizitave ishte vlerësimi i trajtimit dhe i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), me Ligjin nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Keqtrajtimi fizik

Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit dhe kontakteve përmes telefonit me të burgosurit gjatë vitit 2020, MKPT-ja nuk mori ankesa të besueshme për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Në përgjithësi, MKPT-ja vërejti komunikim të mirë interaktiv ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues.

Incidentet ndërmjet të burgosurve

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, në përgjithësi nuk janë shënuar incidente serioze ndërmjet të burgosurve. MKPT-ja ka pranuar raporte nga Departamenti Shëndetësor në Burgje (tani e tutje: DShB), të cilat u referohen rasteve kur të burgosurit kërkuan ndihmë mjekësore për shkak të lëndimeve trupore si pasojë e përlëshjeve ndërmjet të burgosurve. Gjatë vizitave dhe përmes komunikimit zyrtar me autoritetet kompetente, MKPT-ja ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës dhe në dokumente të tjera administrative, si dhe në protokollat adekuate të njëjësive shëndetësore. Për më shumë, bazuar në njoftimet zyrtare dhe dokumentacionin e pranuar nga autoritetet, janë zhvilluar hetime të brendshme dhe hetime nga Policia e Kosovës në raste të caktuara, u ndërmorën masa disiplinore bazuar në gjetjet e komisioneve disiplinore, si dhe u ndërmorën masa për të garantuar sigurinë fizike të të burgosurve.

Për shkak të COVID-19 dhe bazuar në respektimin e parimit të mosshkaktimit të dëmit më të madh, MKPT-ja nuk ishte në gjendje të shkonte gjithmonë në vend të ngjarjes në qendrat korrektuese apo në ato të paraburgimit për të verifikuar faktet relevante lidhur me këto incidente.

MKPT-ja, duke çmuar lart veprimet e personelit mjekësor të DShB-së dhe të autoriteteve të tjera të sigurisë, edhe nëpërmjet këtij raporti ua rikujton autoriteteve obligimin që kanë për parandalimin e dhunës ndërmjet të burgosurve, për të cilët ata janë përgjegjës.

Kjo përgjegjësi përfshin obligimin për t'u kujdesur dhe për të miratuar masa parandaluese për ta reduktuar rrezikun e dhunës, si dhe për t'i mbrojtur të burgosurit më të cenusëm. MKPT-ja, bazuar në informatat e grumbulluara gjatë vitit 2020, vërejti se raportet ndërmjet të

burgosurve në përgjithësi janë të mira dhe nuk ka klimë tensioni ndërmjet tyre dhe incidentet ndërmjet të burgosurve nuk duket se janë problem madhor për qendrat korrektuese e as për ato të paraburgimit.

Kushtet e akomodimit në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit

Neni 3 i Ligjit nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”*

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të gjendjes me COVID-19, MKPT-ja nuk ishte në gjendje të kryente vizita të përgjithshme të cilat do ta përfshinin edhe vlerësimin e kushteve të akomodimit për të burgosurit në secilën qendër korrektuese dhe në të paraburgimit, të cilën e ka vizituar, përveç në disa prej tyre.

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, më 1 dhjetor 2020, MKPT-ja vërejtë se kushtet e akomodimit janë në nivel të kënaqshëm në kuptim të hapësirës për banim, dritës natyrore dhe artificiale, si dhe të pastërtisë. MKPT-ja vlerësoi se kushtet e akomodimit në këtë qendër janë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe me Standardet e KPT-së.¹⁹⁸

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë, MKPT-ja vërejtë se u rinovua dhoma e kontrollit, janë kryer disa rinovime të pjesshme në spital, por jo të cilësisë së kënaqshme. Po ashtu ka filluar rinovimi i kuzhinës dhe të gjitha punët kryhen nga të burgosurit. Më 1 dhjetor 2020, MKPT, përmes një shkrese zyrtare, kërkoi nga ShKK-ja informata se a kishte rinovime gjatë vitit 2020 në qendrat korrektuese dhe në ato të paraburgimit si dhe a kishte vlerësime nëse duhen kryer rinovime në qendra të caktuara korrektuese apo në të paraburgimit, me qëllim që kushtet fizike të jenë në pajtim me standardet nacionale dhe me ato ndërkombëtare.

Më 7 dhjetor 2020, ShKK-ja e njoftoi MKPT-në se gjatë vitit 2020, për shkak të COVID-19 dhe për shkak të shkurtimeve buxhetore, ka hasur në vështirësi për të kryer rinovime në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit, sidomos në ato të cilat janë ndërtim i vjetër. Më tej në këtë njoftim theksohej se përkundër vështirësive, janë realizuar projektet, si në vijim: në Qendrën Korrektuese në Dubravë u rinovua kuzhina, rinovimi i kulmit të dhomës së kontrollit, instalimi i kaldajës, ndërtimi i fermës së pulave.

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, MKPT-ja vërejtë se është në përfundim e sipër rinovimi i Bllokut A dhe u rinovuan edhe blloqet e tjera. Sipas njoftimit

¹⁹⁸ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e banimit për një të burgosur në burgje, publikuar më 15 dhjetor 2015. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cc449>

nga drejtoria e kësaj qendre, rinovimi përfshinë krijimin e dhomave për të miturit me nevoja të veçanta, salla të rekreacionit, kuzhina etj.

Në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë u rinovua kuzhina dhe u instalua ndriçimi. Megjithatë, rekomandimi i MKPT-së që të rinovohet kulmi i pavijonit ku vendosen të dënuarit në këtë qendër korrektuese, pasi gjatë vizitës u vërejt se pikonte uji, ende nuk është zbatuar. Ky rekomandim iu dërgua Ministrisë së Drejtësisë përmes Raportit me rekomandime për vizitën në këtë qendër në vitin 2019.¹⁹⁹

Në Burgun e Sigurisë së Lartë është në progres rregullimi i fushave sportive dhe i dysHEMEVE të dëmtuara. Po ashtu u instaluan kamerat e sigurisë në disa qendra korrektuese (projekt i përfunduar).

Në fund të vitit 2020, ShKK-ja publikoi një njoftim për publikun²⁰⁰, në të cilin theksohej se qendrat korrektuese dhe të paraburgimit kanë filluar të furnizohen me dyshekë cilësorë, jastëkë dhe batanije kundër zjarrit, pasi ato aktuale janë të vjetra dhe nuk i plotësonin standardet e parapara me LESP për akomodim të të burgosurve. MKPT-ja përmes raporteve me rekomandime i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që kjo mangësi të mënjanohej sa më shpejt. Prandaj MKPT-ja mirëpret evitimin e kësaj mangësie serioze nga autoritetet kompetente.

Mbipopullimi

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja vërejt se mbipopullimi nuk paraqet problem madhor për qendrat korrektuese dhe as për ato të paraburgimit. Në raste të rralla është vërejtur mbipopullim tejet simbolik në periudhat sa ka pasur rinovime në pavijone të caktuara, por i cili është mënjanoar pa ndonjë vonesë të madhe.

Regjimi

Me qëllim të risocializimit të të burgosurve, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Kodi i Procedurës Penale²⁰¹ shprehimisht përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që të burgosurit t'i angazhojnë në punë, në aktivitete kulturore, në aktivitete arsimore dhe sportive.²⁰²

Gjatë periudhës për të cilën por raportohet, MKPT-ja, bazuar në vizitat e realizuara dhe në njoftimet zyrtare nga autoritetet kompetente, vërejt se për shkak të COVID-19, të burgosurve u kufizuan të drejta të caktuara, të cilat u garantohen me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, siç janë: vizitat familjare, takimet me avokatët mbrojtës, vizitat e lira etj.

¹⁹⁹ MKPT, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/05/21/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-smrekonice/>

²⁰⁰ Shërbimi Korrektues i Kosovës, shih në: <https://www.facebook.com/SherbimiKorrektuesiKosoves>.

²⁰¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 199, paragrafi 2, dhe neni 200.

²⁰² Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 55, si dhe neni 200, paragrafi 1.

Por në periudha të caktuara, këto masa të kufizimit u pezulluan dhe të burgosurit sërish i gëzuan ato.

Të burgosurit në qendrat korrektuese dhe në ato të paraburgimit u angazhuan në punë dhe në aktivitete të tjera, varësisht nga gjendja me COVID-19.

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë, MKPT-ja vërejti se ishin të angazhuar në punë rreth 300 të burgosur nga numri i përgjithshëm prej 600 të burgosurish. Të burgosurit u angazhuan në punë në kuzhinë, në feramat e qendrës korrektuese, në thertore, në kopshte, në mirëmbajtje të higjienës, në pavijone etj. Të burgosurve në këtë qendër korrektuese u mundësuan aktivitetet sportive si më parë, përveç fitnesit, pasi salla mbahej e mbyllur për shkak të pandemisë.

Në kuadër të programeve trajnuese që ofron ShKK-ja për të burgosurit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, u certifikuan 32 të burgosur të kësaj qendre. Të burgosurit përfunduan me sukses trajnimet profesionale dhe u certifikuan në këto lëmi: Word – Excel, axhustator – saldues, ndërtimtari, zdrukthëtari, kuzhinieri.

Në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, sipas njoftimit nga drejtoria dhe konstatimit të MKPT-së gjatë vizitës më 1 dhjetor 2020, të gjitha të dënuarat u angazhuan në punë. Kështu, 38 të burgosura ishin të angazhuara në punë në kuzhinë, në lavanteri, në mirëmbajtje, në qepje të maskave mbrojtëse, çarçafëve, jastëkëve, në mirëmbajtje të kopshteve dhe kultivim të pemëve dhe perimeve, si dhe në punim të vazove për lule dhe në pikturim. Përveç kësaj, në këtë qendër u instalua serra bujqësore, në të cilën angazhohen në punë të dënuarat.

Gjatë kësaj periudhe u certifikuan 8 të burgosura, të cilat përfunduan më sukses trajnimet profesionale në rrobaqepësi dhe floktari. Certifikimi rrodhi si rezultat i bashkëpunimit mes ShKK-së dhe “Caritas Kosova”.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, u mbajtën trajnime dhe u certifikua grupi i tretë i të dënuarave në trajnimin me titull “Menaxhimi i Zemërimit”. MKPT-ja u njoftua se një e dënuar arriti me sukses t’i përfundojë studimet universitare *online*, kishte aktivitete sportive dhe aktivitete në fushën e dramaturgjisë (psikodrama), ku u përfshinë 16 të dënuara.

Qendra e Paraburgimit në Prizren ka mundësi dukshëm më të kufizuara për të angazhuar në punë dhe në aktivitete të tjera të dënuarit dhe të paraburgosurit, për shkak të konstruksionit të ndërtesës, e cila është ndërtim i vitit 1960. Bazuar në statistikat e dërguara nga drejtoria e kësaj qendre, në përgjithësi në punë janë të angazhuar 15 të burgosur (11 të dënuar dhe 4 të paraburgosur). Në përgjithësi në këtë qendër, regjimi mbetet i varfër dhe pa mundësi për të

ofruar më shumë, pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë. Një gjendje e tillë u konstatua edhe në raportin me rekomandime i MKPT-së për vizitën në këtë qendër në vitin 2019.²⁰³

E njëjta gjendje është edhe në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, për shkak të konstruksionit dhe vjetërisë së ndërtesës. Sipas njoftimit nga drejtorja, gjatë vitit 2020, në përgjithësi u angazhuan në punë për mirëmbajtje dhe kuzhinë rreth 24 të burgosur, ndërsa aktiviteti kryesor për ta është shëtitja në ajër të pastër dhe marrja me ushtrime fizike në ajër të pastër. MKPT-ja vëren se nuk ka ndonjë ndryshim në raport me gjendjen e konstatuar gjatë vizitave të realizuara në vitin 2019 dhe konstatimeve në raportin me rekomandime për vizitën në këtë qendër.²⁰⁴

Në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, e cila akomodon edhe një numër të të dënuarve, bazuar në njoftimet nga drejtorja, për momentin janë të angazhuar në punë 21 të burgosur, ndërsa aktivitetet sportive u lejohen gjatë kohës kur ata dalin për ajrosje. Gjatë kësaj periudhe, në këtë qendër u organizuan trajnime për menaxhimin e sjelljes, të cilin e përfunduan 10 të burgosur. Po ashtu, punëtoritë (rrobaqepësi, zdrukthëtari, shtypshkronjë) e kësaj qendre në të cilat angazhohen në punë dhe trajnime të burgosurit, janë aktive përveç në fazën e parë të pandemisë COVID-19.

Sa i përket së drejtës për dalje në ajër të pastër, në përgjithësi në të gjitha qendrat korrektuese dhe në ato të paraburgimit, kjo e drejtë u realizua pa kufizime, në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale,²⁰⁵ përveç në raste kur kishte dyshime se i burgosuri mund të jetë i infektuar me COVID-19, ku dalja në ajër të pastër u reduktua në një orë.

Regjimi për të paraburgosurit

Megjithatë, për MKPT-në, edhe për këtë periudhë për të cilën po raportohet, mbetet shqetësues regjimi që u ofrohet të paraburgosurve në të gjitha qendrat e paraburgimit. Lidhur me këtë, MKPT-ja, pas vizitave në të gjitha qendrat e paraburgimit gjatë vitit 2019 dhe më parë, përmes raporteve me rekomandime²⁰⁶ i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që të

²⁰³ Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/06/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-ne-lidhje-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prizren/>.

²⁰⁴ Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/12/17/leter-rekomandim-perkitazi-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-peje/>.

²⁰⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 37.

²⁰⁶ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, publikuar më 22 nëntor 2019, paragrafët 15-21. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/11/25/raport-me-rekomandimi-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prishtine/>. Raport me rekomandime për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë, publikuar më 22 nëntor 2019, paragrafët 12-23. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/11/25/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-burgun-e-sigurise-se-larte/>. Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, publikuar më 16 gusht 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/19/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-lipjan/>. Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, publikuar më 5 gusht 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/08/06/raport-me-rekomandime-i-mkpt-se-ne-lidhje-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prizren/>

shtohen përpjekjet që të paraburgosurve t'u ofrohet një regjim, i cili do t'u mundësonte të kenë edhe aktivitete të tjera ditore, përveç shëtitjeve në ajër të pastër dy herë në ditë nga një orë. MKPT-ja vërejtë se angazhimi i tyre në punë është i rrallë dhe, sipas drejtorive të qendrave korrektuese dhe të paraburgimit, kjo ndodh për shkak se angazhimi i tyre është subjekt i lejes nga gjykata kompetente.

Megjithatë, në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojnë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”*

Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësisë ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”*

Në raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili u publikua në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjimin për të paraburgosurit, shprehu shqetësimin se pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, përveç dy orëve të shëtitjes në ditë, duke shikuar TV dhe duke luajtur me letra.²⁰⁷

Përmes këtij raporti, KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente në Republikën e Kosovës, si në vijim: *“KPT, ri-përsërit rekomandimin që autoritetet të angazhohen që të rrisin aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në të gjitha institucionet të cilat KPT i vizitoi, dhe në të gjitha institucionet tjera të Shërbimit Korrektues të Kosovës ku një gjë e tillë është e përshtatshme.”* Më tej KPT-ja thekson: *“Sa më e gjatë që është periudha e paraburgimit, aq më shumë duhet të zhvillohet regjimi i cili u ofrohet atyre. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që edhe numri i personelit të rritet, ku një gjë e tillë është e nevojshme.”*

KPT-ja, pas vizitës në Republikën e Kosovës në tetor 2020, gjatë takimit me ministrin e Drejtësisë dhe me personelin e tij, sërish shprehu shqetësimin lidhur me regjimin e varfër, i cili u ofrohet të paraburgosurve.

MKPT-ja konsideron se bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që ta rritin angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

²⁰⁷ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, publikuar në shtator 2016, paragrafi 46. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

Kontaktet me botën e jashtme

Legjislacioni në fuqi,²⁰⁸ në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe në vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.

Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese²⁰⁹ përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, MKPT nuk ka marrë asnjë ankesë nga të paraburgosurit dhe as nga të dënuarit lidhur me këtë të drejtë.

Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita *“brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit”*, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, Kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të pandemisë COVID-19, këto të drejta varësisht nga situata, ShKK u detyrua që t’i ndalojë vizitat familjare, vizitat e lira, takimet me avokatët mbrojtës dhe kontakte e tjera me botën e jashtme, varësisht nga situata me COVID-19. Pas përmirësimit të gjendjes, këto të drejta u rikthyen sërish dhe të burgosurit i gëzuan plotësisht.

Për shkak të përkeqësimit të gjendjes me COVID-19 në Republikën e Kosovës, ShKK-ja, më 19 tetor 2020, njoftoi opinion publik: *“Me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë dhe mbrojtjes së shëndetit të burgosurve dhe stafit në institucionet korrektuese, Shërbimi Korrektues i Kosovës është detyruar që të ndër marrë veprime të nevojshme, me ç` rast ka nxjerrë Urdhër Operativ për ndalimin e përkohshëm të vizitave familjare, vizitave të organizatave joqeveritare dhe vikendeve për të burgosur”*.²¹⁰ Më tej, në këtë njoftim theksohet: *“Si alternativë në të gjitha institucionet korrektuese do mundësohen telefonatat me të shpeshta dhe sistemi i komunikimit virtual përmes SKYPE sipas procedurave institucionale. Po ashtu, për shkak të ndalimit të përkohshëm të vizitave, pastrimi i rrobave për të burgosur do të organizohet në Institucione.”*

MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, nuk ka marrë ankesa nga të dënuarit dhe as nga të paraburgosurit lidhur me të drejtën për kontakte me botën e jashtme. Ky vendim është ende në fuqi, ndërsa MKPT-ja do ta monitorojë situatën me qëllim të konstatimit nëse

²⁰⁸Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

²⁰⁹Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

²¹⁰ Shërbimi Korrektues i Kosovës, Njoftim, 19 tetor 2020. Shih në: https://shkk.rks-gov.net/al/lajmi_single/2913.

kjo masë është proporcionale, në pajtim me rekomandimet e organeve kompetente shëndetësore dhe nëse e njëjta është subjekt i shqyrtimit kohë pas kohe.

Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit

Shërbimet shëndetësore në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë, respektivisht nga DShB-ja, qysh nga viti 2013, pasi deri atëherë ky shërbim menaxhohej nga Ministria e Drejtësisë. Shërbimet shëndetësore për të burgosurit ofrohen në njësitë shëndetësore të DShB-së në të gjitha qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit dhe në institucionet publike shëndetësore, sipas nevojës. Në kuadër të QKD-së funksionon edhe spitali i burgut.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka pranuar ankesa nga të burgosurit lidhur me trajtimin shëndetësor. Në të gjitha rastet, MKPT-ja ka kërkuar raporte mjekësore dhe administrative nga DShB-ja dhe nga autoritetet e tjera, të cilat i ka analizuar dhe ka konstatuar se në përgjithësi të burgosurve ua ofruan shërbimet e duhura mjekësore edhe në kohë të pandemisë, ndërsa disa vonesa për t'ua ofruar shërbimet mjekësore apo për të dërguar të burgosurit në institucione publike shëndetësore sipas rekomandimit të mjekut kompetent ndodhën si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe nganjëherë si pasojë e mungesës së mjeteve të transportit, për shkak të numrit të madh të kërkesave. Në të gjitha rastet, këto vonesa nuk shkaktuan pasoja për shëndetin e të burgosurve.

Kontrollet mjekësore për të sapopranuarit

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore, sidomos në rastet e të burgosurve apo të të paraburgosurve të sapopranuar jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.²¹¹

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale²¹² dhe PSV²¹³ e DShB përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës²¹⁴, Rregullat Evropiane të Burgjeve²¹⁵. MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, bazuar në vizitat e realizuara

²¹¹ KPT, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në vitin 2016, paragrafi 62. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>

²¹² Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

²¹³ Praktika Standarde e Veprimt, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimt-n%C3%AB-DShB.pdf>

²¹⁴ https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

²¹⁵

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

dhe raportet e dërguara nga DShB-ja, ka vërejtur se të gjithë të burgosurve të sapopranuar u bëhen kontrollet mjekësore brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.

MKPT-ja ka vërejtur se gjatë periudhës për të cilën po raportohet, përveç kontrolleve të zakonshme, të sapopranuarit u vendosën në karantinë në periudhë dyjavore, për të parandaluar dhe luftuar infektimet me COVID-19.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me PSV-në²¹⁶, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me LESP-në²¹⁷ dhe me Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak në Qendra Korrektuese²¹⁸, si dhe me aktet relevante ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.²¹⁹ Edhe gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se në përgjithësi këto shërbime shëndetësore jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

Personeli i qendrave korrektuese dhe i të paraburgimit

MKPT-ja, përmes raporteve me rekomandime për vizitat në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit në vitin 2019 dhe më parë, u rekomandoi autoriteteve kompetente që sipas vlerësimit dhe nevojës, të angazhojnë personel korrektues dhe punëtorë socialë shtesë, pasi u vërejtën mungesa të shumta të zyrtarëve korrektues. Po ashtu mosha mesatare dhe sëmundjet e ndryshme tek disa zyrtarë korrektues ishin problem madhor për ShKK-në.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, qendrat korrektuese dhe burgjet u përballën me ngarkesë shtesë për shkak se disa zyrtarë korrektues rezultuan pozitiv me COVID-19, por edhe për angazhimet shtesë për shkak të kësaj pandemie. Bazuar në informatat e dërguara nga ShKK-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet e deri më tani gjithsejtë 277 zyrtar korrektues u testuan, nga të cilët 93 rezultuan pozitiv.

Procedura e parashtrimit të ankesave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit

Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo brenda qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

²¹⁶ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

²¹⁷ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

²¹⁸ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 25, paragrafi 3.

²¹⁹ Rregullat e Mandelës, Rregullat Evropiane të Burgjeve, Standardet e KPT-së, dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.

Neni 91 i LESP-së përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës, të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të ShKK-së. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja nuk ka marrë ankesa të besueshme nga të burgosurit për mospërgjigje nga organet kompetente të ShKK-së në ankesat dhe në kërkesat e tyre. Përveç MKPT-së, të burgosurit mund t'u drejtohen me ankesa edhe organizatave joqeveritare, të cilat i vizitojnë vendet e privimit nga liria, sipas marrëveshjes që kanë me ministrinë përkatëse.

Ankesat kundër Panelit për Lirim me Kusht

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka marrë ankesat e të dënuarve, parashtruar kundër Panelit për Lirim me Kusht (tani e tutje: PLK), për mosdërgim të aktvendimeve të të dënuarve, të cilët parashtruan kërkesë dhe lënda e të cilëve u shqyrtua nga ky organ. Këto ankesa u morën në fillim të vitit 2020. Lidhur me këto ankesa, MKPT-ja, varësisht nga ankesat e marra, ka kërkuar informata shtesë nga PLK-ja dhe i ka rekomanduar PLK-së që t'i përmbushte obligimet ndaj parashtruesve të kërkesave për lirim me kusht, të cilat burojnë nga Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e PLK-së. Gjendja u përmirësua dukshëm pasi PLK-ja filloi të dërgonte rregullisht njoftimet dhe aktvendimet nëpër të gjitha qendrat korrektuese. MKPT-ja më vonë nuk ka marrë asnjë ankesë lidhur me çështjen e lartpërmendur.

Më pastaj, MKPT-ja mori ankesa nga të burgosurit për shkak të mosshqyrtimit të kërkesave të tyre për lirim me kusht, pasi PLK-ja dhe institucionet e tjera iu nënshtrua masave të kufizimit për shkak të pandemisë dhe punës me personel të kufizuar.

Bazuar në statistikën e dërguar nga PLK-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, PLK-ja, nga 1 janar 2020 deri më 30 nëntor 2020, ka mbajtur 46 seanca, ka shqyrtuar 679 kërkesa për lirim me kusht, ka aprovuar 264 kërkesa për lirim me kusht, i ka refuzuar 366 kërkesa, ndërsa në 32 raste është pushuar procedura e shqyrtimit për lirim me kusht për arsye të lirimit të parakohshëm nga ana e gjykatave, në 15 raste janë hedhur poshtë kërkesat dhe 2 kërkesa janë pezulluar. Bazuar në informatat zyrtare të dërguar nga ShKK-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, 294 të dënuar përfituan nga lirimi i parakohshëm.

Qendra për Azilkërkues

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja e ka vizituar Qendrën për Azilkërkues, më 31 janar 2020, me ç' rast u njoftua nga drejtori i qendrës se janë duke u përballur me një fluks më të madh të azilkërkuesve sesa më parë. Gjatë kësaj vizite, MKPT-ja nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik, as për sjellje të zyrtarëve të qendrës, përfshirë ata të sigurisë, që do të ishte në kundërshtim me respektimin e dinjitetit të azilkërkuesve, e as për mosrespektim të të drejtave të tyre themelore, të cilat u garantohen me Ligjin për Azil.²²⁰

²²⁰ Ligji nr. 06/L-026 për Azil, neni 26.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, u shënuar rritje e numrit të azilkërkuesve, të cilët kërkuar azil në Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, MKPT-ja, më 7 dhjetor 2020, përmes postës elektronike zyrtare, ka kërkuar informata nga DShAM-ja për situatën gjatë periudhës për të cilën po raportohet. Më 17 dhjetor 2020, DShAM-ja e njoftoi MKPT-në se në vitin 2020 në Republikën e Kosovës kërkuar azil 1362 persona, të cilët u akomoduan në institucionet përkatëse.

Kushtet e akomodimit në Qendrën për Azilkërkues në Magure vazhdojnë të jenë të njëjti standardi të lartë. Po ashtu, në këtë qendër ekzistojnë hapësira të përshtatshme për qëndrim të fëmijëve, këndi i lojërave brenda dhe jashtë në oborr. Sipas njoftimit nga DShAM-ja, edhe gjatë vitit 2020, azilkërkuesve u ofruan shërbime të ndryshme, siç janë: shërbimet mjekësore nga institucionet publike shëndetësore të Kosovës, ndërsa shërbimet psikologjike u ofruan nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, si dhe janë ofruar kurse dhe trajnime për azilkërkuesit, rekuizita dhe asistencë sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Menaxhimi i situatës gjatë pandemisë COVID-19

Sipas njoftimit nga DShAM-ja, ende pa u paraqitur rastet me COVID-19 në vend, u morën masat e nevojshme në bashkëpunim me organet kompetente dhe me disa organizata ndërkombëtare. Të gjitha masat u ndërморën në pajtim me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me organet kompetente shëndetësore. Këto masa në përgjithësi i referohen kufizimit të lirisë së lëvizjes. Ndërsa udhëzimet për parandalim të COVID-19, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë, u përkthyer në gjuhë të ndryshme dhe u udhëzuan aplikuesit që t'u përmbahen rregullave kundër COVID-19. Po ashtu, këshillimet psikologjike dhe ligjore azilkërkuesve u ofruan *online*.

Qendra e Mbajtjes për të Huajt

Më 30 janar 2020, MKPT-ja vizitoi Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në të cilën në kohën e vizitës gjendej vetëm 1 person (shtetas i Republikës së Kosovës). Personi në mbajtje u intervistua nga MKPT-ja dhe nuk kishte ankese lidhur me trajtimin nga autoritetet dhe as për të drejtat e tjera, të cilat i garantohen me legjislacionin në fuqi.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, kjo qendër, edhe pse e dedikuar për akomodim të personave të cilët duhet të largohen forcërisht nga territori i Republikës së Kosovës, e njëjta u përdor gjatë COVID-19 si objekt për vendosjen në karantinë të të huajve.

Monitorimi i operacioneve të kthimit me forcë përmes linjave ajrore

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja monitoroi në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dy operacione të kthimit me forcë të shtetasve të Republikës së Kosovës nga autoritetet zvicerane. Ky monitorim bazohet në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar

ndërmjet IAP-së dhe Komisionit Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.²²¹ Gjatë monitorimit të operacioneve në fjalë, MKPT-ja ka vërejtur se të kthyerit me forcë janë trajtuar në mënyrë humane dhe korrekte nga autoritetet policore të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, MKPT-ja ka hasur në bashkëpunim të plotë të Policisë së Kosovës gjatë realizimit të këtyre operacioneve.

Institucionet e shëndetit mendor

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vizituar Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK), Repartin e Urgjencës dhe të Kujdesit Intensiv Psikiatrik i Klinikës Psikiatrike (UKIP), Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP), Institutin Special në Shtime, Shtëpinë me Bazë në Komunitet në Shtime, Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime si dhe Shtëpitë për të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare, në Gurrakoc dhe në Skenderaj.

Qëllimi i vizitave ishte vlerësimi i gjendjes së institucioneve në fjalë, menaxhimi i situatës gjatë pandemisë, progresit të autoriteteve kompetente në implementimin e rekomandimeve të MKPT-së, të dërguara përmes raporteve të mëhershme me rekomandime. Për shkak të gjendjes së pandemisë dhe parimit të mosshkaktimit të dëmit më të madh, MKPT-ja nuk realizoi vizita në disa institucione të tjera të shëndetit mendor. Megjithatë, MKPT-ja ka kërkuar raporte nga këto institucione duke u fokusuar në kapacitetin, incidentet, aktivitetet dhe në veçanti sfidat gjatë COVID-19.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës

Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës (IPFK) është hapur në gusht të vitit 2014. Aktualisht është nën menaxhimin e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Në bazë të Ligjit për Shëndetin Mendor, IPFK-ja është njësi organizative e ShSKUK-së dhe sipas ligjit në fuqi ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin. Në IPFK akomodohen personat të cilët kanë kryer vepra penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrimit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik²²², si dhe personat të cilët janë subjekt i urdhrimit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor.²²³

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja e ka vizituar IPFK-në vetëm një herë, si pasojë e reduktimit të metodologjisë së vizitave (nuk ishte vizitë e vlerësimit të përgjithshëm, por *ad-hoc*, duke trajtuar çështje të caktuara) për shkak të pandemisë COVID-19.

²²¹Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Institutit të Avokatit të Popullit dhe Komisionit Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës për monitorim të operacioneve të kthimit me forcë, i nënshkruar më 24 prill 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/04/25/nenshkruhet-memorandumi-i-mirekuptimit-ne-mes-te-zvices-dhe-kosoves-per-parandalim-te-tortures-dhe-monitorim-te-perbashket-te-operacioneve-te-kthimit-me-force/>

²²² Kodi Penal i Kosovës, neni 89.

²²³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 508, paragrafi 4.

Kapaciteti i këtij institucioni është 36 shtretër (nga 12 shtretër në secilin repart). IPFK-ja përbëhet nga Reparti A (Pranimi/pacientët jo të shtrirë), Reparti B (Trajtimet e detyrueshme psikiatrike), Reparti C (Ekspertizat psikiatrike), dhe Reparti D (për risocializim). Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) është përgjegjës për Repartin A, B dhe D, ndërsa Shërbimi Korrektues është përgjegjës për menaxhimin dhe sigurinë në Repartin C.

Në Repartin B janë të vendosur pacientët të cilëve gjykata ua ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion. Në kohën e vizitës nga MKPT-ja, në IPFK ishin prezentë 14 pacientë me histori të hapur, 3 prej tyre në vikend terapeutik. Sipas informatave nga stafi, në listë të pritjes për Repartin B janë edhe 7 pacientë. Sipas vlerësimit të drejtuesve të institucionit, numri i shtretërve nuk mjafton për tërë vendin.

Sipas pretendimeve të drejtorit, problem shtesë përbën edhe mosndërrimi i masës nga gjykata kompetente në 4 raste, të cilëve gjykata ua vazhdoi qëndrimin në IPFK, përkundër arritjes së objektivave për trajtim të atyre rasteve. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se në kontekst të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, sipas standardeve ndërkombëtare dhe nacionale, gjykatat kompetente duhet t'i rishqyrtojnë vendimet për trajtim të detyrueshëm psikiatrik.²²⁴

Në Repartin C janë të vendosur pacientët të cilët sillen nga ShKK-ja, të cilët janë ose të paraburgosur kur gjykata kërkon vlerësimin e gjendjes mendore (ekspertizë psikiatrike), ose janë të dënuar të cilët sillen nga burgjet për trajtim. Në kohën e vizitës nga MKPT-ja, ishin prezentë 10 raste, prej tyre 7 meshkuj dhe 3 femra të paraburgosura. Në këtë repart ka hapësirë vetëm për dy kategori, ndërsa nëse ka kërkesa për të mitur të burgosur, nuk mund t'i pranohet pa u liruar vendet nga repartit ku janë vendosur femrat e burgosura.

Në kuadër të IPFK-së është edhe Reparti D – i risocializimit. Në kohën e vizitës nga MKPT-ja, ishin prezentë 16 raste me histori të hapur, ku 6 prej tyre ishin në vikende terapeutike. Kapaciteti zyrtar i repartit është 12 shtretër, prandaj kjo gjendje përbën mbipopullim simbolik, i cili duhet të mënjanohet nga autoritetet kompetente.

Po ashtu, sfida për mirëfunksionim të institucionit përbën trajtimi i personave të cilët janë përdorues të substancave narkotike, pasi Klinika e Psikiatrisë e ka vetëm një repart për personat me vartësi nga drogat, ku i mbajnë deri në dy javë për detoksifikim.

Kushtet e akomodimit të pacientëve

Kushtet materiale në IPFK në përgjithësi janë të mira, dhomat janë me nga dy shtretër, pacientët kanë qasje në dritë natyrale, ventilim, ndërsa sistemi i alarmit është në dispozicion të pacientëve. Dhomat e pacientëve kanë ormanë, por janë të dëmtuar dhe nuk mund të mbyllën. Po ashtu ka hapësirë për qëndrimin ditë për pajisur me karrige, televizor, lojëra

²²⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 89 paragrafi 2. Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 176. Ligji për Shëndetin Mendor, neni 24. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

(shahu) si dhe hapësirë të përshtatshme për kuzhinë. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se mungon sistemi kabllor për TV.

Trajtimi dhe aktivitetet

Në IPFK, përveç vlerësimit, trajtimin me medikamente, ofrohet edhe trajtim psiko-social. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, furnizimi me barna nuk ishte i mirë. Prandaj familjarët shpesh detyrohen t'i blejnë ato. Ka mungesa të materialit shpenzues, dorëza, maska dhe mjete dezinfektuese.

Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitetet, si: lojëra, shikim televizori, vizatime, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitore të IPFK-së), seanca individuale me psikologun etj. Orari i aktivitetëve ditore është i vendosur në vende të dukshme, por ky orar është uniform dhe nuk ka plane individuale të aktivitetëve të listuar për pacientët.

Për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19 dhe bazuar në vendimet e autoriteteve të cilat parashohin masa për parandalim të OCIVD-19, aktivitetet grupore janë zvogëluar, u realizuan 4 dalje me personel jashtë institucionit, ndërsa vizitat e familjarëve janë pezulluar. Gjatë pandemisë është rritur numri i telefonatave përmes punonjësit social.

Repartit i Urgjencës dhe i Kujdesit Intensiv Psikiatrik

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja, më 5 mars, më 17 gusht dhe më 2 dhjetor 2020, ka vizituar Repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (tani e tutje: UKIP), i cili funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

UKIP-i është njësi e mbyllur dhe funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike. Moshë e pacientëve të vendosur aty zakonisht është nga 16-65 vjeç. Në këtë repart trajtohen rastet e çrregullimeve të ndryshme psikotike, të çrregullimeve bipolare dhe të çrregullimeve të personalitetit, të cilat nuk mund të trajtohen në repartet e tjera. Ky repart është i vetmi në tërë territorin e Kosovës. Në spitalet e tjera regjionale, repartet psikiatrike nuk i kanë funksionale dhomat e veçanta ku trajtohen rastet urgjente. Rastet e tilla nga tërë Kosova sillen në repartin UKIP të Klinikës Psikiatrike në Prishtinë. MKPT-ja konsideron se repartet psikiatrike në spitalet e tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente. MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime në vitin 2018, u rekomandoi autoriteteve kompetente aktivizimin e këtyre dhomave të veçanta për trajtim të rasteve urgjente.²²⁵

Kushtet e akomodimit në UKIP

Kapaciteti i këtij reparti është 14 shtretër, të ndarë në dy krahë: 7 shtretër për meshkuj dhe 7 shtretër për femra. MKPT-ja ka vërejtur se muret ka kohë që nuk janë lyster, disa xhama të

²²⁵ MKPT, Raport me rekomandime për vizitën në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë, publikuar më 26 tetor 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-psikiatrike-ne-qkuk/>.

dritareve janë të krisur, dritaret kanë grila hekuri, ndërsa banjat kanë lagështi. Hapësirat e dhomave nuk kanë zbulime, disa piktura janë në mure të dhomës së ditës dhe në atë të ushqimit. Reparti ka katër dhoma të izolimit, ku dy prej tyre janë jashtë funksionit si dhe kanë dyshekë joadekuat. Dhomat e izolimit janë larg personelit shëndetësor dhe butoni i alarmit është jashtë funksionit. MKPT-ja konsideron se në repartin UKIP të Klinikës Psikiatrike duhet të bëhen rinovime sa më shpejt që të jetë e mundur.

MKPT-ja nuk ka marrë nga pacientët asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për sjellje të personelit, e cila do ta fyente dinjitetin njerëzor të pacientit.

Mjetet e kufizimit

Në repart nuk përdoret kufizimi mekanik, por vetëm ai farmakologjik si dhe masa e izolimit. MKPT-ja konsideron se përderisa reparti e përdor masën e izolimit, ky mjet kufizimi duhet të jetë subjekt i një politike të detajuar për pacientët të cilët vendosen në dhomë izolimi, e cila duhet të përmbajë informatat për situatat kur mund të përdoret izolimi, objektivat e synuara, kohëzgjatjen dhe nevojën për shqyrtim të rregullt të vendimit për izolim, ekzistimi i kontakteve të mirëfillta njerëzore, nevojën që personeli të jetë në mënyrë të veçantë vigjilentë.

Çdo rast i përdorimit të kufizimit fizik të pacientit (kontrolli manual, përdorimi i instrumenteve të kufizimit fizik, izolimi) duhet të regjistrohet në regjistër specifik të krijuar për këtë qëllim (po ashtu edhe në dosjen e pacientit). Të dhënat duhet të përmbajnë kohën kur masa ka filluar dhe ka mbaruar, rrethanat e rastit, arsyet e zbatimit të kësaj mase, emrin e mjekut i cili e aprovoi masën e tillë dhe të dhënat për çfarëdo lëndimi të shkaktuar ndaj pacientit apo ndaj personelit. MKPT-ja ka vërejtur se reparti nuk ka regjistër të veçantë për personat të cilët vendosen në izolim. Prandaj MKPT-ja konstaton se ende nuk u zbatua rekomandimi për të krijuar një regjistër të tillë, i cili iu dërgua autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime i publikuar më 26 tetor 2018.²²⁶

Personeli

MKPT-ja ka vërejtur se sa i përket personelit, UKIP-i, para paraqitjes së COVID-19, kishte 15 infermierë dhe kryeinfermierin. Por me paraqitjen e pandemisë COVID-19, personeli u detyrua të transferohej në repartet ku trajtohen pacientët me COVID-19, gjë që përbën sfidë serioze për këtë repart pasi aktualisht vetëm 3 infermierë janë në një ndërrim.

MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që për aq sa një gjë e tillë është e mundur, infermierët e trajnuar për kategorinë e personave me sëmundje mendore të mos i transferojnë në reparte të tjera, por të jenë në dispozicion të pacientëve në UKIP. Problem për këtë repart paraqet edhe mungesa e punëtorit social. MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime i publikuar më 26 tetor 2018, adresoi çështjen e mungesës së punëtorit social dhe u rekomandoi autoriteteve kompetente që të shtohet numri i personelit, sipas vlerësimit të nevojave,

²²⁶ Po aty.

megjithatë ky rekomandim ende nuk është zbatuar. MKPT-ja gjatë vizitave ka marrë ankesa nga personeli lidhur me kushtet e punës dhe rrezikshmërinë me të cilën përballen në punën e tyre të përditshme.

MKPT-ja konsideron se nuk janë plotësuar të gjitha nevojat e ekipit dhe të punës shumëdisciplinore. Po ashtu, MKPT-ja konsideron se është shumë i rëndësishëm ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për menaxhimin e rasteve me sëmundje kronike psikiatrike.

Sigurimi në repart ofrohet nga sigurimi privat, i cili përbëhet prej dy personave. Edhe pse intervenimi në raste të incidenteve nuk është mandat i sigurimit, janë ftuar disa herë nga stafi mjekësor për të intervenuar. MKPT-ja konsideron se është e rëndësishme qenësore që personeli i cili caktohet në detyra të ndërlidhura me sigurinë në një institucion psikiatrik, të përzgjidhet në mënyrë të kujdesshme dhe t'u nënshtrohen trajnimeve adekuate para se t'i marrin përsipër detyrat e tyre. Po ashtu, ata gjatë kryerjes së detyrave duhet të mbikëqyren për së afërmi dhe t'i binden autoritetit të personelit të kualifikuar mjekësor.

Trajtimi dhe aktivitetet në repartin UKIP

Gjatë vizitave në këtë repart, MKPT-ja ka vërejtur se trajtimi psiko-farmakologjik është trajtimi kryesor i cili u ofrohet pacientëve. Furnizimi me barna tash për tash është në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se aktivitetet psiko-sociale nuk janë të mjaftueshme. Po ashtu, mungon ekipi shumë disiplinor, si: psikologu, punëtori social, terapisti okupacional dhe mungon plani individual i trajtimit. MKPT-ja konsideron se autoritetet dhe institucionet duhet të sigurojnë llojshmërinë e nevojshme të profesionistëve psiko-socialë si parakusht për një trajtim adekuat të pacientëve.

MKPT-ja u njoftua se pacientët në përgjithësi sillen këtu nga familjarët ose nga policia dhe janë pacientë të cilët akomodohen pa vullnetin e tyre. Ka edhe raste kur sillen pacientë me vendim të gjykatës. Sipas drejtorisë, pas pranimit të pacientit, të nesërmen bëhet vlerësimi i gjendjes së tij/saj shëndetësore nga komisioni përkatës mjekësor.

Nenet 22 dhe 23 të Ligjit për Shëndetin Mendor e rregullojnë çështjen e pranimit të pavullnetshëm pa vendim të gjykatës, e që obligojnë institucionin shëndetësor që ta njoftojnë gjykatën kompetente.

MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, por edhe gjatë vizitave të mëparshme, ka vërejtur se ky kriter ligjor nuk po zbatohet, pra nuk njoftohet gjykata kompetente ashtu siç përcakton ligji. Për më shumë, ky moszbatim i ligjit vazhdon për vite me radhë dhe, përveç MKPT-së, këtë gjendje me shqetësim e konstatoi edhe KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2007, 2010 dhe në Raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015.²²⁷ Në të

²²⁷Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2007, paragrafi 131, publikuar në vitin 2009. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2007, paragrafi 131, publikuar në vitin 2009. Shih në: <https://rm.coe.int/168069727c>. Komiteti Evropian për

gjitha këto raporte, ky komitet kishte shprehur shqetësimin serioz për shkak të moszbatimit të ligjit relevant për këtë çështje.

Lidhur me këtë çështje, MKPT-ja sërish më 2 dhjetor 2020 i ka drejtuar kërkesë për informata shtesë Zyrës Ligjore të MSh-së, nëse kjo gjendje është mënjeluar dhe nëse kjo ministri ka ndër marrë ndonjë veprim për të miratuar akte nënligjore të lartpërmendura.

Regjimi në repart

Pacientët në repart gjatë ditës i nënshtrohen një rutine ditore, e cila konsiston në aktivitetet, siç janë: ajrosja (dy orë në ditë, por pacientët mund të qëndrojnë më gjatë), shikimi i TV-së, ushqimi, dalja në kopsht.

Kontakti me botën e jashtme

Për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19 dhe bazuar në vendimet e autoriteteve të cilat parashohin masa për parandalim të COVID-19, vizitat e familjarëve janë pezulluar, përveç ndonjë rasti shumë specifik, të cilët e kanë realizua vizitën 5 minuta në distancë, por kjo ka ndodhur shumë rrallë. Gjatë pandemisë është rritur numri i telefonatave. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës lidhur me trajtimin e pavullnetshëm theksojnë se kontakti i pacientit me botën e jashtme është esencial jo vetëm në kuptim të parandalimit të keqtrajtimit, por edhe nga pikëpamja terapeutike.

Pacientët duhet ta kenë mundësinë të dërgojnë dhe të pranojnë korrespondencë, të kenë qasje në telefon dhe të pranojnë vizita nga familja dhe miqtë e tyre. Drejtori i klinikës duhet t'i kufizojë daljen dhe aktivitetet e tjera psiko-sociale, në pajtim me gjendjen me COVID-19 dhe me rekomandimet e organeve kompetente. Ky kufizim nuk duhet të jetë parim në asnjë mënyrë dhe duhet t'i nënshtrohet rishqyrtimit të kohëpaskohshëm.

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP) funksionon në kuadër të ShSKUK-së dhe ofron shërbime 24 orë në ditë. QIRSKP-ja është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë qendër janë kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, si schizofrenia. Kapaciteti zyrtar për akomodim në këtë institucion është 60 rezidentë, ndërsa në kohën e vizitës nga MKPT-ja, aty ishin të akomoduar 62 rezidentë.

Sa i përket kushteve të akomodimit, MKPT-ja ka vërejtur se në QIRSKP janë rinovuar Reparti A, ku akomodohen femrat, qëndrimi ditor dhe ambulanca. Në përgjithësi, MKPT-ja konsideron se kushtet e akomodimit në këtë institucion tani janë të një standardi të lartë.

Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2010, paragrafi 88, publikuar në vitin 2011. Shih në: <https://rm.coe.int/16806972c7>. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, paragrafi 111, publikuar në vitin 2016. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

Në muajt e parë të pandemisë, bazuar në vendimet e organeve kompetente, ky institucion mori vendim t'i ndalonte vizitat jashtë institucionit (në shtëpitë e familjeve të rezidentëve), ndërsa u lejuan vizitat e familjarëve në këtë institucion, duke respektuar masat mbrojtëse të parapara me vendimet e organeve kompetente.

Sa i përket personelit, nuk kishte reduktime të personelit gjatë periudhës për të cilën po raportohet. Numri i personelit në dispozicion është i kënaqshëm për t'u përballur me punët e përditshme, por ka nevojë për: terapist okupacional, shofer për autoambulancë, punëtor të mirëmbajtjes së jashtme, si dhe kuzhinier.

Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga drejtori se 10 rezidentë janë rehabilituar dhe me një përkrahje nga familja mund të integrohen në familje dhe në komunitet. Bazuar në pohimet e drejtorit, janë parashtruar kërkesa në qendrat e shëndetit mendor në nivel komunal që këta rezidentë të vazhdojnë trajtimin e mëtejshëm në këto qendra dhe po ashtu të vazhdojnë jetën në familjet e tyre. Gjashtë nga këta rezidentë u transferuan për qëndrim të mëtejshëm në familjet e tyre, pasi gjendja e tyre shëndetësore u përmirësua. Problem përbën mosgatishmëria e familjeve për t'i marrë rezidentët për të cilët konsiderohet se u është përmirësuar gjendja shëndetësore.

Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se nuk u zbatua ende rekomandimi i MKPT-së që të ndërtohet njësi rehabilituese-vokacionale, e cila është shumë e rëndësishme në kuptim terapeutik dhe për rehabilitimin e rezidentëve. Edhe përmes këtij raporti, MKPT-ja sërish kërkon nga autoritetet kompetente të ndërmarrin masat e nevojshme për ta krijuar këtë njësi.

Sa u përket aktiviteteve psiko-sociale, MKPT-ja vërejti se para pandemisë janë realizuar vizita jashtë institucionit, respektivisht dalje në qytet, dy herë brenda javës, në grupe me nga 2-3 pacientë. Gjatë pandemisë janë kufizuar daljet jashtë objektit, në pajtim me masat e IKShPK-së dhe të MSh-së.

Më 15 shtator 2020, IAP-ja, përmes postës elektronike, kërkoi informata nga MSh-ja lidhur me statusin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dërguara nga MKPT-ja. Më 9 dhjetor 2020, MKPT-ja mori përgjigje në të cilën, lidhur me Ligjin për Shëndetin Mendor, theksohet se është krijuar Grupi punues për hartimin e koncept-dokumentit për Ligjin për Shëndetin Mendor.

Shtëpitë Integruese në Bashkësi

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të pandemisë COVID-19, MKPT-ja nuk ka arritur t'i vizitonte këto institucione, bazuar në parimin e mosshkaktimit të dëmit më të madh dhe duke u bazuar në faktin se rezidentët janë në moshë e cila kategorizohet si e cenueshme. Megjithatë, MKPT-ja përmes shkresave zyrtare ka kërkuar informata për gjendjen nga secila ShIB. Bazuar në informatat e dërguara nga Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB) në Prizren, në Ferizaj, në Mitrovicë, në Gjilan dhe në Pejë, këto institucione kanë kapacitete për 10 persona dhe aktualisht ky numër është i plotësuar. Megjithatë,

pavarësisht obligimit ligjor dhe kushtetues për t'u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit, MKPT-ja nuk mori raport nga nga ShIB-të në Bresje dhe në Drenas.

Sipas raporteve të dërguara, në këto institucione nuk kishte rezidentë të infektuar me COVID-19 dhe nuk u raportua mungesë e personelit të nevojshëm. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ShIB-të kanë respektuar rekomandimet e Komitetit të ShSKUK-së për menaxhim të situatës me COVID-19, sipas të cilave, në disa faza u kufizuan të drejta të caktuara, siç janë: vizitat familjare, shëtitjet dhe aktivitetet e tjera jashtë objektit.

Bazuar në raportet e dërguara, në ShIB nuk janë raportuar incidente, qofshin sulme ndaj stafit apo incidente ndërmjet rezidentëve.

Sa i përket furnizimeve në ShIB, institucionet e lartpërmendura raportuan furnizime të kënaqshme me ushqime dhe nuk raportuan probleme me ngrohje dhe as me veshmbathje. Po ashtu nuk u raportuan probleme sa i përket furnizimit me materiale mbrojtëse gjatë pandemisë dhe as për mungesë të barërave bazike psikiatrike, përveç barnave të tjera të cilat nuk janë në kontratën për furnizimin, të cilat u siguruan përmes linjave të tjera buxhetore.

Instituti Special në Shtime

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja e ka vizituar Institutin Special në Shtime (tanin e tutje: ISSh), më 24 janar 2020, ndërsa më 14 dhjetor 2020 ka kërkuar raport për gjendjen e përgjithshme si dhe për aspekte të ndryshme, të cilat ndërlidhen me trajtimin e rezidentëve, kujdesin shëndetësor, sfidat me të cilat u përball dhe përballët institucioni, si pasojë e COVID-19, aktivitetet psiko-sociale, vizitat familjare dhe ato jashtë institucionit etj.

Sa i përket pandemisë COVID-19, ISSh-ja raportoi se u nxorën vendime dhe rregullore për menaxhimin e pandemisë në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së dhe me vendimet e tjera të organeve kompetente për luftimin e pandemisë COVID-19. Po ashtu, në pajtim me këto vendime dhe rekomandime u ndaluan vizitat dhe u krijua shtabi emergjent brenda institucionit dhe reparti COVID-19 me 8 shtretër, me banjë të veçantë dhe hapësirë për qëndrim të veçantë.

Sipas raportit në fjalë, në këtë institucion, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, u infektuan me COVID-19 10 rezidentë, ndërsa 2 janë ende pozitivë. Të gjithë rezidentët janë testuar dhe testimi vazhdon të bëhet në rast të ndonjë dyshimi. Sa i përket furnizimit me materiale mbrojtëse kundër COVID-19, ISSh-ja raportoi se kishte furnizim të mirë me materiale mbrojtëse dhe barna dhe nuk ka pasur probleme në këtë drejtim. Po ashtu, ISSh-ja raportoi se ka pasur furnizim të mirë me ushqime, me veshmbathje dhe me ngrohje 24 orë në ditë.

Më tej institucioni raportoi se gjatë periudhës për të cilën po raportohet kanë ndodhur 18 raste të vetëlëndimeve, nuk kishte raste të vetëvrasjeve dhe as të sulmeve fizike. Sa u përket aktiviteteve psiko-sociale, ISSh-ja raportoi se aktivitetet e brendshme realizohen, ndërsa vizitat jashtë institucionit janë pezulluar.

Shtëpitë me Bazë në Komunitet

Për shkak të pandemisë COVID-19, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja nuk ka realizuar vizita në këto shtëpi, përveç në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në Shtime. Kushtet e akomodimit në këtë institucion janë shumë të mira.

Megjithatë, MKPT-ja ka kërkuar nga udhëheqësit e Shtëpive me Bazë në Komunitet (ShBK) në Kamenicë, në Deçan, në Ferizaj, në Vushtrri, në Lipjan, në Graçanicë, që t'i dërgonin raportet e tyre lidhur me gjendjen në këto shtëpi, në veçanti informata lidhur me kapacitetin dhe numrin e rezidentëve, furnizimet me barna, aktivitetet psiko-sociale, kushtet e akomodimit, kontrole sistematike mjekësore, incidentet eventuale ndërmjet rezidentëve etj. Deri më tani MKPT-ja ka pranuar raporte nga ShBK-të në Ferizaj, në Deçan dhe në Kamenicë, ndërsa nga ShBK-të në Lipjan dhe në Vushtrri nuk ka marrë përgjigje.

Për shkak të pandemisë COVID-19, udhëheqësit e ShBK-ve vendosën që rezidentët të mos dalin jashtë institucionit gjatë gjithë kohës. Sa u përket vizitave familjare, ato u rralluan dhe në përgjithësi u realizuan nga distanca. Gjatë kësaj periudhe u realizuan vetëm vizitat e domosdoshme mjekësore. MKPT-ja konsideron se udhëheqësit duhet t'i kufizojnë daljen dhe aktivitetet e tjera psiko-sociale, në pajtim me gjendjen me COVID-19 dhe rekomandimet e organeve kompetente. Ky kufizim nuk duhet të jetë parim në asnjë mënyrë dhe duhet t'i nënshtrohet rishqyrtimit të kohëpaskohshëm.

Bazuar në informatat e pranuar, MKPT-ja vëren se gjatë periudhës për të cilën po raportohet, këto institucione nuk raportuan raste të të infektuarve me COVID-19.

Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore - Shtime

Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe është i vetmi institucion i tipit të hapur, i cili akomodon fëmijët me aftësi të kufizuara mendore dhe ofron shërbime 24 orë. MKPT-ja ka vërejtur se moshë e të gjithë rezidentëve është mbi 18 vjet, përveç një rasti që është 16 vjeç.

MKPT-ja, gjatë vizitës në këtë institucion gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka vërejtur se rezidentët në këtë institucion trajtohen në mënyrë humane dhe nuk ka vërejtur asnjë indikacion të keqtrajtimit fizik apo psikik të rezidentëve të akomoduar në këtë institucion.

Sa i përket kontakteve me familje dhe vizitave familjare, për shkak të pandemisë COVID-19, ato u ndaluan, përveç një rasti specifik, të cilit iu ka mundur vizita jashtë institucionit. Për siguri më të madhe të rezidentëve për shkak të pandemisë, u mundësohen kontaktet me familjet përmes telefonit. Gjatë kohës së vizitës, MKPT-ja u njoftua se nuk ka të infektuar me COVID-19 as nga personeli dhe as nga rezidentët dhe se nga komuna janë furnizuar me material mbrojtës për situatën e pandemisë.

Shtëpitë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare

Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF) në Prishtinë është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të MPMS-së. Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është 100 persona. MKPT-ja u njoftua nga menaxheri i këtij institucioni se aktualisht në këtë institucion janë të vendosur 67 rezidentë, 38 femra dhe 29 meshkuj.

Sa i përket personelit, aktualisht janë të angazhuar 53 të punësuar, ndërsa 11 punëtorë janë të angazhuar në punë përmes Zyrës për punësim në kohë pandemie. Institucioni kishte të infektuar me COVID-19, por pas shërimit ata u kthyen në punë. Po ashtu, 4 punëtore janë të angazhuara nga një kompani e pastrimit. Përmes këtij raporti, udhëheqësja konsideroi se personeli aktual është i mjaftueshëm në raport me rezidentë.

Për shkak të pandemisë dhe bazuar në vendimet e organeve kompetente, institucioni nxori disa rekomandime në formë të shkruar me qëllim të respektimit të të gjitha rekomandimeve të IKShPK-së, të OBSH-së, të MSH-së dhe të vendimeve të qeverisë për mbrojtje nga COVID-19.

Vizita në Shtëpinë për Personat e Moshuar në Gurrakoc

Vizita në Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje, e cila gjendet në Gurrakoc, u realizua më 27 shkurt 2020. Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i trajtimit të rezidentëve, kushtet e akomodimit, aktivitetet psiko-sociale në dispozicion etj. MKPT-ja u njoftua se kapaciteti zyrtar i shtëpisë është për 20 persona, ndërsa aktualisht ishin gjithsej 18 të moshuar (10 femra, 8 meshkuj).

Sa i përket infrastrukturës dhe kushteve të akomodimit, MKPT-ja ka vërejtur se në dhoma janë të akomoduar nga dy të moshuar, dhomat ku akomodohen rezidentët janë të mëdha, me ndriçim të mjaftueshëm natyral, të pajisura me shtretër të mirë, me mbulesa dhe dollapë personale. Dhomat e ditës kanë nga një tavolinë ku të moshuarit ushqehen, si dhe një aparat televiziv. MKPT-ja ka vërejtur se ashensori është funksional, gjë që lehtëson dukshëm lëvizjen e personave të moshuar. Banjat dhe tualetet ishin të ndara për të dy gjinitë dhe të pastra.

Kujdesi mjekësor ofrohet nga mjeku i përgjithshëm, i cili i viziton dy herë në javë. Vizitat tek internisti apo tek ndonjë specialist tjetër me udhëzim të mjekut të përgjithshëm i realizojnë në qendrën e mjekësisë familjare apo në spitalin regjional. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur mungesë të një psikologu dhe të një salle për shërbime të fizioterapisë. Në dispozicion të institucionit dhe të të moshuarve është edhe një autoambulancë, e cila lehtëson shumë punën e personelit mjekësor.

Sa u përket aktiviteteve psiko-sociale, MKPT-ja ka vërejtur se për rezidentët organizohen shëtitje 5 herë në vit jashtë Gurrakocit. Përveç lojës me letra, nuk ka aktivitete të tjera për rezidentët. Gjatë kohës së pandemisë aktivitetet jashtë shtëpisë janë pezulluar.

Vizita në Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Skenderaj

MKPT-ja, më 11 shkurt 2020, vizitoi këtë shtëpi para fillimit të pandemisë. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në këtë shtëpi ishin të vendosur 16 persona, ndërsa kapaciteti zyrtar është për 20 persona. Rezidentët ndahen në tri kategori: të moshuar të varur nga asistenca; gjysmë të varur; dhe të pavarur. Qendra ka karakter regjional dhe akomodon rezidentë nga Skenderaj, nga Drenasi, nga Vushtrria dhe nga Mitrovica.

Sa i përket infrastrukturës, MKPT-ja ka vërejtur se në dhoma qëndrojnë nga dy persona, por kishte edhe dhoma, sidomos kategoria e varur, ku qëndronin nga tre apo katër, kryesisht dhomat ishin të mëdha dhe me ndriçim të mjaftueshëm natyral, shtretër të mirë, mbulesa dhe dollapë personale.

MKPT-ja ka vërejtur se në dhomën e qëndrimit ditor kishte televizor, shah dhe në dispozicion të rezidentëve ishte edhe serra, ku të moshuarit angazhohen në aktivitete pune. Institucioni ka autoambulancën për shërbime mjekësore dhe minibusin për organizimin e shëtitjeve. Gjithashtu vlen të përmendet edhe funksionimi i ashensorit, i cila kishte ndikim pozitiv, sepse rezidentët ndiheshin të lirë dhe të sigurt për dalje jashtë objektit.

Banjat dhe tualetet janë të përbashkëta, pastërtia ishte në nivel, nuk kishte probleme me ujë të ngrohtë dhe as me rrymë. Po ashtu u vërejt furnizim i mirë me materiale higjienike.

Sa i përket kujdesit shëndetësor dhe furnizimit me barna, nuk u vërejtën probleme. Në kuadër të institucionit ishte dhoma e mjekut dhe barnatorja, por aty nuk ka mjek. Shërbimet mjekësore i marrin në qendrën e mjekësisë familjare. Po ashtu u vërejt mungesa e mjekut dhe e fizioterapeutit. Sipas udhëheqësit të shtëpisë, janë ndarë mjetet për ta ndërtuar sallën e fizioterapisë.

Udhëheqësi i institucionit theksoi se çështjen e psikologut e kanë diskutuar me Qendrën për Punë Sociale, ku kanë kërkuar që psikologu i QPS-së të angazhohet dy herë në javë në shtëpinë për të moshuar.

VI. Bashkëpunimi ndërkombëtar

VI. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ), siç është edhe Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, me mekanizma ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, është kërkesë thelbësore e Parimeve të Parisit²²⁸, sepse ato përveçse mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe mirëqeverisjen në nivel vendor, ato shërbejnë edhe si urë lidhëse në mbikëqyrjen e zbatimit efektiv të obligimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që burojnë nga mekanizmat dhe dokumentet ndërkombëtare, që janë pjesë e sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Për shkak të rëndësisë që kanë këto institucione në nivel ndërkombëtar, Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e Kombeve të Bashkuara²²⁹ ka përfshirë, përmes objektives 16.A.1: *“Ekzistencën e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut të pavarura në pajtueshmëri me Parimet e Parisit.”*²³⁰ Kjo për faktin se, siç e thotë edhe Deklarata e Meridës²³¹: *“Këto institucione do të ofrojnë një kornizë të rëndësishme për implementimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, sikurse implementimi këtyre objektivave që do të kontribuojë në realizimin e të drejtave të njeriut.”*

Në vitin e kaluar, Komisioni i Venedikut miratoi *“Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucioneve të Ombudsmanëve”*, të referuara si *“Parimet e Venedikut”*²³², të cilat përfaqësojnë një përmbledhje të standardeve të njohura ndërkombëtare për Institucionet e Ombudsmanëve dhe janë ekuivalente me Parimet e Parisit. Kurse në këtë vit, me qëllim të forcimit të pozitës së institucioneve të Ombudsmanëve në nivel botëror për ushtrimin e mandatit të tyre të pavarur, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 16 dhjetor 2020, miratoi rezolutën për *“Rolin e institucioneve të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit”*²³³, hap ky shumë i rëndësishëm, që përbën krijimin e një standardi global për këto institucione.

²²⁸ Parimet e Parisit janë kriteret minimale që duhet të ketë një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut që të konsiderohet i besueshëm, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare.

²²⁹ Agjenda 2030 përfshin 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Ato janë thirrje urgjente për veprim për të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim për një partneritet global në zbatimin e tyre. Objektivat kanë synimin kryesor për t'i dhënë fund varfërisë dhe privimeve të tjera, përmes zhvillimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve strategjike që përmirësojnë shëndetin, arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, ka miratuar rezolutën për OZHQ.

²³⁰ Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, objektivi 16, i qasshëm në:

https://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/SDG_Indicator_16a1_Metadata.pdf

²³¹ Deklarata e Meridës lidhur me Rolin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, neni 12, e qasshme në:

<https://nhri.ohchr.org/EN/ICC/InternationalConference/12IC/Background%20Information/Merida%20Declaratio n%20FINAL.pdf>

²³² 25 Parimet e Venedikut për Institucionet e Ombudsmanëve, Komisioni i Venedikut,

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e)

²³³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta lidhur me rolin e institucioneve të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, 16 dhjetor 2020, e qasshme në: <https://undocs.org/en/A/RES/75/186>

Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës (IAP) së Kosovës, si institucion i pavarur kushtetues për të drejtat e njeriut, vazhdon të jetë i përkushtuar në realizimin e plotë të obligimeve ndërkombëtare dhe të mbajtjes së bashkëpunimit të mirë me institucione të ndryshme ndërkombëtare, në kuadër të të cilit edhe në këtë vit, pavarësisht problemeve të shkaktuara nga kriza me pandeminë globale COVID- 19, ka marrë pjesë në një numër të madh të takimeve ndërkombëtare, të renditura në listën më poshtë:

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Data
1.	Seminari ndërkombëtar për shënimin e 20-vjetorit të themelimit të Ombudsmanit të Tajlandës. Bangkok, Tajlandë.	10-15 shkurt 2020
2.	Vizitë për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave në kuadër të Projektit të ENNHRI-së “Roli i IKDNJ në situatat në konflikt dhe post konfliktit”. Belfast, Irlandë e Veriut.	18-20 shkurt 2020
	Takime të mbajtura përmes internetit	↓
3.	Trajnimi: “ <i>Hyrje në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut</i> ”.	13 prill 2020
4.	Uebinar lidhur me Veprimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë situatës me COVID.	27 maj 2020
5.	Takim lidhur me COVID-19 dhe të drejtat e njeriut në vendet e post-konfliktit.	29 maj 2020
6.	Takim rajonal lidhur me ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut.	11 qershor 2020
7.	Video-konferencë lidhur me procedurat në gjykatë dhe standardet për të drejtat e njeriut.	18 qershor 2020
8.	Takimi i TAIEX-it lidhur me praktikat e mira në parandalimin e dhunës në familje në kontekst të COVID-19.	24-25 qershor 2020
9.	Takimi vjetor i Komisionit të Këshillit të Evropës kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI) me organet e barazisë.	28-30 shtator 2020

10.	Akademia e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut.	29 shtator- 29 tetor 2020
11.	Uebinari: “ <i>Si t’i bëjmë Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut të forta dhe efektive?</i> ”	8 shtator 2020
12.	Sesione trajnimi online: Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.	9-18 shtator 2020
13.	Uebinar: “ <i>Si të komunikojmë për të drejtat e njeriut gjatë pandemisë COVID-19?</i> ”	27 shtator 2020
14.	Seminari: “ <i>Margjinalizimi shoqëror i programit të dhunës ndaj grave në situata të izolimit të detyruar, rrethanave emergjente dhe masave kufizuese.</i> ”	5 tetor 2020
15.	Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të EQUINET-it.	16 tetor 2020
16.	Forumi i shtatë regional lidhur me sundimin e ligjit.	16-17 tetor 2020
17.	Programi veror i Akademisë për Profesionistët e Rinj, me temën: “ <i>Menaxhimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Publik</i> ” (virtual).	19-23 tetor 2020
18.	Konferenca e 12 Ndërkombëtare e Institucioneve të Ombudsve për Forcat e Armatosura, me temën: “ <i>Impakti i COVID-19 në Institucione të Ombudsmanëve për Forcat e Armatosura</i> ”.	26-30 tetor 2020
19.	Uebinar të Lidërshpit të ENNHRI-së.	9-10 nëntor 2020
20.	Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të ENNHRI-së	16 nëntor 2020
21.	Sesioni trajnues lidhur me bashkëqeverisjen dhe inovacionin social për qëndrueshmëri.	19 nëntor 2020
22.	Takimi lidhur me COVID-19 dhe Ombudspersonin - ngritja ndaj sfidës së një pandemie.	24 nëntor 2020
23.	Konferenca Rajonale: “ <i>Qasja në drejtësi për gratë viktime dhe të mbijetuara të dhunës në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi në kohën e COVID-19</i> ”.	26-27 nëntor 2020

24.	Uebinar lidhur me ndërveprimin me mekanizma të Kombeve të Bashkuara: Rishikimi Periodik Universal.	1 dhjetor 2020
25.	Konferenca vjetore e ENNHRI-së	2 dhjetor 2020
26.	Uebinari: “Të drejtat e njeriut të detyrueshme për kujdesin e duhur”.	2 dhjetor 2020
27.	Shkëmbim i njohurive dhe praktikave të mira: “Zbatimi i mandatit dhe funksioneve të IKDNJ-së në kontekst të COVID-19”.	3 dhjetor 2020
28.	Konferenca vjetore e GANHRI-së, me temën: “Ndryshimi i klimës: Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut”.	4 dhjetor 2020
29.	Uebinari: “Një traktat për biznesin dhe të drejtat e njeriut”.	9 dhjetor 2020

Tabela: Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Bashkëpunimi me homolog dhe me organizata të tjera ndërkombëtare

IAP-ja i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me homologë dhe me organizata e rrjete të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, rrjedhimisht është i përkushtuar që të përfshihet në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kanë për qëllim shkëmbimin e informatave e praktikave të mira në fushën e të drejtave të njeriut dhe ngritjen e kapaciteteve. Edhe në këtë vit, pavarësisht krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, IAP-ja ka marrë pjesë në disa aktivitete ndërkombëtare, shumica prej të cilave janë realizuar online, kurse më poshtë do t’i përmendim disa më të rëndësishmet.

Duke qenë anëtare e Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), IAP-ja ka rastin që të takohet edhe me homologë të tjerë jo vetëm të kontinentit evropian, por edhe nga mbarë bota. Si rrjedhojë, në këtë vit, Avokati i Popullit ka pranuar ftesë nga Ombudsmeni i Tajlandës për pjesëmarrje si panelist në seminarin ndërkombëtar të organizuar me rastin e 20-vjetorit të themelimit të këtij institucioni, mbajtur në datat 10-15 shkurt 2020. Temë qendrore e këtij seminary ishte “E ardhmja e institucionit të Ombudsmanit në një botë në ndryshim: Teknikat e adaptimit dhe bashkëpunimit”. Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, në fjalën e tij, shpërfaqti rolin e institucionit të Ombudsmanit në disa aspekte të të drejtave të njeriut, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe tematika aktuale në botën që po jetojmë, si: roli i IKDNJ-së në iniciativat për plotësimin e standardëve të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, krijimin e indikatorëve për të drejtat e njeriut, pastaj roli i tyre në relacion me arritjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inteligjencën Artificiale. Ai në fund të fjalës së tij tha: “Jam shumë i bindur se zhvillimet aktuale globale do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë

në të ardhmen e të drejtave të njeriut; një epokë e re në shkallë globale tashmë ka filluar. Ombudsmanët në të gjithë botën duhet ta pranojnë këtë dhe ta shfrytëzojnë mundësinë për të adresuar dhe kontribuar në nxitjen e perspektivës së të drejtave të njeriut në përputhje me zhvillimet globale. Kjo mundësi në të njëjtën kohë paraqet edhe sfidë për të gjithë ne në shtetet tona, prandaj duhet të punojmë së bashku që të bëjmë të mundur të dëgjohet zëri ynë lidhur me zhvillimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.”

Në fillim të vitit 2020, Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI), në kuadër të projektit “*Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në situatat në konflikt dhe pas konfliktit*”, ia mundësoi një përfaqësuesi të IAP-së pjesëmarrjen në një vizitë studimore në Irlandën Veriore, me nikoqir Komisionin për të Drejtat e Njeriut. Kjo vizitë kishte për qëllim marrjen e praktikave të mira, me fokus në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave kulturore, e po ashtu drejtësinë tranzitore. Gjatë vizitës u realizuan takime me institucionet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut në Irlandën e Veriut dhe vizita u cilësua si shumë e suksesshme nga të dyja palët.²³⁴

ENNHRI-ja, anëtare e së cilit është edhe IAP-ja, ishte shumë aktiv gjatë kohës së pandemisë, duke marrë përsipër ndërmarrjen e një sërë aktiviteteve informuese e koordinuese, që ndërlidhen me të drejtat e njeriut, por gjithashtu edhe me përballimin me situatën e krijuar pas COVID-19. Një nga to ishte edhe Raporti për Gjendjen e Sundimit të Ligjit në Evropë,²³⁵ i cili paraqet perspektivën e të gjitha institucioneve anëtare të këtij rrjeti për gjendjen e sundimit të ligjit në shtetet e tyre, bazuar në monitorimin dhe në mbledhjen e të dhënave gjatë periudhës prill – qershor 2020, duke përfshirë edhe pjesën për Kosovën, sipas raportit të dërguar nga Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës (IAP). Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ), siç është edhe IAP-ja, janë aktorë kryesorë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit, dhe si organe me mandat shtetëror, të cilat veprojnë në mënyrë të pavarur nga qeveria me një mandat të gjerë për të drejtat e njeriut. Ky raport identifikon tendencat kryesore në këtë aspekt në të gjithë rajonin dhe detajon situatën specifike në secilin shtet, përfshirë në kontekstin e reagimit të qeverive pas përhapjes së pandemisë së virusit COVID-19.²³⁶

Siç është përmendur edhe në raportet e kaluara, ENNHRI-ja, në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR), në baza vjetore organizon edhe Akademinë e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, e cila në këtë vit, për shkak të gjendjes me pandeminë, u mbajt përmes internetit, prej datës 29 shtator – deri më 29 tetor 2020. Në këtë vit fokusi i saj ishte përdorimi i mandatit promovues të IKDNJ-

²³⁴ Për më tepër rreth kësaj vizite, në: <http://ennhri.org/news-and-blog/european-nhris-take-part-in-ennhri-first-peer-exchange-visits-focusing-on-their-role-in-post-conflict-situations/>

²³⁵ <http://ennhri.org/wp-content/uploads/2020/06/ENNHRI-State-of-the-Rule-of-Law-in-Europe-June-2020.pdf>

²³⁶ ENNHRI-ja publikon raportin lidhur me gjendjen e sundimit të ligjit në Evropë, 30 qershor 2020, <https://www.oik-rks.org/2020/06/29/publikohet-raporti-i-iap-se-ne-ennhri/>

së gjatë kornizimit të migracionit nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe në të mori pjesë edhe një përfaqësues i IAP-së.²³⁷

Më 9 dhe më 10 nëntor, ENNHRI-ja mbajti dy seminare online, të cilat ishin të përqendruara në mundësitë e IKDNJ-së për ngritjen e respektimit të të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë përmes instrumenteve të reja të politikës së Bashkimit Evropian (BE). Përfaqësuesit e IKDNJ-së dhe të BE-së shkëmbyen informata se si angazhimi strategjik i IKDNJ-së në nivelin regional mund të shkaktojë ndryshime në nivelin vendor.²³⁸ Menjëherë pas përfundimit të këtyre seminareve, IAP-ja, sipas kërkesës së ENNHRI-së, përmes një raporti dha kontributin e tij lidhur me praktikën e mira të ndërveprimit të Bashkimit Evropian me IKDNJ, në të cilin shpërfaqti të gjitha mjetet dhe metodat e përdorura në kuadër të procesit të integrimi evropian për Republikën e Kosovës, me qëllim të forcimit të IAP-së dhe ndikimit të tij si institucioni i vetëm kombëtar për të drejtat e njeriut në Kosovë. Si rezultat, ENNHRI-ja doli me Udhëzuesin për Veprimin e Jashtëm të Bashkimit Evropian, i cili liston dhjetë arsye për angazhimin e IKDNJ-së në të drejtat e njeriut dhe demokracinë në BE.²³⁹

Gjithashtu, më 18 nëntor 2019, u mbajt edhe Asambleja e Përgjithshme e ENNHRI-së, në të cilin u diskutua për punën e këtij rrjeti gjatë vitit. Në sesionin e parë u miratua raporti i kryesueses së rrjetit, raporti i sekretariatit, raporti financiar dhe ai i akreditimit; në sesionin e dytë u votua për zgjedhjen e anëtarin evropian për përfaqësim në Grupin punues të GANHRI-së lidhur me moshën dhe zgjedhjen e anëtarit evropian për të përfaqësuar në Nën-komitetin për Akreditim të GANHRI-së; kurse në sesionin e tretë, të gjithë pjesëmarrësit u ndanë në grupe të vogla në të cilat u diskutua për Planin Strategjik të rrjetit për vitin 2021.

Më 2 dhjetor, ENNHRI-ja mbajti Konferencën Vjetore, duke mbledhur së bashku përfaqësues të IKDNJ-së, të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, për të shkëmbyer informata rreth angazhimit strategjik të IKDNJ-së për të forcuar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë. Në këtë konferencë u ripërserit fakti se IKDNJ-ja ka rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave të BE-së dhe gjithashtu ofron mundësi strategjike për të rritur mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke inkurajuar zbatimin e standardeve ndërkombëtare në nivelin kombëtar.

Siç është raportuar edhe në raportet e viteve të mëparshme, me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, IAP-ja mori mandatin si organ i barazisë, kurse në vitin 2019 u pranua edhe si anëtar i Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET).

²³⁷ Akademia e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, e qasshme në: <http://ennhri.org/our-work/nhri-academy/>

²³⁸ Për më tepër lidhur me përfundimet e këtyre seminareve shumë të suksesshme, ju lutem vizitoni këtë link: <http://ennhri.org/news-and-blog/advancing-human-rights-in-eu-internal-and-external-policy-what-opportunities-for-nhris/>

²³⁹ <http://ennhri.org/wp-content/uploads/2020/12/Guide-on-engagement-with-NHRIs-in-EU-external-action.pdf>

Në kuadër të mandatit si organ barazie, IAP-ja mori pjesë në disa ngjarje ndërkombëtare. Ndër më të rëndësishmet ishte edhe Takimi vjetor i Komisionit të Këshillit të Evropës kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI), me organet e barazisë për vitin 2020, me temën: “Bashkimi i forcave për komunikimin e mesazhit të barazisë dhe diversitetit”, i cili u mbajt më datat 28-29 shtator 2020. Qëllimi kryesor i këtij seminari ishte diskutimi lidhur me mënyrat se si institucionet e angazhuara në luftën kundër racizmit dhe intolerancës mund të komunikojnë në mënyrë më efektive dhe si ECRI, organet e barazisë dhe akterë të tjerë mund t’i bashkojnë forcat që të rrisin ndikimin e komunikimit në promovimin e barazisë dhe luftës kundër racizmit dhe intolerancës.

Më 16 tetor 2020, u mbajt edhe Asambleja e Përgjithshme e EQUINET-it, në të cilën u diskutua lidhur me punën e rrjetit gjatë vitit dhe u votua për llogaritë dhe për planin e punës për vitin e ardhshëm. Në një sesion të veçantë, pjesëmarrësit patën rastin t’i tregonin përvojat e tyre lidhur me përballjen me pandeminë si dhe aktivitetet e ndërmarra në kuadër të mandatit të tyre si organe të barazisë.

Përveç nga sa u tha më lart, IAP-ja, në korrik të këtij viti, pati raportuar në EQUINET për veprimet e institucionit të ndërmarra si përgjigje ndaj gjendjes së krijuar gjatë pandemisë COVID-19 dhe ndikimi i saj në të drejtat e njeriut. Këto të dhëna u publikuan në ueb-faqen e këtij rrjeti me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira me të gjitha vendet anëtare.²⁴⁰

Është me rëndësi të përmendet edhe pjesëmarrja në Takimin vjetor dhe Konferencën e Aleancës Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNJ-së me Parimet e Parisit), i cili në këtë vit u mbajt në mënyrë virtuale. Më datën 3 dhjetor, takimi u fokusua në shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira: Zbatimi i mandatit dhe i funksioneve të IKDNJ-së në kontekst të COVID-19, kurse më datën 4 dhjetor 2020 u mbajt konferenca e cila në këtë vit pati si temë: “Ndryshimi i klimës: Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut”. Meqë Republika e Kosovës nuk është anëtarësuar ende në Kombet e Bashkuara, IAP-ja e ka të kufizuar mundësinë për të qenë pjesë e kësaj organizate të rëndësishme ndërkombëtare, por ka vite që merr pjesë në aktivitetet dhe në takimet e saj si anëtare vëzhgues.

Në kuadër të bashkëpunimit që IAP-ja ka me Zyrën e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, më datën 4 dhjetor 2020, Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, mori një letër nga z. Jose Maria Aranz, Shef i Degës për Amerikë, Evropë dhe Azi Qendrore/Divizioni i Bashkëpunimit Teknik dhe Veprimeve në Terren, i cili përmes saj shpreh gatishmërinë e zyrës së tij që të rritë bashkëpunimin me IAP-së në çështje të interesit të përbashkët dhe të

²⁴⁰ EQUINET, Të dhënat e organeve të barazisë lidhur me COVID-19, e qasshme në: <https://equineteurope.org/COVID-19-response/#data>

reflektojë në mënyrat e mundshme të mbështetjes së institucionit në të ardhmen, gjë të cilën e mirëpriti z. Qelaj duke e falënderuar atë përmes një letre tjetër si përgjigje.

Ndërsa kur jemi tek bashkëpunimi me institucione homologe nga rajoni, përmendim një video konferencë rajonale e realizuar me iniciativën e Komisionarit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Republikës së Shqipërisë, me institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, në Shqipëri dhe në Maqedonisë së Veriut, sipas pajtimit që buron nga memorandumit i bashkëpunimit, i nënshkruar vitin e kaluar. Në këtë konferencë u diskutua lidhur me përhapjen e pandemisë COVID-19 në këto vende dhe masat e ndërmarra na shteti, por gjithashtu edhe puna e monitorimit të tyre nga këto institucione nëse ato masa janë të pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në këtë kuadër, IAP-ja, më 10 dhjetor 2020, për të shënuar Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, organizoi konferencën regjionale, me temën: “Të drejtat e njeriut në periudhën e pandemisë dhe roli i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut”, në të cilën morën pjesë autoritetet më të larta të shtetit, shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, Sekretarja e përgjithshme e Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI), Ombudsmanët nga regjioni i Ballkanit Perëndimor, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare. Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, theksoi se viti 2020 i ka gjetur vendet në mbarë botën para një sfide të madhe, para një pandemie që rrezikon jetën e njerëzve dhe shëndetin publik, gjë që ka shkaktuar pasoja në të gjitha aspektet e shoqërisë. Ai në fjalën e tij nënvizoi: *“Çka duhet të jetë në qendër të këtij diskutimi sot, është fakti i parimit të ligjshmërisë së masave kufizuese, me qëllim të shmangies së arbitraritetit, diskriminimit si dhe që të njëjtat të jenë të domosdoshme dhe proporcionale me rrezikun apo situatën e krijuar.”*

Bashkëpunimi i mirë ekziston edhe me institucione të tjera homologe në rajon dhe më gjerë, me të cilat IAP-ja është në komunikim të përhershëm për çështje të interesit të përbashkët.

Meqë IAP-ja tashmë është anëtarësuar në rrjetet dhe në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, në këtë vit është kujdesur që të ndërveprojë me to, duke mbajtur takime të përbashkëta, shkëmbim të informatave e të praktikave të mira, të cilat ndihmojnë në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Më poshtë në paraqitje tabelore është evidentuar gjendja momentale e anëtarësimeve të IAP-së në mekanizma ndërkombëtarë:

Nr.	Rrjeti/Mekanizmi	Viti i anëtarësimit
1.	Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)	2002
2.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)	2009

3.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)	2012
4.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)	2013
5.	Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF)	2015
6.	Konferenca Ndërkombëtare e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forcat e Armatosura (ICOAF)	2015
7.	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)	2016
8.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut ²⁴¹	2017
9.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)	2019

IAP-ja gjithashtu ftohet dhe merr pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe të rrjeteve të tjera, në të cilat për shkak të barrierave politike është vetëm anëtar vëzhgues, si në:

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNJ-së me Parimet e Parisit);²⁴²
- Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC);²⁴³
- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Evropës Juglindore (SEE NPM) (në kuadër të të cilit IAP-ja merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).²⁴⁴

Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë

IAP-ja çdo vit pranon pyetësorë të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe në këtë vit janë dërguar disa kërkesa për raporte dhe pyetësorë të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

Data	Tema e raportit/hulumtimit	Organizata/institucioni të cilit i është dërguar raporti
------	----------------------------	--

²⁴¹ Ky rrjet është themeluar në vitin 2017 dhe është nënshkruar nga këto shtete: Bosnja, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia.

²⁴² Kusht për anëtarësim në këtë organizatë është anëtarësimi e Kosovës në Kombet e Bashkuara.

²⁴³ Kusht për anëtarësim në këtë rrjet është anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës.

²⁴⁴ Kusht për anëtarësim në këtë rrjet rajonal është aderimi i Kosovës në Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës.

17 janar 2020	Raport lidhur me pakon e zgjerimit të Komisionit Evropian dhe për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)
24 prill 2020	Raport lidhur me punën e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës në Kosovë gjatë kohës së pandemisë COVID-19.	Forumi Evropian i Mekanizmave Kombëtar për Parandalim të Torturës
2 qershor 2020	Pyetësori lidhur me ndërveprimin me mekanizma të Kombeve të Bashkuara.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)
10 qershor 2020	Raport lidhur me sundimin e ligjit në Kosovë.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)
17 qershor 2020	Raport lidhur me përgjigjën e organeve të barazisë ndaj COVID-19	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)
19 qershor 2020	Përgjigje në pyetësorin lidhur me udhëheqjen në kohë krizash.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)
24 gusht 2020	Raporti lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.	Departamenti i shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes Ambasadës së ShBA-së në Kosovë
2 shtator 2020	Raport lidhur me përfshirjen e rinisë - komunikimi me të rinj.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)
11 shtator 2020	Përgjigje në pyetësorin lidhur me ndikimin e COVID-19 në punën e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forcat e Armatosura.	Qendra e Gjenevës për Udhëheqjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF)
18 nëntor 2020	Raport lidhur me praktikat e mira të ndërveprimit të Bashkimit Evropian me	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)

	Institucione Kombëtare për të Drejtat e Njeriut.	
4 dhjetor 2020	Përgjigje në pyetësorin lidhur me organet e barazisë në BE: statusi dhe funksionimi	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET) Agjencia për të Drejtat Themelore e Bashkimit Evropian (FRA)
7 dhjetor 2020	Raport lidhur me bazën ligjore të standardeve për fuqizimin dhe garantimin e pavarësisë së IKDNJ	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

Tabela: Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare

VII. Komunikimi me publikun dhe me mediat

VII. Komunikimi me publikun dhe me mediat

Gjatë vitit 2020, komunikimi me publikun dhe me mediat ka qenë intensiv duke shfrytëzuar të gjitha kanalet e mundshme të komunikimit në funksion të ngritjes së vetëdijes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Mediat vendore kanë mbuluar aktivitetet e IAP-së, edhe pse në një situatë më ndryshe sivjet për shkak të situatës së pandemisë COVID-19. Megjithatë IAP-ja ka punuar në rritjen e transparencës, informimin e vazhdueshëm dhe proaktiv me publikun.

Niveli i bashkëpunimit të IAP-së me media dhe me publikun është thelluar edhe më shumë duke pasur parasysh shpërndarjen e informacioneve të dobishme me kohë për publikun e gjerë. IAP-ja është angazhuar që kthimi i përgjigjeve në pyetjet e mediave të jetë në një afat sa më të shkurtër të mundshëm, në mënyrë që mediat të jenë në gjendje që të raportojnë me kohë.

Gjatë tërë këtij viti, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë marrë pjesë në intervista, në debate dhe në diskutime online të mbuluara nga mediat online, televizionet dhe radiot. Përfaqësuesit e IAP-së kanë folur për çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, siç janë: mbrojtja nga diskriminimi, barazia gjinore, të drejtat e njeriut gjatë pandemisë, dhuna në familje e tema të tjera që bien në mandatin dhe në kompetencat e Avokatit të Popullit.

IAP-ja i ka ndjekur edhe raportimet e mediave me fokus në publikimin e artikujve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kësisoj, IAP-ja ka nisur 17 raste sipas detyrës zyrtare (Ex officio) pikërisht duke u bazuar në raportimet e mediave vendore.

Rastet e hapura ex-officio nga raportimet e mediave

Raste të hapura ex-officio nga raportimet e mediave	17
Portali “Gazeta Express“	3
Portali “Kallxo.com“	3
Portali “Koha.net”	2
Portali “Drenicapress.com“	1
Televizioni T7	1
Televizioni Klan Kosova	1
Televizioni Kohavision, KTV	1

Portali “Kossev.info”	1
Portali “Insajderi”	1
Portali “Zeri.info”	1
Portali “Prishtina Insight”	1
Portali “Lajmi.net”	1

Avokati i Popullit ka informuar publikun e gjerë për opinionet e tij për të drejtat e njeriut dhe për liritë themelore dhe ka kontribuar në komunikimin intensiv në çështjet e rëndësishme për shoqërinë gjatë kohës së pandemisë edhe përmes rrjetit social Facebook. Gjatë vitit 2020, IAP-ja ka arritur t’i shtonte 1.462 ndjekës të rinj duke ngritur numrin në 5.378 ndjekës (followers) deri në mes të dhjetorit. Të gjitha ngjarjet, takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Avokati i Popullit janë prezantuar në media. Mediat kanë qenë rregullisht të interesuara në çështjet që përfshijnë të drejtat e njeriut dhe Avokati i Popullit është përgjigjur gjithmonë pozitivisht në ftesat e mediave për të shprehur pikëpamjet e tij për çështjet që ata kanë ngritur.

Në periudhën për të cilën po raportohet 1 janar – 31 dhjetor 2020, përmes ueb-faqes dhe rrjetit social Facebook janë publikuar raportet me rekomandime të Avokatit të Popullit, si dhe aktivitetet dhe angazhimet e tij. Numri i përgjithshëm i lajmeve dhe i informatave në ueb-faqe arrin në 54 sosh. Në tabelën 3 paraqiten lajmet, komunikatat dhe informatat e tjera sipas muajve.

Informata/deklarata/njoftime të publikuara në ueb-faqe, sipas muajve

2020	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
	4	1	4	3	5	9	0	2	4	10	6	6
TOTALI	54											

Gjatë vitit 2020 janë realizuar mbi 100 paraqitje publike përmes mediave (intervista, prononcime, emisione etj.) nëpër televizione, portale dhe radio stacione. Ky numër i paraqitjeve në media nuk përfshin shpërndarjen apo riprodhimin e të njëjtave nga portalet elektronike apo nga mediat e tjera elektronike a të shkruara, që i kanë huazuar materialet.

Në fund të vitit, Avokati i Popullit organizoi një konferencë të veçantë për media, ku prezantoi të dhënat preliminare të statistikave dhe punës së bërë përgjatë vitit 2020.

Zyra për Komunikim me Publikun dhe Mediat po ashtu menaxhon procesin e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike (QDP) që i drejtohen IAP-së, si dhe procedimin e përgjigjeve të institucioneve tek palët. Gjatë vitit 2020, IAP-ja ka pranuar 13 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe për të gjitha ka lejuar qasje brenda afateve ligjore. Palëve u janë dërguar dokumentet e kërkuara përmes e-mailit.

VIII. Financimi

VIII. Financimi

Buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit

IAP-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit: “*IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.*”²⁴⁵ Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm shtesë edhe për rastet e shtimit të obligimeve dhe kompetencave me këtë ligj dhe me ligjet e tjera, respektivisht edhe burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.²⁴⁶

Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës

IAP-ja, bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, ka parashtruar kërkesën e vet buxhetore për vitin 2020 në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Financave.

Kërkesa buxhetore për vitin 2020 nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur bazuar në planifikimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së për vitin kalendarik 2020. Buxheti i IAP-së për vitin 2019 është ndarë në masën monetare prej 1.373.815.00 €, i cili ka qenë i dedikuar për këto kategori buxhetore si në vijim:

- a) Paga dhe mëditje në shumë prej 977.962.00 €;
- b) Mallra dhe shërbime në shumë prej 322.353.00 €;
- c) Shpenzime komunale në shumë prej 15.000.00 €;
- d) Shpenzime kapitale në shumën prej 58.500.00 €.

Pasqyrimin e buxhetit të IAP-së për vitin 2020, sipas kërkesës buxhetore, të buxhetit sipas Ligjit të Buxhetit Fillestar për vitin 2020, sipas Ligjit për Plotësimin e Ndryshimin e Ligjit të Buxhetit për vitin 2020, të shpenzimeve buxhetore si dhe të deklaratimit të kursimeve buxhetore do t’ia paraqesim në formën tabelore bazuar në të dhënat e përgjithshme sipas kategorive ekonomike buxhetore. Kurse raportimi financiar i detajuar për vitin buxhetor 2020, për të gjitha kategoritë ekonomike buxhetore dhe për nënkategoritë e veçanta ekonomike buxhetore, do të hartohet veçmas dhe do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në raportimin e rregullt vjetor dhe të formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, ashtu siç kërkohet nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës.²⁴⁷

Më hollësisht dhe konkretisht në paraqitjen tabelore në vijim do të pasqyrohet buxheti i IAP-it për vitin 2020, duke e filluar me *Kërkesën buxhetore, me buxhetin fillestar të Ligjit për*

²⁴⁵ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, neni 35, paragrafi 3.

²⁴⁶ Po aty.

²⁴⁷ Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

Buxhetin e vitit 2020, të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit të Buxhetit për vitin 2020, sipas Deklarimit të kursimeve buxhetore nga IAP-ja, të shkurtimit të buxhetit me vendim të Qeverisë së Republikës të Kosovës dhe buxhetin final për vitin 2020.

Buxheti i IAP-së për vitin 2020, sipas të dhënave në vijim:

<i>Kategoria Ekonomike</i>	<i>Kërkesa buxhetore e IAP-së</i>	<i>Buxheti në bazë të Ligjit Nr. 07/L-001</i>	<i>Buxheti në bazë të Ligjit Nr. 07/L-014</i>	<i>Deklari mi i kursimeve nga IAP-ja</i>	<i>Transferimi brendshëm i buxhetit</i>	<i>Shkurtimet me vendim të qeverisë</i>	<i>Buxheti final 2020</i>
Paga dhe mëditje	1.079.242.00	977.962.00	977.962.00	47.000.00		12.375.75	918.586.25
Mallra dhe shërbime	329.353.00	322.353.00	222.353.00	45.000.00	9.100.00	27.303.30	140.949.70
Shpenzime komunale	15.000.00	15.000.00	8.371.79	2.200.00			6.171.79
Shpenzimet kapitale	58.500.00	58.500.00	29.250.00	0.00	9.100.00		38.350.00
Gjithsej buxheti	1.482.095.00	1.373.815.00	1.237.936.79	94.200.00	0.00	39.679.00	1.104.057.74

Planifikimi i buxhetit, shpenzimi i buxhetit dhe deklarimi i kursimeve buxhetore për vitin 2020 është realizuar sipas nevojave të planifikuara dhe të destinacionit të përcaktuar për plotësimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së, të cilat kanë qenë me interes të sigurimit të ushtrimit të mandatit, të mbarëvajtjes së punës dhe të funksionimit të IAP-së. Kurse planifikimi dhe shpenzimet e buxhetit për vitin 2020 janë ndikuar nga situata e pandemisë, sepse një pjesë e madhe të aktiviteteve të punës nuk kanë mundur të realizohen sipas planit të punës së IAP-së, me ç' rast mosrealizimi i këtyre aktiviteteve të punës ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mosshpenzimin e buxhetit të planifikuar për vitin buxhetor 2020. Nga IAP-ja nuk ka mundur monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të buxhetit.

Për vitin 2020, sipas procedurave ligjore, IAP-ja ka bërë edhe deklarimin e kursimeve buxhetore në muajin tetor 2020 në shumën e përgjithshme prej 94.200.00 €. Mirëpo, me vendim të Qeverisë së Republikës të Kosovës, në muajin dhjetor 2020, është bërë harmonizimi dhe shkurtimi i buxhetit të IAP-së në kategoritë e ndryshme buxhetore edhe në masën monetare prej 39.679.05 €.

Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020

Buxheti IAP-së për vitin buxhetor 2020 është realizuar në masën monetare 1.054.731.85 € apo shprehur në përqindje për 95.53 %, në raport me buxhetin final të fundit të vitit. Në

tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2020, sipas të dhënave buxhetore të kategorive ekonomike si dhe të shprehura në përqindje.

Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2020

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për 2020	Buxheti i shpenzuar	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	918.586.25	918.586.25	0.00	100.00
2.	Mallra dhe shërbime	140.949.70	94.307.94	46.641.76	66.91
3.	Shpenzime komunale	6.171.79	3.487.66	2.684.13	56.51
4.	Shpenzime kapitale	38.350.00	38.350.00	0.00	100.00
Gjithsej		1.104.057.74	1.054.731.85	49.325.89	95.53

IX. Statistikat

IX. Statistikat

Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve

Nga 1 janari 2020 deri më 31 dhjetor 2020, në selinë e IAP-së në Prishtinë dhe në zyrat rajonale janë parashtruar nga qytetarët e Kosovës 1419 ankesa dhe kërkesa për këshillë apo për ndihmë juridike.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, kishin të bënin me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, mbrojtjen e pronës, barazinë para ligjit, të drejtën e qasjes në dokumente publike etj.

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura dhe i rasteve të hetuara, numri i rasteve të hetuara sipas detyrës zyrtare, përkatësia etnike e ankuesve, gjinia e ankuesve, numri i rasteve të zgjidhura, autoritetet përgjegjëse kundër të cilave janë drejtuar ankesat, numri i raporteve me rekomandime dhe i letrave me rekomandime për rastet e hetuara, opinioneve, kërkesave për masë të përkohshme etj.

Tabela 1: Ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2020

	Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP	1419
	Numri i personave të përfshirë në ankesat e paraqitura	11197
Përkatësia etnike e ankuesve		
	Shqiptarë	1270
	Serbë	64
	Boshnjakë	24
	Ashkalinj	18
	Turq	15
	Romë	14
	Egjiptianë	5
	Goranë	4
	Të tjerë	5
Gjinia e ankuesve		
	Meshkuj	1016

	Femra	403
Autoritetet përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)		
	Ministritë	422
	Gjykatat	373
	Komunat	236
	Policia	64
	Prokuroritë shtetërore	63
	Person privatë	52
	Kompanitë private	52
	Ndërmarrjet publike	37
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	18
	Autoritetet e huaja	11
	Të tjera	183

Tabela 2: Ankesat e shpallura të papranueshme

	Numri i ankesave të shpallura të papranueshme	673
Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit		
	Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 22, pika 1.4	205
	Në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 22, pika 1.3	153
	S'ka shkelje, keqadministrim - neni 22, pika 1.1	149
	Jashtë juridiksionit - neni 21, pika 1.3.1	106
	Mosinteresim, dështim i palës - neni 22, pika 1.2	40
	Të tjera	20

Tabela 3: Ankesat në pritje për shqyrtim gjatë vitit 2020

	Ankesat në pritje për shqyrtim	26
--	---------------------------------------	----

Tabela 4: Rastet e hapura për hetim nga IAP-ja gjatë vitit 2020

	Rastet e hapura për hetim nga ankesat e paraqitura	720
	Rastet e hapura për hetim sipas detyrës zyrtare (ex-officio)	43
<i>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</i>		
	Shqiptarë	627
	Serbë	47
	Boshnjakë	17
	Turq	10
	Ashkalinj	5
	Egjiptianë	3
	Romë	3
	Goranë	3
	Të tjerë	5
Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara		
	Meshkuj	521
	Femra	199
Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP-ja (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)		
	Ministritë	239
	Gjykatat	215
	Komunat	148
	Policia	39
	Prokuroritë shtetërore	38
	Ndërmarrjet publike	20
	Kompanitë private	16
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	7

Persona privatë	7
Të tjera	72

Tabela 5: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	213
E drejta për mjete juridike	183
E drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit	165
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	133
Mbrojtja e pronës	76
Barazia para ligjit	61
E drejta e qasjes në dokumente publike	60
Të drejtat e fëmijës	36
E drejta për arsimin	25
Të drejtat e të akuzuarit	23
Liria e lëvizjes	22
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	15
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	14
Dinjiteti i njeriut	13
E drejta për jetën	6
Raste për ndërmjetësim	5
E drejta e martesës dhe e familjes	4
Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	2
E drejta e privatësisë	2
Liria e artit dhe e shkencës	2
E drejta e lirisë dhe e sigurisë	1
Liria e tubimit	1

	Liria e shprehjes	1
	E drejta e integritetit personal	1
	E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër	1
	Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë	1
	Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale	1

Tabela 6: Numri i rasteve të mbyllura nga IAP-ja gjatë vitit 2020 (jo vetëm rastet e vitit 2020, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)

	Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura	990
Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit		
	I zgjidhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - neni 21, pika 1.5	468
	I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - neni 22, pika 1.1	158
	I mbyllur me raport – neni 24, pika 3	146
	I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 22, pika 1.3	109
	I papranueshëm, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 22, pika 1.4	52
	I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - neni 22, pika 1.2	41
	I papranueshëm, jashtë juridiksionit - neni 21, pika 1.3.1	12
	Të tjera	4

Tabela 7: Raportet me rekomandime, Letër rekomandimet, Opinionet dhe Kërkesat për masë të përkohshme

	Raporte për rastet e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	17
	Raporte për rastet e hetuara <i>ex-officio</i>	5
	Raportet e MKPT-së	1
	Letra me rekomandime për rastet e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	19

	Letra me rekomandime për rastet e hetuara ex-officio	3
	Rekomandime në raportet dhe në letrat me rekomandime	185
	Amicus Curiae	4
	Kërkesë për masë të përkohshme	3
	Opinione	3

Tabela 8: Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Autoriteti përgjegjës	Rekomandi me të zbatuara	Rekomandime të pazbatuara	Në pritje për zbatim
Ministria e Punëve të Brendshme	1	0	3
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	0	0	2
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	0	3
Ministria e Infrastrukturës	2	3	0
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	0	3	0
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rajonal	0	0	1
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1	0	0
Ministria e Shëndetësisë	0	0	1
Ministria e Drejtësisë	0	0	1
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	0	0	2
Policia e Kosovës	0	1	9
Inspektorati i Arsimit	2	0	0
Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	0	0	1

Agjencia Kosovare e Privatizimit	0	1	0
Autoriteti i Aviacionit Civil	0	0	3
BQK	0	0	4
Rektori i Universitetit të Prishtinës dhe Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës	0	0	1
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës	0	0	1
Inspektorati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit	0	0	1
Komisioni i Ankesave për të Huajt	1	0	0
Kuvendi i Republikës së Kosovës	0	0	1
Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokuroria Speciale	0	1	0
Gjykata Themelore në Prishtinë	0	0	1
Gjykata Themelore në Prizren	0	0	1
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	1	0	0
Prokuroria e Shtetit dhe Inspektorati Policor i Kosovës	0	0	1
Prokuroria Themelore në Prishtinë	1	0	2
Komuna e Prishtinës	4	0	5
Komuna e Kamenicës	4	0	2
Komuna e Fushë Kosovës	0	3	5
Komuna e Graçanicës	3	0	4
Komuna e Ferizajt	0	0	6
Komuna e Istogut	0	0	5
Komuna e Klinës	0	0	5
Komuna e Gjakovës	0	1	4
Komuna e Mitrovicës së Veriut	3	0	2

Komuna e Pejës	3	0	2
Komuna e Vushtrrisë	4	0	1
Komuna e Mitrovicës së Jugut	0	0	5
Komuna e Lipjanit	0	0	5
Komuna e Prizrenit	0	0	2
Komuna e Glllogcit	0	0	2
Komuna e Kllokotit	1	0	2
Komuna e Gjilanit	1	0	1
Komuna e Deçanit	1	0	1
Komuna e Podujevës	0	0	2
Komuna e Malishevës	0	0	2
Komuna e Suharekës	0	0	2
Komuna e Rahovecit	0	0	2
Komuna e Shtimes	0	0	2
Komuna e Junikut	0	0	2
Komuna e Obiliqit	0	0	2
Komuna e Dragashit	0	0	2
Komuna e Mamushës	0	0	2
Komuna e Kaçanikut	0	0	2
Komuna e Hanit të Elezit	0	0	2
Komuna e Skenderajt	0	0	1
Komuna e Vitisë	0	0	1
Komuna e Zveçanit	0	0	2
Komuna e Zubin Potokut	0	0	2
Komuna e Shtërpcës	0	0	2
Komuna e Novobërdës	0	0	2
Komuna e Leposaviqit	0	0	2

Komuna e Parteshit	0	0	2
Komuna e Ranillugës	0	0	2
Gjimnazi i Specializuar Matematikor-Prishtinë	2	0	0
Totali	36	13	136

Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2020 - 31 dhjetor 2020




Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP




Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura




Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura




Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP




Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim




Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP-ja




Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë




Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP-ja gjatë vitit 2020 (jo vetëm rastet e vitit 2020, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)




Figura 9: Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Statistikat mbi treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike²⁴⁸

Më 7 dhjetor 2017, mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian u nënshkrua Marrëveshja Financiare për Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimin - IPA 2016, pjesa e dytë, për Reformën e Administratës Publike. Kontributi maksimal i Bashkimit Evropian në këtë marrëveshje është në vlerën prej 25.000.000.00 EUR.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj marrëveshje: *“Synon përkrahjen e procesit të reformës së administratës në Kosovë me qëllim të rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe efektivitetit të administratës publike, me fokus më të madh në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Ky program synon të ndihmojë qeverinë e Kosovës në zbatimin e pakos strategjike të reformës së administratës publike e miratuar në vitin 2015 e fokusuar veçanërisht në përmirësimin e llogaridhënies së administratës, harmonizimin e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, në prezantimin e menaxhimit modern të burimeve njerëzore dhe modernizimin e shërbimeve publike të orientuar drejt konsumatorit. Programi gjithashtu do të fuqizoj kapacitetet administrative të nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin e acquis të BE-së.”*²⁴⁹

Vlen të theksohet se me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, kjo çështje është përfshirë po në këtë marrëveshje, përmes treguesit (indiktorit) nr. 7, i cili parasheh se deri në vitin 2020, zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e nivelit qendror të arrijë jo më pak se 60%. Ndërsa kujtojmë se në vitin 2016, sa u përket rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror, zbatimi i tyre ka qenë në shkallën 16%.

Për shkak të gjendjes së krijuar me pandeminë COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria për Punë të Brendshme dhe Administratë Publike, më datë 26 mars 2020, ia ka drejtuar një letër Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, përmes së cilës ka kërkuar që afati për përmbushjen e indikatorëve të paraparë që të arrihen deri në fund të vitit 2020 lidhur me realizimin e kontratës së sipërpërmendur, të shtyhet për të njëjtën periudhë të vitit 2021.²⁵⁰ Kjo kërkesë u shqyrtua nga Komisioni Evropian dhe duke marrë parasysh rrethanat e krijuara, ata kthyen përgjigje pozitive lidhur me arritjen e qëllimeve të paraparë për vitin 2020, të cilat shtyhen për vitin 2021.

Sidoqoftë, IAP-ja, pavarësisht pandemisë, ka vazhduar me punën për realizimin e misionin të tij, prandaj më poshtë do ta paraqesim gjendjen e zbatimit të treguesit nr. 7.3.1 dhe 7.3.2 për vitin 2020:


²⁴⁸ Marrëveshja financiare për IPA 2016 - pjesa e dytë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së.

²⁴⁹ Marrëveshja financiare për IPA 2016 - pjesa e dytë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së, fq. 18.

²⁵⁰ Letra e datës 26 mars 2020, e z. Xhelal Sveçla, ministër në detyrë i Ministrisë së Brendshme dhe Administratës Publike, drejtuar znj. Nataliya Apostolova, Udhëheqëse e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Treguesi 7.3.1 kërkon që të paktën 95% e institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit u ka adresuar rekomandime në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2020, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Avokati i Popullit gjatë periudhës 1 janar deri më 30 nëntor 2020, ua ka adresuar 43 rekomandime institucioneve të nivelit qendror²⁵¹, nga të cilat, vetëm për 25 rekomandime ka marrë përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, i përcaktuar me nenet 25 dhe 28 të Ligjit nr. 5/L-019 për Avokatin e Popullit,²⁵² kurse për 18 rekomandime të tjera nuk ka marrë përgjigje apo përgjigja ka arritur jashtë afatit ligjor. Me këtë vihet në konkluzion se shkalla e zbatimit për treguesin 7.3.1 është mjaft e ulët, sepse Avokati i Popullit gjatë periudhës së përcaktuar ka marrë përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh vetëm për 58% të rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror. Prandaj, sipas këtyre të dhënave, treguesi 7.3.1 nuk është përmbushur.²⁵³



²⁵¹ Institucionet e nivelit qendror të përcaktuara me treguesin 7 të Marrëveshjes financiare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Kjo marrëveshje mund të gjendet në gazetën zyrtare nën linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>


²⁵² <https://www.oik-rks.org/2018/08/20/ligji-per-avokatin-e-popullit-nr-051-019/> qasur më 13/02/2019

²⁵³ Metoda e kalkulimit për treguesin 7.1.1 është bërë sipas formulës:

$X = \frac{\text{numri i rekomandimeve me përgjigje nga institucionet e nivelit qendror të pranuar nga Avokati i Popullit brenda afatit ligjor}}{\text{numri total i rekomandimeve të Avokatit të Popullit adresuar institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar}} \times 100$.

Treguesi 7.3.2 kërkon që të zbatohen të paktën 60% e të gjitha rekomandimeve drejtuar institucioneve të qeverisë qendrore, të lëshuara në vitet 2019 dhe 2020, në të cilat institucionet e nivelit qendror janë përgjigjur pozitivisht.

Referuar treguesit 7.3.2, rekomandimet e adresuara gjatë periudhës 2019 dhe 2020, për të cilat IAP-ja ka marrë përgjigje pozitive apo përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, janë 143 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 81 sosh. Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, sipas këtij indikator, është 57%,²⁵⁴ pra nuk ka arritur të përmbushej në mungesë të një përqindjeje shumë të vogël.



²⁵⁴ Metoda e kalkulimit është bërë sipas formulës së përcaktuar me treguesin 7.3.2:

$X = \frac{\text{numri i rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar, për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, janë zbatuar}}{\text{numri i përgjithshëm i rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve}} \times 100.$